

Xhafer Durmishi
SKENDER

VEPRA

4



TË FALA S'PO NA ÇOJNË ASNJËHERË

PARAFJALË

1. SA JU KANË LËNDUAR KËTO ETIKETIME

Programi i Jusuf Gërvallës i shprehur

- 1. Në Aktgjykimet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare....
- 2. Në *Programin dhe Statutin e Frontit të Kuq Popullor*
- 3. Në gazetën *Bashkimi*
- 4. Në revistën *Lajmëtari i lirisë*
- 5. Në letrën dërguar Enver Hoxhës
- 6. Në artikuj teorik ende të pabotuar
- 7. Në letrat - raportet dërguar Sabri Novosellës
- 8. Në revistën *Zëri i Kosovës*

2. TI SI GJITHMONË MA MUND ME FJALË

- 1. UDHËTIM I TMERRSHËM - RRUGËS KALUAM MIRË
- 2. AI TAKIM I VËSHIRË - GËZIMI YNË NUK PATI KUFI
- 3. NUK MBETËM VETËM
- 4. PO E LA BARDHYLI PUNËN
- 5. TI SI GJITHMONË MA MUND ME FJALË
- 6. E KA LANË PUNËN - NUK E KA LËNË PUNËN
- 7. THONË SE JANË NJË LULI E NJË KEQA
- 8. PROPAGANDË QESHARAKE
- 9. GAJRETI I GJERGJIT PËR POPULLIN E PATREMBUR
- 10. GAJRETI I GJERGJIT PËR JUSUFIN E TREMBUR

3. GEGA IA SJELL JUSUFIT POROSINË NGA LULI E KEQA

- 1. NUK VARET GJITHË SHQIPTARIA PREJ SHTËPISË SONË
- 2. NA BEFASOI DHE KRIJOI TË ÇARA NË MESIN E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE
- 3. NA BEFASOI DHE KRIJOI UNITET NË MESIN E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE
- 4. ME HYSENIN E PRITËM BASHKË VITIN E RI 1980
- 5. TASH SË FUNDI JAM NË KONTAKT
- 6. ME HYSENIN NUK E PRITËM BASHKË VITIN E RI 1981

4. BASHKIMIN DO TA BËJNË NJERËZIT E VËRTETË TË PUNËVE TË VËRTETA

- 1. KUJDESI PËR RRRITJEN E QENIT TË SHARRIT DHE PËRHAPJA E TIJ NË BOTË
- 2. KU E KE TELEFONIN – TELEFONI NUK PUNON
- 3. E KENI DITUR JU KËTË FAKT?
- 4. E KENI DITUR JU KËTË THASHETHEMNAJË?
- 5. BASHKIMIN DO TA BËJNË NJERËZIT E VËRTETË TË PUNËVE TË VËRTETA

5. LOTËT E TIJ PIKUAN

- 1. I mungonte babai
- 2. E ka përqaftuar babain
- 3. U gëzova shumë kur mora ftesën e Suzanës

6. SPEKTAKLE DHE VRAPIME TË MJERA

- 1. BURRNIA DHE QYQARIA
- 2. ÇKA JANË KËTO SPEKTAKLE TË MJERA?
- 3. VARRIM MADHËSHTOR
- 4. Ç'ËSHTË KY VRAP I MJERË?
- 5. NJË JAVË U GRINDËM PËR GURËT E YJET
- 6. FOL ME LULËN QË T'I FLET KEQËS

7. NE MBETËM PA ASKË PRANË

- 1. USHQIMI I TYRE ISHTE NEKTARI DHE AMBROSIA
- 2. NA LINTE SIKUR FËMIJËT KUR I LE E AMA
- 3. JU JEPSHA GAJRET TË GJITHËVE POR ATËHERE E KISHA GJITHË SHOQËRINË E JUSUFIT ME VETE
- 4. NUSJA E BARDHYLIT E KTHYE, NE MBETËM PA ASKË PRANË
- 5. PATA VËREJTJE PËR PUNËN E TYRE
- 6. TË FALA S'PO NA ÇOJNË ASNJËHERË

8. SHKUAM E NA ÇUAN

-1. I DASHUR SHOKU ENVER

-2. PËRCJELLJA E SUZANËS, PREMTONIT, DONIKËS DHE ERGONIT PËR SHQIPËRI

-3. REAGIM I FAMILJES GËRVALLA

PARAFJALË

Ky libër ka të bëjë me dramën *Misioni* të Sabri Hamitit, e cila u botua më 1997. Këtë dramë mu dha rasti ta lexoj në fund të vitit 2006. Shënimet që mbajta më mbetën në dorëshkrim për shkak të botimeve të disa librave që dolën në vitet 2007-2010. Drama e Sabri Hamitit ka të bëjë me Vëllezërit Gërvalla në Shtutgart (Isën e Bardhylin) me Kadri Zekën (Lulin) e Ibrahim Kelmendin (Keqën). Kjo ka të bëjë sidomos me familjen e ngushtë të Jusufit (Suzanën, Premtonin e Donikën), me çaste të jetës së tyre në Shqipëri dhe Gjermani.

Drama *Misioni* i ka katër pjesë: Pjesa e parë VDEKJA, skenat 1, 2, 3 dhe 4.

Pjesa e dytë DASHA, 1 skenë. –Pjesa e tretë BALSAMI, skenat I (1, 2, 3, 4) dhe II (1, 2, 3, 4) –Pjesa e katërt NATA, 1 skenë.

Tekstin e librit e kam ndarë në tetë kapituj.

Kapitulli 1. Prezantohen idetë themelore politike të Jusufit të krahasuara me disa mendime tjera, që nuk kanë të bëjnë shumë me dramën por e lehtësojnë kuptimin e thelbit të saj.

Kapitulli 2. Trajton pjesën e parë skenat 1 dhe 2.

Kapitulli 3. Trajton pjesën e parë, skenën 3.

Kapitulli 4. Trajton pjesën e parë, skenën 4..

Kapitulli 5. Bëhet vetëm një përgjithësim i pjesës së dytë.

Kapitulli 6. Trajton pjesën e tretë. Bëhet një përgjithësim i skenës I-1. Nga skenat I-3 dhe I-4 bëhen vetëm citime. Po nga pjesa e tretë trajtohen gjithashtu skenat II-1 dhe II-2.

Kapitulli 7. Trajton pjesën e tretë, skenat I-2 dhe II-3.

Kapitulli 8: Trajton pjesën e tretë, skenën II-3.

Vetë Sabri Hamiti është i mendimit se kur kemi të bëjmë me persona e ngjarje historike duhet t'u përmbahemi dokumenteve. Sabri Hamiti dhe personat burimor të tregimit të dramës së tij nuk janë mbështet në dokumente e fakte por në disponimet e çastit, sipas situatave të krijuara. Atë çka e kanë kërkuar prej të tjerëve nuk e kanë zbatuar vet.

Sabri Hamiti: "ZANA – Ti e di Gjergj kush e ka njohur Isën. Mirëfilli e luta atë djaloshin dinak e të urtë që të mbështetej në dokumente." (f.101)

Me këtë rast dua ta falënderoj Faridin Tafallarin, i cili përveç leximit të dorëshkrimit më siguroi dokumente të rëndësishme për punën time, me qëllim që veprimtaria e shokëve të luftës së Vëllezërve Gërvalla dhe aktivistëve tjerë të dalluar të asaj kohe të del sa më e plotë.

Në çdo rast, para citimeve nga drama *Misioni* janë vendosur vetëm inicialet e autorit "S. H." dhe në fund të citatit e jap vetëm numrin e faqes nga ajo.

Më 2007 drama Misioni u botua në frengjisht. Me ribotimin e lajmit nga Qendra për Informim e Kosovës (QIK) e mbylli këtë parafjalë.

"Misioni" i Sabri Hamitit në frengjisht

Drama u promovua në Qendrën e njohur kulturore Zhorzh Pompidu në Paris Paris/Prishtinë, 5 dhjetor 2007 (QIK)- Drama e Sabri Hamitit "Misioni", botuar para dhjetë vitesh në Prishtinë, doli në frengjisht muajin e kaluar, botuar nga shtëpia botuese "L'Espace d'un Instant" në Paris, nën perkujdesjen e Dominique Dolmieu (Domink Dolmje).

Drama u përkthye nga gjuha shqipe prej Anne Marie Autissier (Anë Mari Otisje) dhe Fatime Neziroskit.

Brenda këtij botimi përfshihen edhe dy tekste dramatike të Sabri Hamitit: "Dialogu" dhe "Dialogu i gjahtarëve barbarë", të shkruara në vitin 1999. Këto tekste nga shqipja i përktheu Christiane Montécot (Kristianë Monteko). Libri shoqërohet me një shënim biografik për shkrimtarin Sabri Hamiti, kurse parathënien e ka shkruar Chatherine Bédarida (Katrinë Bedarida), kritike e gazetës prestigjioze "Le Monde".

*Kritikja Bedarida, në parathënie bën një portret letrar dhe kulturor të autorit, duke theksuar që veprat e tij dramatike janë një dëshmi e ndodhive të rënda në Kosovë në deceniet e fundit. Ajo vlerëson që përkthimi në frengjisht i "Misionit" bën të mundur që "në Francë të zbulohet një shkrim fluid dhe preciz i këtij autori rreth temës së ekzilit, edhe para se ai ta kishte përjetuar vetë. Aty janë të pranishme të gjitha elementet që e copëtojnë zemrën e të ekziluuarit: përballja që të jetë i dyshuar që jeton një jetë të qetë e egoiste nga militantët e mbetur në vend; akuzat e tradhtisë rreth çështjes; **QËRIMI I HESAPEVE** në mënyrë mizore dhe të marrë; ringjallja politike e fituesve. 'Misioni' është një tekst i guximshëm që shfaq plagët e rënda të shkaktuara nga degradimi i situatës të imponuar nga regjimi i Serbisë".*

Kritikja franceze nënvizon në parathënie të librit që klika e diktatorit serb gjykohet në Tribunalin Penal Ndërkombëtar, kurse Sabri Hamiti ka rimarrë punët e shkrimtarit dhe të profesorit universitar. "E ardhmja e Kosovës është në diskutim, por artistët dhe intelektualët kanë rigjetur një frymim - ende të brishtë - të lirisë", përfundon Katrinë Bedarida.

Libri "Misioni" më tutje karakterizohet: "Ngjarjet e 'Misionit' ndodhin në Kosovë, në Shqipëri dhe në Evropën Perëndimore, dhe paraqesin fatin e personazheve të ndrydhura ndërmjet lidhjeve të tyre me atdheun - motor i ekzistencës së tyre" dhe tokës së panjohur dhe armiqësore, ku janë të mërguar. Në fillim të intrigës, vrasja politike e një idealisti, Isa, të cilin angazhimi për lirinë e shpie deri në sakrificën e jetës së tij. Në sfond profilohen ngjarjet politike që kanë përfshirë regjionin në fund të shekullit, nën shenjën e një tensioni ekstrem politik".

Promovimi i dramës "Misioni" të Sabri Hamitit në frengjisht u bë më 1 dhjetor në qendrën e famshme kulturore "Zhorzh Pompidu" të Parisit para një auditori të zgjedhur, në kuadrin e programit vjetor të kësaj Qendre për letërsinë e mërgimit. Programi i promovimit përfshinte bisedën e hapur me autorin për veprën e tij letrare dhe leximin e tekstit dramatik në skenë nga trupa Théâtre de Syldavie e Parisit. (www.kosova.com)

*TANJUG: "Policia ende po i gjurmon dorasit, por mund të supozohet se është fjala për **QËRIM TIPIK HESAPESH** midis emigrantëve të nëntokës së RFGJ, të cilëve, siç mendon policia i kanë takuar edhe viktimat e kësaj përleshjeje." (Bon, 18 janar 1982)*

1. SA JU KANË LËNDUAR KËTO ETIKETIME?

Programi i Jusuf Gërvallës

I shprehur

- 1. Në Aktgjykimet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare....
- 2. Në Programin dhe Statutin e Frontit të Kuq Popullor
- 3. Në gazetën *Bashkimi*
- 4. Në revistën *Lajmëtari i lirisë*
- 5. Në letrën dërguar Enver Hoxhës
- 6. Në artikuj teorik ende të pabotuar
- 7. Në letrat - raportet dërguar Sabri Novosellës
- 8. Në revistën *Zëri i Kosovës*

-1. Në Aktgjykimet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare....

S. H.: "*DONA -Kush janë ata t'u flas për babain tim. Asnjë fjalë. Babain e kam njohur vetëm në Prishtinë. Duhet të kthehem atje për ta rinjohur. Jashtë nuk ka qenë i njëjti. Ajo mbyllje në dhomën e tij në mansardë. Ai ballë i rrudhur, ajo buzëqeshje e tretur. Interesi i humbur për gitarën e vetë, për flautën time. Atëherë s'kam ditur gjë, tash e di si ia hëngrën shpirtin paknapak përditë. Ai për mua kishte humbur në Gjermani. Bishat ia hëngrën zemrën. Tash duan të ngjallen si kufomat e gjalla rreth hijes së tij. Jo. Nuk lejoj, nuk dua. Çka kanë bërë për të, asgjë. E kanë veshur vdekjen e tij me një vel të mjegullës, me peshën e territ. Jo! Pushim. Ç'është ky vrap i mjerë i njerëzve që duan të gjejnë identitetin e vet te tjetri në vonesë kohe.*" (F. 88-89)

"Bota sot: Ju e thatë edhe më lart se pas vrasjes së Jusufit, Bardhoshit e Kadriut ka patur interpretime për personalitetin e Jusufit, është folur se ka qenë "marksist, komunist..." etj. **Sa ju kanë lënduar juve si familje këto etiketime?**

Hysen Gërvalla: Sigurisht se na kanë prekur. Jusufi kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, kurrë nuk ka qenë komunist. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike." (Bota Sot, 1 dhjetor 2006)

Aktgjykim: "*I akuzuari Isa Demaj*

Sepse me shkrim dhe gojarisht nxiti ndërrimin antikushtetutar të rregullimit shoqëror-socialist e vetëqeverisës dhe shkatërrimin e bashkim – vëllazërimit e barazisë së kombeve e kombësive të RSFJ, e po ashtu me qëllim të keq dhe rrejshëm i paraqiti rrethanat politiko-shoqërore në RSFJ, kështu që gjatë viteve 1975 deri në 1979 në Lipjan dhe vendet tjera gjatë bisedave me të akuzuarin Avdi Kelmendi, e pastaj me **Ismajl Gashin, Beqir Lecin, Ekrem Llugiqin** dhe persona tjerë ka deklaruar se në **Jugosllavi nuk ekziston socializmi i vërtetë po vetëm politika revizioniste**, se shoku **Tito është antikomunist** dhe se politika e tij të cilën e udhëheqë shkon në favor të **kapitalizmit**, se Beogradi udhëheqë politikë shfrytëzuese ndaj Kosovës, se RSFJ i shfrytëzon pasuritë natyrore të KSA të Kosovës. Poashtu ka kritikuar sistemin socialist vetëqeverisës dhe ka

deklaruar se duhet punuar me rininë shqiptare në mënyrë që e njëjta të ngritet ideologjikisht për veprimtari armiqësore ndaj RSFJ, e pastaj në banesën e Ismajl Gashit në Lipjan ka deklaruar se situata politike e Kosovës nuk ka ndryshuar pas Plenumit të Katërt, kurse para nxënësve të QAMO në Lipjan, ku ka qenë i inkadruar në veti të profesorit të gjuhës shqipe ka recituar vargje nga “Lahuta e Malësisë” dhe shumë herë është shprehur armiqësisht ndaj sistemit socialist në RSFJ, dhe gjatë bastisjes në shtëpinë e tij më 27 dhjetor 1979 janë gjetur shtatë ekzemplarë të revistës “Ylli”, vjersha “Kosovës” e materiale tjera me përmbajtje armiqësore, - me çka ka kryer veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ.” (AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË QARKUT NË PRISHTINË P - nr. 137/80, 4 qershor 1980, www.pashtriku.org)

Hysen GËRVALLA: “Qëllimet majtiste tani janë të kthjellëta si loti: ose do të ketë shtet siç mendon tradhtia, ose mos të formohet fare shteti i Kosovës.” (Bota Sot, 12 mars 2003)

Aktgjykim: “I akuzuari Avdi Kelmendi, si në hetime ashtu edhe në seancë kryesore, pohon se me veprimtari armiqësore ka filluar të merret nën ndikimin e të akuzuarit Isa Demaj i cili e ka frymëzuar me ideologji të huaj. Për Jugosllavinë i ka folur se është larguar shumë nga socializmi duke shkuar rrugës së revizionizmit modern, se **Titoja është antikomunist dhe se politika që e udhëheq ai është në kundërshtim me parimet marksiste-leniniste dhe shkon në favor të imperializmit**, se Jugosllavia ka politikë shfrytëzuese ndaj Kosovës dhe popullatës së saj, duke ia grabitur pasuritë nëntokësore e mbitokësore.” (Aktgjykimi i Shefqet Jasharit me shokë. Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-nr. 248/80, 10 nëntor 1980. faqe 8)

Aktgjykim: “**Sipas mendimit të Jusuf Gërvallës në komitet duhet të marrin pjesë të akuzuarit Ismajl Haradinaj, Nimon Mustafaj, Nazmi Selmani dhe dy hoxhallarë, imami i fshatit Drenofc dhe një hoxhë nga Gjakova.** ... Sipas porosisë së Jusufit bëjnë bisedë edhe me të akuzuarin Nimon Mustafaj, e njoftojnë me “Statut” dhe “Programin” e “Lëvizjes nacionalçlirimtare të Kosovës”, i **përcjellin porositë e Jusuf Gërvallës dhe i shtrojnë për detyrë që të kontakton dhe angazhoj Hafizin - hoxhë**, të cilën detyrë e pranon, kështuqë pas 3-4 ditësh shkon në Gjakovë, gjen momentin e përshtatshëm për bisedë me Hafizin, i parashtron qëllimin e ardhjes së tij, mirëpo nuk arrin me e angazhuar pasi i njejtë refuzon. Për këtë e njofton të akuzuarin Ismajl. Për të akuzuarit Ismajl dhe Hasan kanë qenë të papranueshme dhe inkompatibile në bazat “Marksiste” që anëtarë të komitetit **të jenë hoxhallarët**, kështuqë në këtë drejtim të akuzuarit Ismajl e sidomos i akuzuari Hasan Ukëhaxhaj është angazhuar që të gjej njerëz të përshtatshëm për komitet.” (Aktgjykimi kundër Ismail Haradinajt me shokë nga Gjykata e Qarkut në Pejë, Më datën 6 gusht 1981, P. nr. 106/81, www.pashtriku.org)

-2. Në Programin dhe Statutin e Frontit të Kuq Popullor

Hysen Gërvalla: “**Jusufi kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, kurrë nuk ka qenë komunist.** Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike.” (Bota Sot, 1 dhjetor 2006)

Programi i Jusuf Gërvallës, është i shprehur mirë në përpilimin nga ai i Programit dhe Statutit të Frontit të Kuq Popullor.

Jusuf Gërvalla: “Egzistojnë shumë grupe e organizata, që të gjitha me një qëllim të vetëm, madje me një ide të vetme edhe për mënyrën e sendërtimit të këtij qëllimi (jo zogistë, ballistë... po vetëm komunist, marksist-leninistë që pranojnë vetëm pikëpamjet e

një vendi të vërtetë socialist, siç është Shqipëria), por gjithë këto grupe e organizata e patën vështirë t'i shplohen shoqja-shoqes dhe t'i bashkojnë armët, sepse armiku pat infiltruar në radhët e tyre një armatë agjentësh." (Bashkimi, janar-shkurt 1980, faqe 2, shtylla 4)

Jusuf Gërvalla: "Lufta kryesore dhe e vetme do të jetë lufta kundër robëruesit jugosllav, në krye me klikën titiste dhe shovinizmin sllavomadh (serb, malazez e maqedon) me qëllim të çlirimit social e nacional nga Jugosllavia dhe të bashkimit shoqëror e kombëtar me vendin amë, Shqipërinë Socialiste. Kjo është e drejtë legjitime e popullit shqiptar, i cili, megjithëse derdhi pa kursim gjakun e vet të shtrenjtë për tokat e veta të shenjtë, u bë pre e apetiteve pushtuese jugosllave dhe e politikës diskriminuese të fuqive të mëdha.

*Donika Gërvalla: "Shtypja e vazhdueshme e popullatës në Kosovë nga ana e regjimit **komunist** jugosllav, nga artisti dhe gazetari Jusuf Gërvalla, bëri edhe veprimtarin politik Jusuf Gërvalla. Ai merr pjesë në lëvizjen ilegale, e cila ngjashëm me vendet e tjera të Evropës Lindore që vuanin nga regjimet e tyre diktatoriale përpigjej të mbronte dhe të realizonte të drejtat e popullatës ndaj shtypjes totalitare të regjimeve përkatëse." (www.gervalla.org, 2009)*

... Meqë interesat tona klasore e kombëtare përputhen me interesat klasore e kombëtare të popujve të Jugosllavisë, ne nuk dëshirojmë luftë me këta popuj, pos me klikën revizioniste të Beogradit. Prandaj në kohë "paqeje", FRONTI I KUQ POPULLOR ka për detyrë që me propagandë të shëndosh patriotike dhe marksiste-leniniste, t'i çjerrë maskën përgjithësisht klikës së egër të Beogradit dhe të thërras në luftë kundër saj edhe forcat përparimtare të popujve tjerë të Jugosllavisë. Mbi të gjitha, forca e propagandës i drejtohet popullit shqiptar, në mënyrë që ai të përgatitet në baza sa më të shëndosha e më të forta për revolucionin e ardhshëm.

... Strategjia e punës dhe e luftës së FRONTIT TE KUQ POPULLOR do të jetë strategjia e PPSH, e cila e ka demaskuar dhe demaskon me ngulm revizionizmin dhe politikën e egër jugosllave të gjenocidit mbi shqiptarët në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. Lufta e shokut Enver Hoxha kundër revizionizmit, strategjia e hollë dhe trimëria e pashembullt e Tij në mbrojtjen e interesave jetike të popullit dhe të Shtetit Shqiptar, do të jenë mësimet bazë për të gjithë anëtarët e FRONTIT TE KUQ POPULLOR dhe do të studiohen me kujdes në mënyrë kreative, duke iu përshtatur kushteve konkrete.

... Vendimet bazë dalin nga komunistët, pasi të jenë analizuar në mënyrë kritike dhe pasi të jetë konstatuar se sjellin kontribut të padyshimtë për revolucionin. Me formimin e Partisë Komuniste Shqiptare (në viset e robëruara) FRONTI I KUQ POPULLOR do t'i organizojë masat rreth sajë, pasi PK do të jetë prezantuesja më e denjë e klasës punëtore.

"Bota sot: Ju e thatë edhe më lart se pas vrasjes së Jusufit, Bardhoshit e Kadriut ka patur interpretime për personalitetin e Jusufit, është folur se ka qenë "marksist, komunist..." etj. Sa ju kanë lënduar juve si familje këto etiketime?

Hysen Gërvalla: Sigurisht se na kanë prekur. Jusufi kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, kurrë nuk ka qenë komunist. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike." (Bota Sot, 1 dhjetor 2006)

Propaganda duhet të kryhet në çdo vend dhe në çdo rast e kohë; ajo duhet të jetë propagandë e shëndosh, që demanton dhe demaskon plotësisht realitetin revizionist jugosllav dhe sidomos politikën antishqiptare të Jugosllavisë.

... - TE RROJE SHOKU ENVER HOXHA, QE PO NA NDRIQON RRUGEN E VEPRIMIT!" (PROGRAMI DHE STATUTI I FRONTIT TE KUQ POPULLOR, maj 1980)

-3. Në gazetën *Bashkimi*

Programi i Jusufit në mënyrë të përsosur është i shprehur edhe në artikullin "Bashkimi bënë fuqinë" i botuar në numrin e fundit të gazetës Bashkimi.

Jusuf Gërvalla: *"Po deshëm që lufta jonë, nga një rezistencë spontane, të kalojë në luftë të organizuar për çlirimin kombëtar dhe klasor, atëherë para nesh shtrohet si domosdoshmëri studimi dhe përvetësimi i historisë kombëtare dhe i literaturës revolucionare marksiste-leniniste. Zotërimi i kësaj literature nga avangarda jonë dhe popullarizimi i saj në masa ka qenë dhe mbetet detyrë primare për zgjimin e vetëdijes kombëtare e klasore të masave populllore dhe të punonjësve.*

Hysen GËRVALLA: *"Qëllimet majtiste tani janë të kthjellëta si loti: ose do të ketë shtet siç mendon tradhtia, ose mos të formohet fare shteti i Kosovës."* (Bota Sot, 12 mars 2003)

Nën kujdesin e Partisë së Punës të Shqipërisë, sot në Atdheun tonë socialist lulëzon një literaturë e begatshme revolucionare. Nga literatura e tillë, që duhet të përvetësohet në mënyrë të domosdoshme dhe të ngutshme, sidomos nga pararoja jonë revolucionare, donë veçuar këto pikëmbështetje kryesore: veprat e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit e ato të marksist-leninistit dhe prijësit të madh shqiptar, shokut Enver Hoxha; historia kombëtare shqiptare, ajo e PPSH-së dhe dokumentat e PPSH-së; shtypi shqiptar, sidomos publikimet shkencore nga lëmi i historisë dhe ai i ndërtimit teorik dhe praktik të socializmit në Atdheun tonë." (Bashkimi, janar 1981, faqe 1, shtylla 1-2)

"Bota sot: *Ju e thatë edhe më lart se pas vrasjes së Jusufit, Bardhoshit e Kadriut ka patur interpretime për personalitetin e Jusufit, është folur se ka qenë "marksist, komunist..." etj. Sa ju kanë lënduar juve si familje këto etiketime?*

Hysen Gërvalla: *Sigurisht se na kanë prekur. Jusufi kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, kurrë nuk ka qenë komunist. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike."* (Bota Sot, 1 dhjetor 2006)

Jusuf Gërvalla: *"Për një Shqipëri socialiste të të gjithë shqiptarëve! Lëvizja jonë, lufta jonë nacionalçlirimtare, revolucionari ynë, na shpien pikërisht te qëllimi ynë kryesor: te një Shqipëri socialiste e të gjithë shqiptarëve. Kjo aspiratë është vënë edhe në ballë të organit tonë "Bashkimi" në trajtë parulle.*

Nëse lufta jonë nacionalçlirimtare synon çlirimin kombëtar të të gjitha trojeve tona të pushtuara nga Jugosllavia, atëherë jemi duke luftuar për një Shqipëri. Nëse pos çlirimit kombëtar synojmë edhe çlirimin klasor, atëherë jemi duke luftuar për një Shqipëri socialiste, e cila pas bashkimit të tokave që iu shkëputën padrejtësisht trungut shqiptar, do të jetë Shqipëria socialiste e të gjithë shqiptarëve.

Hysen GËRVALLA: "Qëllimet majtiste tani janë të kthjellëta si loti: ose do të ketë shtet siç mendon tradhtia, ose mos të formohet fare shteti i Kosovës." (Bota Sot, 12 mars 2003)

Ai që bënë zhurmë duke na e mohuar një të drejtë të tillë, në thelb është reaksionar, sepse pikëpamjet e tilla janë kryekëput pikëpamje imperialiste, kolonialiste e revizioniste. T'i mohosh popullit tonë të drejtën e luftës nacionalçlirimtare, do të thotë të pajtohesh me robërimin e popujve, dhe kjo është antimarksiste e antileniniste." (Bashkimi, janar 1981, faqe 1, shtylla 2)

Jusuf Gërvalla: "**Bashkëpunimi internacionalist i forcave tona çlirimtare**

Siç shihet edhe në Programin e Frontit të Kuq Popullor, ne kurrë nuk do të luftojmë kundër popullit serb, malazez e maqedonas. Përderisa ata të mos i përgjigjen ndërsimit të klikës titiste.

Hysen Gërvalla: "**Jusufi** kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, **kurrë nuk ka qenë komunist**. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike." (Bota Sot, 1 dhjetor 2006)

...Nga kjo del se ne, në baza të shëndosha marksiste-leniniste, nuk pranojmë të bëjmë gabime trashanike, siç është identifikimi i një populli me qeverinë e tij, kur kjo qeveri është antipopullore. As veprimet e individit të helmuar me politikën shoviniste që ndjek ndaj shqiptarëve udhëheqja revizioniste jugosllave, ne nuk do t'i përgjithësojmë dhe etiketojmë si akte të popullit serb, malazez e maqedonas. Lufta dhe revolucionin ynë do të jenë më të fuqishëm e më të plotë, sa më shumë që të shtrijnë ndikimin e tyre edhe në çlirimin kombëtar e klasor edhe të popujve të tjerë, mbi të cilët ushtrohet dhuna e pushtuesve të huaj apo e pushteteve të veta reaksionare e antipopullore." (Bashkimi, janar 1981, faqe 1, shtylla 2)

Jusuf Gërvalla: "Në gjithë të kaluarën tonë fqinjësore, siç tregon përvoja shekullore, "Bashkimi i armëve (shqiptare) me fqinjët e Ballkanit ka qenë (për ne) vetëvrasje." (Arben Puto).

...Kështu, çështja e bashkëpunimit në baza të internacionalizmit proletar me serbët, malazezët dhe maqedonasit, për ne është një gjë shumë e vështirë, ndoshta edhe e pamundshme. Megjithatë, kur te këto popullsi të kemi hetuar disponim të mirë për bashkëpunim mbi bazat e përmendura ne nuk do të refuzojmë." (Bashkimi, janar 1981, faqe 1 shtylla 3)

Jusuf Gërvalla: "Me këtë rast duhet të vëmë në dukje se ne ende nuk kemi qenë në gjendje ta formojmë partinë tonë komuniste marksiste-leniniste, pa të cilën gati do të jetë e pamundshme hyrja konkrete në luftën e ardhshme nacionalçlirimtare dhe në revolucionin tonë. Kjo na nxjerr te një çështje tjetër që kërkon sqarim. Ishte Partia Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës e Shqipërisë) ajo që e pat themeluar Frontin Nacional Çlirimtar (sot Fronti Demokratik). Dhe kjo ishte rruga e drejtë. Te ne ka ngjarë e kundërta. Fronti i Kuq Popullor, i themeluar prej forcash patriotike, pret themelimin e partisë sonë komuniste marksiste-leniniste e cila do të vihet në ballë të

"Bota sot: Ju e thatë edhe më lart se pas vrasjes së Jusufit, Bardhoshit e Kadriut ka patur interpretime për personalitetin e Jusufit, është folur se ka qenë "marksist, komunist..." etj. Sa ju kanë lënduar juve si familje këto etiketime?

Hysen Gërvalla: Sigurisht se na kanë prekur. Jusufi kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, kurrë nuk ka qenë komunist. Jusufin e ka edukuar

nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike." (Bota Sot, 1 dhjetor 2006)

*luftës dhe të revolucionit. Sipas vlerësimeve të Frontit, arsyeja për këtë inverzion qëndron në kushtet konkrete, të cilat kanë ndikuar që forcat patriotike të masave të gjëra të ecin një hap përpara organizimit të komunistëve tanë. Në kështu konteksti e shohim aktivitetin e Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe të Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi - një organizatë e hershme, që ka mbledhur dhe mban rreth vetes njerëz me eksperiencë patriotike e revolucionare dhe me të cilën jemi duke bërë përpjekje për njohje reciproke dhe për bashkim. Në kështu konteksti jemi duke përcjellë gjithashtu edhe aktivitetin e Marksist-leninistëve të Kosovës, që po shfaqen këto kohët e fundit me organin e tyre "Liria". Duke u nisur nga kryeartikulli në numrin e parë të këtij organi, si dhe nga përmbajtja e tij përgjithësisht e nga trajtimi marksist-leninist i problemeve nga ana e krijuesve të "Lirisë", ne e vlerësojmë shumë të drejtë punën e Marksist-leninistëve kosovarë. **Kjo na jep shpresë që së shpejti, ndoshta pikërisht nga radhët e tyre, do të realizohet edhe kërkesa e domosdoshme për themelimin e vetë partisë komuniste marksiste-leniniste.***

*Donika Gërvalla: "Shtypja e vazhdueshme e popullatës në Kosovë nga ana e regjimit **komunist** jugosllav, nga artisti dhe gazetari Jusuf Gërvalla, bëri edhe veprimtarin politik Jusuf Gërvalla. Ai merr pjesë në lëvizjen ilegale, e cila ngjashëm me vendet e tjera të Evropës Lindore që vuanin nga regjimet e tyre diktatoriale përpiquej të mbronte dhe të realizonte të drejtat e popullatës ndaj shtypjes totalitare të regjimeve përkatëse." (www.gervalla.org, 2009)*

Për sa i përket strategjisë së ndjekur gjer më tash në luftë kundër socialshovinizmit jugosllav, ne kemi vlerësuar se pjesa më e madhe e grupeve dhe organizatave patriotiko-revolucionare shqiptare janë puqur në një pikë: në etapën e deritashme të luftës e të revolucionit tonë, ato i kanë dhënë armikut një grusht nga aspekti politik, duke bërë me veprimtarinë e tyre të ngritet vetëdija kombëtare e masave tona populllore. Vitet e fundit bashkë me vetëdijen kombëtare janë arritur rezultate të shënueshme edhe në ngritjen e vetëdijes klasore, që është një hap i madh cilësor drejt revolucionit. Këtë ua dimë për nder patriotëve e revolucionarëve tanë, që ditën ta përqafojnë e ta përhapin në masa literaturën revolucionare marksiste-leniniste, sidomos atë që po botohet në Tiranë dhe është bërë fener ndriçues edhe për forcat revolucionare në të gjithë botën.

Hysen GËRVALLA: "Qëllimet majtiste tani janë të kthjellëta si loti: ose do të ketë shtet siç mendon tradhtia, ose mos të formohet fare shteti i Kosovës." (Bota Sot, 12 mars 2003)

Mirëpo, vlerësojmë ne gjithashtu, tani ka ardhur koha që të kalohet në një etapë tjetër të luftës: në aksione të sinkronizuara për dëmtimin e armikut edhe në pikëpamje ekonomike e luftarake. Kështu sikurse strategjia, edhe taktika e deritashme, në rast të tillë, duhet t'ia lëshoj vendin taktikës së re. Në këso kushtesh bëhet edhe më i nevojshëm bashkimi i shpejt i organizatave tona patriotiko-revolucionare, të cilat, deri më tash, megjithë strategjinë e njejtë apo të ngjashme, kanë aplikuar taktika të ndryshme." (Bashkimi, janar 1981, faqe 2, shtylla 1)

Jusuf Gërvalla: "Mirëpo na habit qëndrimi i pacipë i disa forcave, të cilat ndjekin rrugën revolucionare, siç janë ta zëmë disa parti marksiste-leniniste. Pa informata të

sakta mbi historinë e popullit shqiptar dhe mbi gjendjen e mjeruar të shqiptarëve me banim në Jugosllavi, ato sikur duan të na e mohojnë gjithashtu të drejtën për luftë nacionalçlirimtare. Duke përdorur disa klishe prej arrivistësh të revolucionit, ata pëshpërisin: Ju duhet të veproni vetëm për ngadhënjimin e revolucionit proletar në Jugosllavi, jo ju duhet patjetër të zhvilloni një bashkëpunim internacionalist me serbët e malazezët, jo duhet të hiqni dorë nga vetëvendosja gjer në shkëputje dhe bashkimi me vendin amë, sepse vendi amë nuk e potencon kështu si ju çështjen tuaj, ju nuk keni të drejtë, e të tjera, e të tjera. Nga ana tjetër, kudo që u shfaqet rasti, ata nuk lënë pa propaganduar përkrahjen e tyre ndaj luftërave nacionalçlirimtare dhe revolucioneve." (Bashkimi, janar 1981, faqe 2, shtylla 3)

Jusuf Gërvalla: "Kështu do ta ruajmë edhe në të ardhmen njëri tjetrin: Shqipëria e PPSH dhe e shokut Enver Hoxha ne nga rreziku i çkombëtarizimit dhe i shfarosjes, dhe ne atë nga apetitet pansllave të Jugosllavisë; derisa të vijë edhe Nëntori i tretë - ai i bashkimit të plotë kombëtar dhe i jetës në liri e socializëm." (Bashkimi, janar 1981, faqe 3, shtylla 2)

-4. Në revistën *Lajmëtari i lirisë*

Hysen Gërvalla: "**Jusufi** kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, **kurrë nuk ka qenë komunist**. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike." (Bota Sot, 1 dhjetor 2006)

Jusuf Gërvalla; "Se anija jonë ka erë të mbarë, e cila do ta nxjerrë nga dallgët e stuhishme, dëshmon fakti se të gjitha organizatat patriotike shqiptare, që i janë vënë përballë deri më tash qeverisë fashiste të Beogradit, duke lëshuar përherë e më shumë rrënjë në popull, kanë pasur një drejtim dhe një platformë të vetme: çlirimin nga robëria jugosllave dhe bashkimin me vendin amë, Shqipërinë, të tillë çfarë është ajo, me Partinë e Punës në krye. Kështu, lëvizja jonë mbi të gjitha, na del edhe largpamëse: ajo ka zgjedhur një platformë politike dhe një ideologji, e cila do të jetë ideologjia e së nesërme së njerëzimit." (Lajmëtari i lirisë, gusht 1980, faqe 2)

Jusuf Gërvalla: "**Cila qenka platforma jonë?**

Përgjithësisht, ne përvetësojmë vijën ideopolitike të Partisë së Punës të Shqipërisë, me adaptime minimale, që implikohen aty-këtu nga gjendja jonë karakteristike. Përafërsisht këtë vijë ndoqën afro pesëdhjetë organizatat dhe grupet patriotike revolucionare të shqiptarëve të Kosovës, që armiku, fatkeqësisht, arriti t'i dëmtojë bukur shumë që tridhjetë e pesë vjet.

"**Bota sot:** Ju e thatë edhe më lart se pas vrasjes së Jusufit, Bardhoshit e Kadriut ka patur interpretime për personalitetin e Jusufit, është folur se ka qenë "marksist, komunist..." etj. Sa ju kanë lënduar juve si familje këto etiketime?

Hysen Gërvalla: Sigurisht se na kanë prekur. Jusufi kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, kurrë nuk ka qenë komunist. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike." (Bota Sot, 1 dhjetor 2006)

Kemi njoftime se armiku ynë shekullor, qeveria e Beogradit, për të dëmtuar luftën tonë të drejtë, e cila mund të arrihet vetëm duke përfillur idenë e një revolucioni të përgjithshëm socialist, djem nga radha e shqiptarëve ushtron dhe organizon në një ushtri iluzioniste, në ushtrinë e treqind partive shqiptare, që hanë bukën e imperializmit dhe

njëkohësisht ia zgjasin jetën qeverisë shoviniste të Beogradit. Lufta e emigracionit shqiptar, me rrënjë në imperializmin e kalbëzuar e me idenë e saj të përgjithshme shkatërrimin e Shqipërisë së sotme dhe të rezultateve të saj të shkëlqyera në avancimin e socializmit, jo vetëm që është luftë e huaj për ne, por ajo do të luftohet pa kompromis, sikundër që luftohet çdo fraksion armiqësor, që do të quhet dezertim nga e vetmja luftë e drejtë – revolucionin socialist.” (Lajmëtari i lirisë, nr.1, gusht 1980, faqe 16)

Jusuf Gërvalla: *”Si gjithmonë, edhe sot, pararoja jonë revolucionare dhe mbarë populli ynë, me sy e me zemër jemi të drejtuar nga nëna Shqipëri dhe presim çastin që fatin tonë do ta lidhë sërish me fatin e saj, si një pjesë e pandashme, për tërësinë e së cilës është derdhur gjaku i bijve martir të Shqipërisë ndër shekuj.” (Lajmëtari i lirisë, nr. 2, tetor-nëntor 1980, faqe 3)*

Jusuf Gërvalla: *”Mbi idetë dhe lëvizjet përparimtare asnjë popull nuk mund të vërë dorë përgjithmonë, ashtu si e vë njeriu kësulën në kokën e vetë të patjetërsueshme. Ku zënë fill, nga shtegtojnë dhe ku ngrehin çerdhe lejlekët e anës së ndriçuar të vetëdijes së Planetit, është punë që nuk mund të hetohet jashtë ligjshmërisë dialektike, dhe kjo ligjshmëri për të paditurin shfaqet përplot pusi.*

Hysen GËRVALLA: <i>”Qëllimet majtiste tani janë të kthjellëta si loti: ose do të ketë shtet siç mendon tradhtia, ose mos të formohet fare shteti i Kosovës.” (Bota Sot, 12 mars 2003)</i>

Ideja e madhe komuniste mori krah në Gjermani, me Marks në ballë. U avancua dhe materializua në Revolucionin e madh rus, të cilit i priu Lenini dhe të cilin e çoi përpara Stalini. Po pasi braktisi stepet e paskajshme, e pezmatuar në tradhtinë e akullt hrushoviane, ideja e madhe komuniste u strehua dhe nguliti në Shqipërinë e ’vogël’. Këtu gjeti prehje dhe truall të përshtatshëm për lulëzim të plotë. Së këndejmi fshikullon sot pa mëshirë imperializmin dhe social-imperializmin, ’eurokomunizmin’ fodull. Këtu u bë fener për proletarin, të nënshtruarin, të kolonizuarin. Kudo në botë. Sepse siç thotë poeti, Shqipëria është një magje lirisë, që formulën e lirisë nuk e mban sekret.” (Lajmëtari i lirisë, nr. 2, tetor-nëntor 1980, faqe 4)

Jusuf Gërvalla: *”Për fatkeqësinë e imperializmit, social-imperializmin e të social-shovinizmit, për fatkeqësinë e gjakësorit dhe të tradhtarit – bota anëmbanë po zien. Zien bota për fatbardhësinë e të shtypurit dhe të të shfrytëzuarit.” (Lajmëtari i lirisë, nr. 2, tetor-nëntor 1980, faqe 6)*

-5. Në letrën dërguar Enver Hoxhës

Jusuf Gërvalla: *”Po tash, meqë lufta jonë politike ka hyrë në fazën e vet përfundimtare, e cila po zhvillohet në favorin tonë, janë të domosdoshme edhe forma më të larta organizimi të aktivitetit revolucionar. Edhe nga kjo pikëpamje ne, me një vonesë të konsiderueshme, kemi arritur në përfundimin se luftës sonë i duhet një emërues i përbashkët dhe i fuqishëm..., është e domosdoshme një ndihmë konkrete nga ana e Partisë së Punës të Shqipërisë. Një ndihmë e tillë, konsiderojmë ne, është e drejtë e patjetërsueshme si për PPSH – në, ashtu edhe për djalërinë patriotike e revolucionare shqiptare në pjesën e robëruar të atdheut tonë të përbashkët.. Kështu do të përligjej dhe do të fuqizohej edhe lufta jonë e drejtë, po edhe përkrahja që do të merrnim nga PPSH. Ndihma, natyrisht nuk ka munguar as deri më tash. Literatura revolucionare dhe patriotike, që ka depërtuar në masë të madhe edhe te populli ynë këndeje, ka rëndësi të madhe dhe ka ushtruar ndikim të madh. Një rol të rëndësishëm ka luajtur deri më tash sidomos Radio Tirana me emisionet e saj. Dhe një nga masat më të qëlluara për afrimin*

dhe për ngritjen e vetëdijes kombëtare, shoqërore, politike e ideologjike të popullit tonë në pjesën e robëruar të Shqipërisë, konsiderojmë ne, ka qenë ajo e 28 Nëntorit të kaluar, qëkur shqiptarët në Jugosllavi mund ta ndjekin edhe programin e Televizionit Shqiptar. Mirëpo për t'ia dalë në mënyrë sa më të denjë dhe sa më efektive qëllimit tonë të lartë, mendojmë se në mesin tonë duhet të punojë një dorë e rysur komuniste, që do të na i transmetonte drejtpërsëdrejti bazat e shëndosha të veprimtarisë së një partie

Hysen Gërvalla: "**Jusufi** kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, **kurrë nuk ka qenë komunist**. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike." (Bota Sot, 1 dhjetor 2006)

komuniste marksiste-leniniste në kushtet e ilegalitetit të thellë. Nga ana jonë mund të themi se një gjë është fare e sigurt: njerëz përparimtarë nga të gjitha strukturat shoqërore te ne janë të gatshëm të punojnë pa kursyer asgjë për atdhe dhe për idetë e larta komuniste.

Pos kësaj, në mesin tonë dita ditës po nxjerr kokë një mendim i përgjithshëm: brezi ynë i sotëm e ndjen veten të thirrur ta bëjë një hap të madh përpara në luftën për liri dhe bashkim me vendin amë, në mos edhe ta realizojë përfundimisht revolucionin e pashmangshëm. Prandaj, të sigurt se kjo çështje është e denjë për kujdesin Tënd, të Partisë së Punës dhe të mbarë popullit shqiptar, ne presim që kërkesa e mbarështruar këtu për ndihmën e përmendur nga ana e PPSH-së, të hasë në mirëkuptim dhe të shqyrtohet në nivelin për të cilin do të konsideroni ju se është adekuat." (Letër Enver Hoxhës, 19 gusht 1980; Marrë nga libri i Faridin Tafallarit, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 98-99)

-6. Në artikuj teorik ende të pabotuar

Jusuf Gërvalla: "**Rruga e rezistencës më të vogël** - Historia e luftërave çlirimtare dhe revolucioneve ka treguar se lidhur me këtë çështje, në periudha të ndryshme kanë dalë divergjenca në lëvizjet revolucionare, që kanë çuar edhe në përçarje të plotë dhe në

Donika Gërvalla: "Shtypja e vazhdueshme e popullatës në Kosovë nga ana e regjimit **komunist** jugosllav, nga artisti dhe gazetari Jusuf Gërvalla, bëri edhe veprimtarin politik Jusuf Gërvalla. Ai merr pjesë në lëvizjen ilegale, e cila ngjashëm me vendet e tjera të Evropës Lindore që vuanin nga regjimet e tyre diktatoriale përpigjej të mbronte dhe të realizonte të drejtat e popullatës ndaj shtypjes totalitare të regjimeve përkatëse." (www.gervalla.org, 2009)

tradhtinë e teorisë marksiste-leniniste, si teoria më e përsosur e revolucionit, nga ana e revolucionarëve, që kanë qenë të prirur të ndjekin rrugën e rezistencës më të vogël, duke u përpjekur që pjesëzat e tërësisë t'i imponojnë si tërësi dhe qëllime të fundit. (...) Lëvizja revolucionare marksiste-leniniste synon dhe realizon krijimin e forcave të rregullta revolucionare, teorikisht të përgatitura dhe të lidhura në trajtë ingranazhi, që mund të sigurojnë vazhdimësinë e veprimtarisë revolucionare, ta përcaktojnë orientimin dhe koncentrojnë forcën goditëse të masave popullore e punonjëse, duke mos u zbrapsur e hutuar as në kohën e vlimeve të masës e as në kohën e tërheqjes së saj para brutalitetit të armikut - t'ia bëjnë armikut varrin e vërtetë." (Luftë të dëshpëruarish apo lëvizje të ndërgjegjshme?)

-7. Në letrat - raportet dërguar Sabri Novosellës

Jusuf Gërvalla: "Konkretisht në rrethinën e Shtutgartit janë nja 7 – 8 shokë të gatshëm e të përshtatshëm për punë patriotiko-revolucionare. Ata presin ndonjë orientim nga unë. Po unë duke qenë dhe vetë në mjegull për gjendjen time, nuk kam dashur t'i ngashënej e pastaj t'i lë në gjysmë të rrugës. Prandaj u kam folur për gjëra të përgjithshme në çështje të organizimit, të propagandës dhe të agjitacionit si dhe kam bërë përpjekje për t'ua dhënë elementet e domosdoshme shkencore të historisë kombëtare dhe të lëvizjes komuniste shqiptare e ndërkombëtare. Janë punëtorë dhe ma ka marrë mendja se në radhë të parë u duhet një ngritje e tillë ideore, politike e shkencore. ...

Hysen GËRVALLA: "Qëllimet majtiste tani janë të kthjellëta si loti: ose do të ketë shtet siç mendon tradhtia, ose mos të formohet fare shteti i Kosovës." (Bota Sot, 12 mars 2003)

Lidhur me këtë, për fillim, kemi zënë të organizojmë një varg demonstratash, nëpër qendra të ndryshme evropiane, që kanë për qëllim të bëhen përpjekje e zëshme e ngjarjeve aktuale në Kosovën tonë trime. Demonstrata e parë, shumë e suksesshme, është bërë para ambasadës jugosllave në Bern të Zvicrës, më 11 prill, në të cilën kanë marrë pjesë edhe shqiptarë nga RFGJ. Demonstrata e dytë do të mbahet po në Zvicër, në qytetin Cyrih, më 18 prill, kurse të tretën e kemi parashikuar në Shtutgart, aty nga 26 prilli. **Parullat e demonstratave kanë një përmbajtje thellësisht marksiste-leniniste dhe përkrahin deri në fund kërkesat e rinisë heroike të Kosovës për republikë (që nënkupton edhe përfshirjen e tokave dhe të popullsisë shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi e në Serbi). ...**

"Bota sot: Ju e thatë edhe më lart se pas vrasjes së Jusufit, Bardhoshit e Kadriut ka patur interpretime për personalitetin e Jusufit, është folur se ka qenë "marksist, komunist..." etj. Sa ju kanë lënduar juve si familje këto etiketime?

Hysen Gërvalla: Sigurisht se na kanë prekur. Jusufi kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, kurrë nuk ka qenë komunist. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike." (Bota Sot, 1 dhjetor 2006)

Kam pasur nderin të njihem edhe me sekretarin e parë të Partisë Komuniste Gjermane, njëkohësisht edhe kryetar i Shoqatës së Miqësisë Gjermani-Shqipëri dhe i kam dërguar një letër me lutjen që edhe ai me partinë e tij të shikojë ndonjë formë të përshtatshme ndihme për përkrahjen morale të popullit shqiptar të Kosovës. Ende s'kam marrë përgjigje prej tij, por shpresoj se megjithatë do të na ndihmojë patjetër, sepse për këtë i obligon drejtpërdrejt edhe artikulli i "Zërit të popullit" i datës 8 prill, se siç dihet, kjo parti e komunistëve gjermanë ka për busollë të vetme PPSH-në." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 259-260)

-8. Në revistën *Zëri i Kosovës*

Jusuf Gërvalla: "Prandaj, në mbrojtje të vullnetit sa e sa herë të ndrydhur e të nëpërkëmbur të popullit shqiptar në Jugosllavi, ne – një pjesë e pararojës patriotike e

Hysen Gërvalla: "**Jusufi** kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, **kurrë nuk ka qenë komunist**. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike." (Bota Sot, 1 dhjetor 2006)

komuniste të shqiptarëve të robëruar, që jemi organizuar në gji të **Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi** – dalim para popullit tonë, para opinionit jugosllav dhe atij botëror me këto kërkesa minimale të parevokueshme." (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 2)

Sabri Hamiti: "DONA - Kush janë ata t'u flas për babain tim. Asnjë fjalë. **Babain e kam njohur vetëm në Prishtinë. Duhet të kthehem atje për ta rinjohur. Jashtë nuk ka qenë i njëjti.** Ajo mbyllje në dhomën e tij në mansardë. Ai ballë i rrudhur, ajo buzëqeshje e tretur. Interesi i humbur për gitarën e vetë, për flautën time. Atëherë s'kam ditur gjë, tash e di si ia hëngrën shpirtin paknapak përditë. **Ai për mua kishte humbur në Gjermani.** Bishat ia hëngrën zemrën. Tash duan të ngjallen si kufomat e gjalla rreth hijes së tij. Jo. Nuk lejoj, nuk dua. Çka kanë bërë për të, asgjë. E kanë veshur vdekjen e tij me një vel të mjegullës, me peshën e territ. Jo! Pushim. **Ç'është ky vrap i mjerë i njerëzve që duan të gjejnë identitetin e vet te tjetri në vonesë kohe.**" (Misioni, Prishtinë 2007, f. 88-89)

"**Bota sot:** Ju e thatë edhe më lart se pas vrasjes së Jusufit, Bardhoshit e Kadriut ka patur interpretime për personalitetin e Jusufit, është folur se ka qenë "marksist, komunist..." etj. Sa ju kanë lënduar juve si familje këto etiketime?

Hysen Gërvalla: Sigurisht se na kanë prekur. Jusufi kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, kurrë nuk ka qenë komunist. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike." (Bota Sot, 1 dhjetor 2006)

Jusuf Gërvalla: "Një i burgosur politik kosovar paska deklaruar para do kohësh se është marksist-leninist i bindur; kur e pyesin më gjatë në hetuesi, ai gjoja qenka përgjigjur se nuk e ka lexua asnjë vepër të Leninit.

Kështu thotë Tanjugu dhe kjo mund të jetë e vërtetë, dhe, edhe po të jetë e vërtetë, s'ka krisur kiameti. Të burgosur politikë shqiptarë - vetëm pas ngjarjeve të përgjakshme të marsit dhe prillit - ka me mijëra, e të paktën janë 232 sish, të shpallur zyrtarisht, që kanë marrë dënime drakoniane. Dhe në mos të gjithë, në pjesën dërmuese po se po, në mos marksistë-leninistë të ngritur, këta të burgosur janë së paku ithtarë e dashamirës të marksizëm-leninizmit. Dhe kjo mjafton për fillimin e çdo lufte çlirimtare dhe të çdo revolucionit." (Zëri i Kosovës, nr.2, janar 1982, faqe 10)

Sa ju kanë lënduar juve si familje këto etiketime?

2. TI SI GJITHMONË MA MUND ME FJALË

- 1. UDHËTIM I TMERRSHËM - RRUGËS KALUAM MIRË
- 2. AI TAKIM I VËSHTIRË - GËZIMI YNË NUK PATI KUFI
- 3. NUK MBETËM VETËM
- 4. PO E LA BARDHYLI PUNËN
- 5. TI SI GJITHMONË MA MUND ME FJALË
- 6. E KA LANË PUNËN - NUK E KA LËNË PUNËN
- 7. THONË SE JANË NJË LULI E NJË KEQA
- 8. PROPAGANDË QESHARAKE
- 9. GAJRETI I GJERGJIT PËR POPULLIN E PATREMBUR
- 10. GAJRETI I GJERGJIT PËR JUSUFIN E TREMBUR

-1. UDHËTIM I TMERRSHËM - RRUGËS KALUAM MIRË

S. H.: "Isa – Ai udhëtim i tmerrshëm për një natë me Gjergjin." (f.14)

Jusuf Gërvalla: "Kah ora dy pas mesnate, tashmë ditë e shtunë, i trokita në derë Skënder Blakajt. Me veturën e tij shkuam në Pejë, e morëm Salih Kastratin, dhe u nisëm për Jesenice, në kufirin jugosllavo-austriak. Rrugës kaluam mirë. Ata më lanë në oborr të Bacit Haxhi, kështu ishim marrë vesh dhe shkuan." (Vepra, vëll. 4, Prishtinë 2010, f.246)

-2. AI TAKIM I VËSHTIRË - GËZIMI YNË NUK PATI KUFI

S.H.: "Ai tunel që s'i shihej fundi... Ai takim i vështirë me Bardhylin..." (f.14)

Jusuf Gërvalla: "Bardhi s'kishte sjellë me vete ndonjë dokument të vyer për mua, mirëpo, me ardhjen e tij, unë u çlirova shumë. Para dreke bëmë ca plane, më në fund vendosëm që për Austri të ikja më këmbë, nëpër tunelin që shpie nga Hrushica (4-5 km larg Jesenice) deri në Rozenbah të Austrisë.

....Bardhin, sipas marrëveshjes, e prita te ura e parë e hekurudhës që pritej me rrugën automobilistike, 20-30 km nga dalja e tunelit. Fshati i parë që shihej nga ai vend në mal, ishte një 500 m më poshtë. Prita afro një, një orë e gjysmë, kot. Atëherë iu drejtova me frengjishten time të mjerë të zotit të veturës së parë që kaloi atypari në një si depo-uzinë. Ai s'e dinte frengjishten, por për fat fliste sllovenisht gati më mirë se unë. Ai me çoi me veturë deri në Rosenbach (tetë km) ku u takuam me Bardhin, që ishte nisur kah vendi tek e prisja unë.

Gëzimi ynë s'pati kufi." (Vepra, vëll. 4, Prishtinë 2010, f.246-247)

-3. NUK MBETËM VETËM

S. H.: "ISA – Po në Prishtinë ishit krejt vetëm?

ZANA – E kishim Gjergjin." (f.16)

-4. PO E LA BARDHYLI PUNËN

S.H.: "ISA – Bardhylin do ta mbysin fjalët." (f.16)

Bardhoshi më ka treguar, në verë 1981, se ai qysh sa ka qenë Jusufi në Kosovë e ka marrë vesh angazhimin e tij (J.G.) në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi" dhe gjithmonë ka qenë i përgatitur se mund të ndodhë që Jusufi të detyrohet ta kërkojë mbështetjen e tij në Gjermani. Ngjarjet e mesit të dhjetorit 1979 nuk kanë qenë kurrfarë befasi për Bardhoshin.

S.H.: *"ZANA – Po e la Bardhyli punën kush na e jep një kafshore buke."* (f.17)

Jusuf Gërvalla: *"E hënë, 14 janar, ora 00,45 (Ludwigsburg) Sot do të paraqitem me kërkesë për azil politik në policinë e Ludwigsburgut."* (Vepra, vëll. 4, Prishtinë 2010, f.250)

Në ditën e njëmuororit të arratisjes së Jusufit nga Kosova, më 14 janar 1980, Jusufi kërkon azil politik në policinë e Ludwigsburgut. Kjo do të thotë se prej 14 janarit 1980 e deri në vdekjen e tij Jusufi e më vonë familja e tij, nuk është barrë ekonomike e vëllaut të vet dhe askujt tjetër pos shtetit gjerman, të atij shteti që ia ofroi një jetë aq të qetë e aq pa brenga nga pikëpamja ekonomike, pa i kërkuar asgjë si kundërkompensim. Këto kushte ia mundësuan Jusufit të bënte atë aktivitet aq të dendur e të furishëm që e bënë të padurueshëm për Jugosllavinë.

S.H.: *"ISA – Kurrkush nuk vdes këtu për një kafshore buke. ... Nuk kanë vdekur të gjithë shqiptarët, jo!"* (f.17)

-5. TI SI GJITHMONË MA MUND ME FJALË

S. H.: *"ISA – Të egër janë tanët.*

ZANA – Këta janë të dreqit.

GJERGJI – A doni mysafir?

ISA – Dera është e hapur për...

GJERGJI – E hapur po me dryna...

ISA – Ti si gjithmonë ma mund me fjalë. Pushim.

ZANA – Jemi ngujuar me njëqind dryna.

GJERGJI – Ç'është kjo vranësinë. Mos kam ardhur në çast të ligë.

GJERGJI – Isë, çka po ngjet kështu?" (f.18-23)

Citati më lartë i ka disa shkurtime. Fjalët "Ti si gjithmonë ma mund me fjalë" të Sabri Hamitit në raport me Jusufin, janë krejtësisht të njejta me fjalët e Ibrahim Kelmendit, kur ai si nip i dajës Ramë, tregon se si Jusufi i paska thënë ma bëre shah-mat. Përgjigjen e shah-matit e kam dhënë në një kapitull që quhet "Simultanka dhe shah-mati i Jusuf Gërvallës". A do të jetë ky shkrim, kjo përgjigje e imja Sabri Hamitit identike me Simultankën, këtë nuk mund ta them, megjithëse dëshira dhe përpjekja ime ka qenë që të jetë si ajo.

-6. E KA LANË PUNËN - NUK E KA LËNË PUNËN

S. H.: *"ISA – Jetojmë keq, të izoluar. Pak të holla që kemi i harxhojmë të shtypim gazeta. Bardhyli e ka lënë punën. Nuk e lanë. Unë e kam të ndaluar lëvizjen. Këtu vjen rrallë kush. Edhe ata që vijnë flasin egër. Më përflasin, më thonë tradhtar, i dërguar. Ruhem para saj, ruhem para fëmijëve."* (f.23)

Bardhi nuk e ka lënë punën vet dhe as nuk ka pasur kurrfarë pengesash prej punëdhënësit të vet. Bardhoshi, duke i ndihmuar Jusufit si vëlla dhe si aktivist shumë i

dalluar politik për të drejtat e popullit të vet dhe të punëtorëve ka vepruar pikërisht në atë frymë që e ka kërkuar vendi i tij i punës. Bardhoshi në Gjermani ka qenë punëtor social në atë që gjermanisht quhet Arbeiterwohlfahrt.

Arbeiterwohlfahrt (AWO)

Bashkimi për Mirëqenien e Punëtorëve (AWO) është organizatë e decentralizuar bamirëse gjermane, e ndërtuar në bazë të anëtarësimeve personale në shoqata lokale. Me rreth 145.000 të punësuar me orar të plotë është një ndër punëdhënësit më të mëdhenj në Gjermani. Detyra e tij kryesore është t'u ndihmoj në pikëpamje sociale njerëzve në gjendje të vështirë.

Është themeluar më 13 dhjetor 1919, pikërisht 60 vjet para se Jusuf Gërvalla më 14 dhjetor 1979 detyrohet të arratiset nga Kosova. Pas marrjes së pushtetit prej Adolf Hitlerit, organizata ndalohej. Disa aktivist të saj vazhduan punën në ilegalitet, siç ishte Joan Kirchner, i cili u ndihmonte aktivistëve të rrezikuar të lëvizjes punëtore të shkonin në ekzil.



**Vendi i punës së Bardhosh Gërvallës: Solitudestr. 44,
Ludwigsburg
Telefoni: 07141-26091**

Pas Luftës së Dytë Botërore AWO, në Hanover, formohet si një Organizatë ndihmëse (Hilforganisation), e pavarur në pikëpamje politike dhe religjioze. Në zonën e okupuar nga Bashkimi Sovjetik, dhe më vonë në Republikën Demokratike Gjermane (DDR)

veprimtaria e saj ndalohej. Pas ribashkimit AWO vepron në të gjithë vendin. Zyra qendrore e AWO është në Berlin.

S.H.: "ISA – Sa kam hequr ta fus Bardhylin në këtë rrugë." (f.23)

Këto fjalë të turpshme nuk i ka shqiptuar kurrë Jusufi. Këto janë fjalë ofenduese për Jusufin dhe po aq edhe për Bardhoshin.

-7. THONË SE JANË NJË LULI E NJË KEQA

S. H.: "GJERGJI – Kush qenkan këta?

ISA – vijon me zë të ulët. Thonë se janë një **Luli e një Keqa**. Kurrë s'i kam parë. Kanë mbi kokë një tjetër që i thonë Sofë. Po të gjitha fjalët sillen rreth një I Padukshmi, të tjerët i thonë Jusi. Të tjerët i bartin fjalët e tyre...

GJERGJI – Që ti je tradhtar? (f.23-24)

-8. PROPAGANDË QESHARAKE

S.H.: "ISA – Edhe këtë, edhe atë. Por shërbime lypin. **Donë gazeta e janë gjysmanalfabetë**. Shihe çfarë shkruajnë! Ia nxjerrë parasysh një letër. Parulla, propagandë qesharake. Këngë për traktorin, vaje për Kosovën, himne për Shqipërinë, këngë për Të Madhin. Më duhet të ndreq diçka." (f.24)

-9. GAJRETI I GJERGJIT PËR POPULLIN E PATREMBUR

Jusuf Gërvalla: "ME SY E ZEMËR NGA NËNA SHQIPËRI

Në qoftë se epoka e lavdishme e Skënderbeut nxori në pah një përmasë të rëndësishme të shpirtit të popullit tonë; gatishmërinë për flajm në shkallën më të lartë dhe frymëzimin e papërsëritshëm për mbrojtjen e atdheut, mund të thuhet se epoka e sotme shqiptare e Partisë së Punës dhe e Enver Hoxhës jo vetëm që konfirmoi të parën, por sheshoi edhe një përmasë tjetër, të ndryrë deri në tash në ndërdije nga shekujt e robërisë dhe historia njerëz, etjen e madhe të shqiptarit për punë dhe për ndriçimin e plotë të mendjes. Sot doli në shesh Njeriu i Ri, vërtet nga gjiri i një populli të vogël, por i pari që të bëhet shembull në botë.

Skena e dramës së sotme shqiptare është po ajo e para 500 vjetëve, kur Shqipëria bënte luftën e prometheut kundër të gjithë perëndive. Atëherë ishte bota e krishterë ajo që e pat nisur luftën kundër kuçedrës anadollake. Dhe, posa u duk se ajo botë po e bekonte titanin Skënderbe i cili më në fund i çonte në vend edhe interesat e Evropës, fuqitë e kohës ia kthyen shpinën heroit tonë në tradhti nga më mizoret dhe jepnin me të madhe edhe porosi e para për eliminimin e tij. (Sikur kishte diçka që nuk durohej te personaliteti i **GJERGJIT** dhe i gjithë popullit shqiptar; ndoshta serioziteti dhe këmbëngulja mbinjerëzore që çështjen e shtrenjtë të lirisë e bënte të kuptohej në gjithë njërendisinë e saj.

Kësisoj u sprapsën edhe forcat e djeshme komuniste, të cilat në vallen e madhe të komunizmit patën hyrë përpara Shqipërisë së "vogël". Kjo Shqipëri e "vogël", në njërendësinë e saj të madhe në luftë për zhvillimin dhe pavarësinë e plotë të vendit si dhe për avancimin dhe mbrojtjen e çështjes së madhe komuniste, revizionistëve ua mori gjithë merakun – në kushte të luftës me një intensitet që ato s'e kishin parë e s'e kishin menduar.

Marrëveshjet paqësore dhe krushqitë e dikurshme të Venedikut e të Serbisë me vezirë e sulltanë, në një kohë që Shqipëria martire po e lante në gjak çdo pëllëmbë të tokës së vet në luftë kundër fuqisë më të madhe të epokës, nuk ndryshojnë aq shumë nga tradhtia jugosllave, sovjetike, kineze... që tradhtuan komunizmin, duke mos qenë të gatshme t'i bëjnë ballë frymëzimit të lartë marksist-leninist dhe duke parapëlqyer rrugën e rezistencës së ulët ndaj armikut të epokës- imperializmit dhe kapitalizmit.

Ne, shqiptarët e shkëputur me dhunë nga trangu i Atdheut tonë të shenjtë, që dhuna na mbërtheu brenda kufijve politikë të Jugosllavisë, ndjekin krenarë çdo hap të Shqipërisë nënë në formimin dhe përparimin e Atdheut dhe të çështjes së madhe komuniste. I gëzohemi çdo prove të suksesshme të unitetit të pathyeshëm të partisë me popullin, e kjo na bën edhe ne më të fortë. Mburra e entuziazmi ynë s'kanë kufi kur kujtojmë që Shqipëria, nga një vend i varfër dhe i prapambetur feudo-borgjez, tash është kthyer në një vend të përparuar e të zhvilluar, pa analfabetizëm e papunësi, ku kultivohet socializmi i mirëfilltë, në një vend, që jo vetëm po ia del ta ruajë të paprekur kështjellën e marksizëm-leninizmit, po edhe të ndezë shkëndija revolucionare te pjesa më e madhe e popujve të botës. Pa frikë se biem në ndonjë eufori të palejueshme, ne jemi të bindur se nesër, kur këto shkëndija të kthehen në zjarre të vërteta revolucionare, bota do t'ia njohë një pjesë të madhe të meritave pikërisht Atdheut tonë, Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Do të jetë dashur një punë e mundimshme tej mase për të arritur në shkallën e sotme. Jemi në dijeni për një pjesë të konsiderueshme problemesh me të cilat janë ballafaquar PPSH dhe populli shqiptar në rrugën e tyre të ndritshme. Ajo që na krenon dhe na jep shpresë më së shumti, është fakti se, në gjithë këtë punë prej titani, PPSH dhe populli shqiptar i lirë, në udhëkryqin e njëres nga sprovat më të mëdha historike, ka zgjedhur rrugën e nderit dhe të guximit të pashoq, në të cilin është mësuar ndër shekuj populli ynë i shumëvuaftur, rrugën, e cila Atdheut tonë i jep dorë të bëhet tribunë e fuqishme e idesë përparimtare dhe e lirisë për të gjithë popujt e botës, duke ndarë si me thikë të mirën nga e liga.

Ne ndjekim me indinjatë të thellë bllokadën e ligë ndaj Shqipërisë, të nisur nga imperializmi e kapitalizmi dhe të vazhduar egërsisht nga revizionizmi modernë. Por, zemra na bëhet mal kur shohim që Atdheu ynë marshon sypatrembur, duke çarë një pas një rrethinat e bllokadat mizore dhe duke ndjekur me frymëzim e besnikëri të pashembullt rrugën e socializmit, që është e nesërmja e të gjithë njerëzimit.

Në sajë të ekzistimit të kësaj Shqipërie të mbarë, të fortë e vigjilente dhe në sajë të shpirtit të paepur luftarak të popullit tonë në përgjithësi, edhe ne – shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare brenda kufijve politikë të Jugosllavisë – ndonëse jemi dëmtuar në një farë mase nga shtrëngimi i darëve të social-shovinizmit serbo-malazezomagedonas, kemi qëndruar dhe ia kemi dalë të ruhem nga ujërat e zeza ideologjike të revizionizmit titist-rankoviçist. Larg ndjenjës shoviniste a revanshiste, që ka mundur të bëhet pasojë e të zezave që kemi hequr me dekada nga armiku barbar, te ne është ndezur xixa e luftës së pashmangshme nacionalçlirimtare, konturet e së cilës po duken qartë në horizont.

Të nxirret pjesa e robëruar e tokave dhe e popullit shqiptar nga kthetrat e përgjakshme të social-shovinistëve titistë dhe të çohet në vend vullneti i nëpërkëmbur i popullit tonë të shumëvuaftur; bashkimi me vendin amë, është e drejtë historike që iu mohua – po pa iu çrrënjësuar kurrë popullit tonë të vënë në shekuj përballë padrejtësive të mëdha historike.

Në dëshmi të përpjekjeve dhe të luftës sonë flasin, pos të tjerash, vetë kampet jugosllave të përqëndrimit me barkun e tyre të errët e të akullt, që s'po pushon së

gëlltituri që dyzet vjet me qindra e mijëra patriotë e revolucionarë shqiptarë. Flet vetëdija e zgjuar kombëtare dhe klasore e shqiptarëve me banim në Jugosllavi. Na bën të fortë fakti se PPSH me shokun Enver në krye, jo vetëm që kanë ndjekur në hap të gjitha konjugacionet e gjenocidit sllavofil të ushtruar mbi ne, por kanë qenë edhe të vetmit denoncues të këtij gjenocidi në sy të botës.

Hysen Gërvalla: "Dhe kur e panë se pak kush ishte i gatshëm të kacafytet me përbindëshat (Shqipëri e Enverit e Jugosllavi e Rankoviqit) që natën bashkëpunonin e ditën shaheshin, i përvolën mangët dhe u futën të gjallë në zjarrin që përvëlonte." (Intervistë dhënë Jusuf Ferizit, Bota Sot, 10 mars 2003)

Deri sa ne na kanë zhdukur masivisht si "ballistë" dhe deri sa kemi duruar urie, deri sa ne kemi shikuar me sedër të vrarë kombëtare si zbret dhe si na ndalohej flamuri shqiptar me të cilin i kishim çliruar tokat tona, deri sa nga vatrat tona të dashura na kanë dëbuar me tortura e shantazhe, me një fjalë, gjithë kohën që ne kemi shijuar mjetet më të egra të gjenocidit nga ana e social-shovinitëve titistë, i vetmi sadijskion për ne ka qenë forcimi dhe zhvillimi i mbarë Shqipërisë nënë dhe denoncimi nga ana e saj i të zezave të zbrazura me rrebesh mbi kokën tonë. Dhe në vend të ndjenjës së braktisjes nga Shqipëria nënë (këtë ndjenjë provoi një kohë të gjatë ta injektonte në ne gënjeshtria e ligë titiste), qenien tonë e mbushi ndjenja e fuqishme se nuk jemi vetëm dhe ka kush na del zot, ka kush e davarit mjegullën, me të cilën titistët menduan ta mbështillnin historinë tonë të vërtetë dhe planet e tyre shtetërore për shfarosjen e shqiptarëve.

Si gjithmonë, edhe sot, pararoja jonë revolucionare dhe mbarë populli ynë, me sy e me zemër jemi të drejtuar nga nëna Shqipëri dhe presim çastin që fatin tonë do ta lidhë sërish me fatin e saj, si një pjesë e pandashme, për tërësinë e së cilës është derdhur gjaku i bijve martirë të Shqipërisë ndër shekuj." (Lajmëtari i lirisë, Nr.2, tetor 1980, f. 3)

-10. GAJRETI I GJERGJIT PËR JUSUFIN E TREMBUR

S. H.: "GJERGJI – Kush qenkan këta?

ISA – vijon me zë të ulët. Thonë se janë një Luli e një Keq. Kurrë s'i kam parë. Kanë mbi kokë një tjetër që i thonë Sofo. Po të gjitha fjalët sillen rreth një I Padukshmi, të tjerët i thonë Jusi. Të tjerët i bartin fjalët e tyre...

GJERGJI – Që ti je tradhtar?

ISA – Edhe këtë, edhe atë. Por shërbime lypin. Donë gazeta e janë gjysmanalfabetë. Shihe çfarë shkruajnë! Ia nxjerrë parasysh një letër. Parulla, propagandë qesharake. Këngë për traktorin, vaje për Kosovën, himne për Shqipërinë, këngë për Të Madhin. Më duhet të ndreq diçka."

GJERGJI – Këto fjalë më sollën këtu si pakrye. Ata farë tipash duhet t'i takosh sa më shpejt, përndryshe shkove keq ti dhe më keq familja." (f.23-24)

VETËM AI MË KA MBETUR I ZEMRËS DHE I BESËS

S.H.: "ISA – i trembur. Të lutem mos fol gjë përpara Bardhylit, mos ma zbraps. Vetëm ai më ka mbetur i zemrës dhe i besës.

GJERGJI: Po ti, bre djalë, nuk mundesh kundër gjithë botës dhe tinëz familjes, asgjë. Je në rrezik nga të dyja anët." (f.24-25)

3. GEGA IA SJELL JUSUFIT POROSINË NGA KADRI ZEKA DHE KEQA

- 1. NUK VARET GJITHË SHQIPTARIA PREJ SHTËPISË SONË
- 2. NA BEFASOI DHE KRIJOI TË ÇARA NË MESIN E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE
- 3. NA BEFASOI DHE KRIJOI UNITET NË MESIN E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE
- 4. ME HYSENIN E PRITËM BASHKË VITIN E RI 1980
- 5. TASH SË FUNDI JAM NË KONTAKT
- 6. ME HYSENIN NUK E PRITËM BASHKË VITIN E RI 1981

-1. NUK VARET GJITHË SHQIPTARIA PREJ SHTËPISË SONË

S. H.: *"ZANA –Kjo po teprohet. Nuk varet gjithë bota e shqiptaria prej shtëpisë sonë! Ne duhet të jetojmë."* (f.29)

Sabile Keçmezi-Basha: *"Gjatë viteve 1945-1990 në ish-Jugosllavi shqiptarët kaluan në burgje 666 shekuj, 72 vjet e 7 muaj burgim."*

Hysen Gërvalla: *"Dhe kur e panë se pak kush ishte i gatshëm të kacafytet me përbindëshat (Shqipëri e Enverit e Jugosllavi e Rankoviqit) që natën bashkëpunonin e ditën shaheshin, i përvolën mangët dhe u futen të gjallë në zjarrin që përvëlonte."* (Intervistë dhënë Jusuf Ferizit, Bota Sot, 10 mars 2003)

Sabile Keçmezi-Basha: *"Gjatë viteve 1945-1990 në ish-Jugosllavi shqiptarët kaluan në burgje 666 shekuj, 72 vjet e 7 muaj burgim."*

-2. NA BEFASOI DHE KRIJOI TË ÇARA NË MESIN E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE

Këtu e kam marrë një pjesë nga libri im "Lëvizja e Jusuf Gërvallës" për ta ilustruar se si Shkolla e Abdullah Prapashticës dhe nipit të tij Faton Topallit, në Ambasadën e Kosovës në Bern, më 26 shkurt 2011 e kanë sqaruar çështjen se kush ka krijuar të çara në familjet e dëshmorëve.

Për raportin tim me familjet e Vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla nga 21 janari deri më 28 mars 1982 kam folur në disa punime tjera në faqen www.pashtriku.org.

Plani i Partisë Komuniste (PKMLSHJ): *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës“ i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave, krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve, por edhe në mesin e mërgimtarëve."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)

Përkundër faktit se Nuhi Sylejmani, sipas Partisë Komuniste-PKMLSHJ, para 21 janar 1982 më paska takuar vetëm njëherë, thotë se influenza ime në shtëpinë e Jusufit paska qenë aq dominuese sa Suzana e paska harruar apo nuk paska qenë fare në dijeni për asnjë detaj të veprimtarisë së Jusufit e Bardhit, i cili mund të ketë qenë vendimtar për qëndrimet e saja nga 18 janari e deri më 28 mars 1982. Në këtë pikë taktika për ta paraqitur Suzanën krejtësisht të painformuar është e njëjtë me të Ibrahim Kelmendit. Por këtu edhe përfundojnë ngjashmëritë në mes shokut të Sadik Blakajt dhe ish policit politik Abdullah Prapashtica, sepse nga shqyrtimi na del se përderisa Jusufi e lenë Suzanën krejtësisht të

painformuar, ish polici politik, gruan e tij e ka bërë Kryetare të Organizatës së grave "Komuniste" në Partinë e tij.

Lidhur me atë se çfarë ndikimi e çfarë influence mund të kem pasur në familjen e gjerë Gërvalla, apo vetëm tek familja e ngushtë e Jusufit, prej 21 janarit deri më 28 marsi 1982 dhe prej 28 marsi 1982 deri më sot, flasin faktet e mëposhtme.

Hysen Gërvalla: *"Po që se ky bashkim nuk arrihet, do të vërtetohet edhe njëherë se në mesin tonë ka njerëz që punojnë për armikun, do të vërtetohet papjekuria jonë në çështjen e madhe, e cila duhet të qëndroj mbi çdo interes personal dhe mbi çdo tendencë individuale dhe subjektive."*

Duhet t'ua theksojmë shokëve të ndershëm që të marrin drejtqëndrimin dhe ta thonë fjalën e vet, çdo njëri në emër të kësaj çështjeje të madhe, të distancohet secili pa ngurrim, pa humbur kohë dhe pa luhatje prej grupeve, prej dinastive, familjarizmit, bajraktarizmit, përkatësive primitive fisnore e të odës dhe mbi të gjitha prej "Krerëve" që pengojnë bashkimin; ta thotë secili fjalën e vet haptas, mendimin e vet të lirë e konstruktiv, sepse siç ka theksuar Ismail Qemali, çdo shqiptar i ndershëm ka të drejtë të flasë në të mirë të kombit dhe atdheut."

Nder i madh është të përcaktohesh në shërbim të atdheut, ndërsa tradhti të vihesh në shërbim të individëve destruktivë, sepse forca qëndron në masë e jo në grupe e as individë." (Letër e hapur - Tri grupeve, respektivisht organizatave që luftojnë në emrin e LRSSHJ-së, 12 korrik 1985)

Plani i Partisë Komuniste (PKMLSHJ): *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës“ i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave, krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve, por edhe në mesin e mërgimtarëve."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)

Xhafer Durmishi: *"Nga ti, Hysen Gërvalla e kemi marrë një letër të datës 12 korrik 1985. Ne e analizuam atë me kujdes, e lexuam disa herë, dhe këtu më poshtë po të japim përgjigjen tonë në letrën tuaj të datës së lartpërmendur."*

Ne e dimë se jeni vëllau i madh i dy vëllezërve që u vranë më 17 janar 1982 pranë Shtutgartit. Ky është një fakt shumë domethënës dhe i mirë për ne të gjithë, por për shkak të luftës sonë, karakterit të saj, fazave të zhvillimit të saj, vetëm kjo e dhënë nuk mjafton që ne të merremi vesh në të gjitha pikat." (Përgjigje Hysen Gërvallës, 22 korrik 1985)

Plani i Partisë Komuniste (PKMLSHJ): *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës“ i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave, krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve, por edhe në mesin e mërgimtarëve."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)

Emrush Xhemaili: *"1985: Hysen Gërvalla kooptohet në Komitetin Qendror të LPRK-së."* (20 vjet veprimtari 1982-2002)

Faridin Tafallari: *"Fjalën e mori Plaku (Hasan Mala - shën i Xh. D.), që shprehu gëzimin se puna jonë po vlerësohej edhe nga vëllezërit tanë të Shqipërisë. "Ne Bacë - tha ai - duke ju drejtuar Hysenit (Gërvallës - shën i Xh. D.) - jemi me ty dhe ti na ke mbrapa me gjithë këta shokë dhe na prij ashtu siç është më mirë, se rrugë tjetër nuk kemi; vetëm me unitet të çeliktë mund të ecim përpara."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 97)

Fjalët e mësipërme të Faridinit kanë të bëjnë me vjeshtën 1985.

Plani i Partisë Komuniste (PKMLSHJ): *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës“ i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave, krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve, por edhe në mesin e mërgimtarëve."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)

Faridin Tafallari: *"Sot më 16 janar (1986-shën i Xh. D.) Baci (Hysen Gërvalla-shën i Xh. D.) më telefoni dhe më tha se po ndahej politikisht me ne. Ky ishte shkaku pse nuk pranoi të dilte në protestën dhe në marshimin përkujtimor të katërvjetorit të rënies së*

shokëve. *"Unë nuk shkoj pas Hasan Malës e të tjerëve. Me shokët e mi do të dalë nesër më 17 janar."* (faqe 105)

Plani i Partisë Komuniste (PKMLSHJ): *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës“ i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave, krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve, por edhe në mesin e mërgimtarëve."* (Nuhi Sylejmani, *Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010*, faqe 158)

Faridin Tafallari: *"Më 21 shtator (1987 -shën i Xh. D) në mbrëmje vonë u ktheva nga Zvicra. Isha në vizitë te Hysen Gërvalla; vizitën e bëra më shumë për Suzanën që kishte ardhur nga Shqipëria. ... Baci (Hysen Gërvalla - shën im) vazhdonte me akuza të ulëta kundër Hasan Malës dhe të tjerëve. ... I thash edhe Suzanës që të shkonte te Hasan Mala. Por edhe ajo nuk kishte fjalë të mira për ata që merreshin nëpër gojë. ... Mbeta vetëm me Hysen Gërvallën, i cili m'u drejtua kështu: "Unë e demaskova Xhafer Durmishin, Ibrahim Kelmendin se ashtu e bënë punën..." (Terror-Dhimbe-Qëndresë, 1997, faqe 114-116)*

Sabri Hamiti: *"ZANA (Suzana Gërvalla shën i Xh. D.), pa përfillje. Nuk kam çka sugjeroj në mënyrë të veçantë. Sa për miqtë e Isës, ai i ka pasur dy miqë të mirë, Nakun e Gjergjin. Ata mund t'ju flasin çka e vlen, për veprën e tij."* (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 83-84)

Plani i Partisë Komuniste (PKMLSHJ): *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës“ i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave, krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve, por edhe në mesin e mërgimtarëve."* (Nuhi Sylejmani, *Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010*, faqe 158)

Sabri Hamiti: *"ZANA (Suzana Gërvalla - shën i Xh. D.), me mëdyshje. (për Saime Isufin - shën i Xh. D.) S'e kam takuar kurrë. As në shtëpi nuk më ka qenë. Jemi ndarë jo mirë, në kohën kur po mirreshim me varrimin. Ishte fort luftarake, s'donte të ndiente për dhimbjen, apo luante ashtu. Shtronte kërkesa bashkë me Keqën, por nuk bënte gjë prej gjëje. Tash kam mirëkuptim për të. Ka qenë tepër e re dhe e padijshme."* (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 94)

Suzana Gërvalla: *"Nga ora 22,00 (Jusufi dhe Kadriu) zbritën (nga dhoma e punës në katin e tretë në dhomën e ditës në katin e parë-shën i Xh. D.). Unë e kisha bërë darkën. Kadriu ishte martuar dy javë përpara. (Kadriu tha) Unë duhet patjetër me e lajmërua gruan se nuk kthehem sonte. Jusufi i tha le o burr se jemi në luftë, mos e mëso gruan ashtu e mos na nxirrë natën me dalë veç për telefon. Ne nuk kishim telefon të shtëpisë. Na thirrshin e (provokonin UDB-ja), se shumë na thirrshin. Bardhi i tha ani se po të çoj. Sa dolën te dera Jusufi tha hajt se po vi edhe unë. Se Jusufin nuk e lenin fortë natën me u endë. Shokët e ruanin shumë. Kanë dalë te dera. Kur dolën **boll inatë më erdhi që doli Jusufi**. (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo, YouTube, 3 gusht 2017, koha në film 8:30-10:00)*

Hysen Gërvalla: *"Pasi dolën në Perëndim bënë përpjekjet e para për dialog kombëtar e njerëzor me "krerët" e OMLK-së dhe të grupimeve tjera që u përngjanin tufave të deleve, duke u përpjekur t'i ofrojnë mërgimtarët, t'i largojnë nga kursi ideologjik, në mënyrë që të viheshin të gjithë në binarë kombëtarë. Fatkeqësisht, gjithë këto përpjekje dështuan, sepse tufat e deleve që i kishte organizuar Enver Hoxha nëpër kruzhoqet partiake, ishin me tru të shpërlarë. Megjithatë, Jusufi e Bardhoshi nuk u ndalen. Dhe, deri në ditën kur u vranë nuk pushuan së insistuari për një pajtim të arsyeshëm e të qytetëruar...."*

...Gjatë takimeve të LNÇKVSHJ-së (Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi, e udhëhequr nga Jusuf Gërvalla) me përfaqësues zyrtarë të Tiranës, doli hapur se diktatori Enver Hoxha nuk ishte i interesuar për forcimin e Lëvizjes Kombëtare, por për formimin dhe zgjerimin e organizatave komuniste në diasporë. Për

këtë shkak dështojnë edhe bisedimet për bashkim në mes të Lëvizjes Kombëtare të Jusufit dhe OMLK-së se Hydajet Hysenit, që u mbajtën në Stamboll në tetor të vitit 1981." (Intervistë dhënë Jusuf Ferizit, Bota Sot, 10 mars 2003)

Plani i Partisë Komuniste (PKMLSHJ): *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës“ i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave, krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve, por edhe në mesin e mërgimtarëve." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)*

Hysen GËRVALLA: *"Qëllimet majtiste tani janë të kthjellëta si loti: ose do të ketë shtet siç mendon tradhtia, ose mos të formohet fare shteti i Kosovës." (Bota Sot, 12 mars 2003)*

Sabri Hamiti: *"ZANA (Suzana Gërvalla shën i Xh. D.), pa përfillje. Nuk kam çka sugjeroj në mënyrë të veçantë. Sa për miqtë e Isës, ai i ka pasur dy miqë të mirë, Nakun e Gjergjin. Ata mund t'ju flasin çka e vlen, për veprën e tij." (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 83-84)*

Plani i Partisë Komuniste (PKMLSHJ): *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës“ i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave, krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve, por edhe në mesin e mërgimtarëve." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)*

Sabri Hamiti: *"ZANA (Suzana Gërvalla - shën i Xh. D.), me mëdyshje. (për Saime Isufin - shën i Xh. D.) S'e kam takuar kurrë. As në shtëpi nuk më ka qenë. Jemi ndarë jo mirë, në kohën kur po mirreshim me varrimin. Ishte fort luftarake, s'donte të ndiente për dhimbjen, apo luante ashtu. Shtronte kërkesa bashkë me Keqën, por nuk bënte gjë prej gjëje. Tash kam mirëkuptim për të. Ka qenë tepër e re dhe e padijshme." (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 94)*

-3. NA BEFASOI DHE KRIJOI UNITET NË MESIN E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE

Është anomali e pashpjegueshme pse syrit vigjilent të ish policit politik, Abdullah Prapashticës dhe nipit të tij Faton Topallit, iu ka shpëtuar Skena e tretë e pjesës së parë së dramës Misioni të Sabri Hamitit, ku përshkruhet artistikisht në mënyrë fenomenale uniteti i familjeve të dëshmorëve, kur Luli (Kadri Zeka) me Keqën (Ibrahim Kelmendin) e paska dërguar Hysen Gegën që t'i vret Vëllezërit Gërvalla në shtëpinë e tyre.

Me poshtë në formë të koncentruar po i jap pjesët kryesore të skenës së tretë.

S. H.: *"ZANA – Kush është?*

GEGA – *A është kjo shtëpia e Isës?*

GEGA – *Kam një porosi për zotin e shtëpisë.*

ZANA – *Urdhëroni*

ISA, duke hyrë – *Tungjatjeta mik! Shkon kah ai.*

GEGA – *Ti je Isa?*

ISA – *Po jam! Po ti kush je?*

GEGA – *Nuk të kisha njohur. Unë jam Gega! E nxjerr nga xhepi dorën e djathtë të bërë grusht.... Jo po nuk njiheshim. Më kanë folur shokët. Nxjerrë duart nga xhepat. Shokët e kanë një fjalë me ty. ...Unë... Nuk di si... Shokët thonë se ti punon krye në veti, nuk e pyet askend... Shokët thonë se ti i nënçmon shokët, që moti.*

ISA – *Kush janë shokët?*

GEGA – *Të gjithë shokët, me rend. Luli e Keqa. Jo vetëm këta. Kështu thonë se thotë Sofo. Thonë se kështu thotë I Padukshmi...*

ISA – I Padukshmi?

GEGA – Jusi vetë. Edhe ai thotë se ti nuk çan kokën për Të Madhin.... Porosia e shokëve është se kush punon krye në vete, punon kundër Lëvizjes, kundër Të Madhit. Shkurt e shqip, punon për armikun... Tamam puna. Kush jam unë që t'i njoh ata. Unë marr e kryej detyra. Kaq mundem, kaq bëj. Për punët e tjera le të mendojë Komiteti.

ISA – Komiteti?

GEGA – Komiteti i Lëvizjes. ... vë dorën në xhep. Unë nuk mundem... Unë nuk di... më kanë thënë. **Nxjerr revolen dhe e vë në tavolinë.** Lidh duart e veta. Merre e bënë çka të duash. Jam në dorën tënde, baca Isë. Tashmë nuk kam frikë. Unë tash jam i turpëruar. Jam në dorën tënde. ... Baca Isë, ti nuk më kupton. Më kanë thënë se e vret një tradhtar! Unë jam një i marrë. Unë që sot jam një i vdekur." (f.29-36)

Abdullah Prapashtica ish polic politik: "I nderuari Isa! Jam i bindur se me fitoren tuaj më së shumti ka fitua demokracia brenda LDK. Sepse ky është një shembull i ri i cili flet mbi shkëputjen e mentalitetit monist, kur kryetaret e partive ishin kryetar të përjetshme, të ashtuquajtur „historik“. Kjo vlen për të gjitha partitë politike. Mund të them se me këtë ka fitua një segment i demokracisë në Kosovë. Nga ky shembull i mire, kur në garë për udhëheqës ka më shumë kandidat, do të mësojnë edhe partitë tjera politike. Besoj se ky veprim do të është ndarje nga e kaluara dhe një fillim i ri pozitiv edhe për LDK edhe për partitë tjera, që mund të shënon kohën e pushimit të luftës mes partive dhe fillimin e bashkimit të tyre në një Lëvizje për bashkim kombëtar!

Fola mbi këto pikëpamjet të mija për arsye se shpreha gatishmërinë time për bashkimin e energjive në dobi të vendit, bazuar në thirrjen që doli nga fjala e jote në kuvendin e LDK, në përpjekje që të arrihet sinteza mes procesit historik të zgjedhjes përfundimtar të çështjes kombëtare dhe detyrave aktuale që duhet të ju përgjigjemi të gjithë ne, pavarësisht a jemi me apo pa parti.

Në përfundim të kësaj letre ju përcjell edhe një herë urimet e mija për shëndetin dhe për punë të mbar në këtë etapë të re për jetën e juaj dhe për jetën e vendit dhe të vendlindjes tuaj. Me respekt, **Abdullah Prapashtica** (Letër-urimi Isa Mustafës me rastin e zgjedhjes për kryetar të LDK, zemrashqiptare.net, 9 nëntor 2010)

Këta rreshta të ish-policit politik, dërguar Isa Mustafës, bashkëpunëtorit më të afërm të Sabri Hamitit, ndoshta janë fakti më domethënës se është pikërisht ai, personi më i përshtatshëm për të krijuar unitet në mesin e familjeve të dëshmorëve dhe për t'i shëruar zemrat e tyre të lënduara. Mençuria e ish-policit politik nuk përfundon me kaq. Për çdo rast ai e dërgon nipin e vet Faton Topallin në Ambasadën e Kosovës në Bern, më 26 shkurt 2011 për ta promovuar librin "Vrasja e trefishtë". Nuk e di a guxon dikush të thotë se ish-polici politik **Abdullah Prapashtica** nuk ua bën shylevek armiqve të tij.

-4. ME HYSENIN E PRITËM BASHKË VITIN E RI 1980

Jusuf Gërvalla: "Nga dita e arratisjes sime në RF të Gjermanisë, më 14 dhjetor 1979, këtu kam pasur kontakte me përfaqësues të Grupit komunist "Zëri i Kosovës"...

Me përfaqësuesin kryesor të Grupit komunist "Zëri i Kosovës" jam njohur, pra, në fund të dhjetorit 1979. Quhet Riza Salihu, nga fshati Mushtisht. Ra fjala për organin e LNÇK "Zëri i Kosovës" dhe ai, me një ton të ashpër, shprehu dyshimin jo vetëm në ekzistencën e këtij organi dhe të LNÇKVSH, por edhe në besnikërinë time. Arsyeja ishte se ai qëndronte vetë në krye të Grupit me të njejtin emër dhe, meqë, siç del logjikisht, nuk dinte për ekzistimin e LNÇKVSH dhe kishte edhe vetë një logjikë të kufizuar, kurrsesi nuk ia kapte rradakja të bënte dallimin në mes një organizate me emrin "Zëri i Kosovës" dhe një organi me titull "Zëri i Kosovës" që i takonte koincidentalisht një organizate krejt

tjetër. Po atë natë, ai më njohu mua dhe vëllaun tim me dy shokët e tij, Hysen Gega (tani i burgosur në burgun e Prishtinës) dhe Maksut Saramati, me punë të përkohshme në RFGJ. Që në fillim ra në sy kapadaillëku në rigorozitetin prej një shefi bande i Riza Salihut dhe natyrshmëria e zgjuarsia e dy shokëve të tij (anëtarë të KQ të "Z.K.").

Me Hysenin e Maksutin u pamë dhe ndjenjëm disa herë me radhë dhe e pritëm bashkë Vitin e Ri 1980. Hyseni lente të kuptohej se kishte diku në Gjermani një shok më të mirë se Rizanë, një student. Ai fliste dendur për të dhe vëllaut tim, Bardhit, që kishte njohur kohë më parë një person të tillë, i shkoi mendja mos ishte fjala për njëfarë Ibrahim Kelmendin. Por Hyseni e fshehte, prandaj nuk ngulëm këmbë për t'u njohur. Pak ditë më vonë vijnë te Hyseni e Maksuti dhe na tregojnë se si Rizai kishte ardhur, që në takimin e parë me mua, në përfundim se unë jam "i dërguar special i UDB-së" dhe se u kishte propozuar haptazi Hysenit e Maksutit të më likuidonin bashkë me vëllaun, Bardhin. Ata u hapën në "muhabet" për dy arsye, sipas pohimit të tyre: e para, lidhur me Rizanë kishin pasur disa dyshime më përpara, dhe e dyta, tashmë ishin takuar me Ibrahimin dhe ai i kishte këshilluar të më afroheshin se gjoja ai e ditka kush jam dhe se jam "i mirë". (Raport Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare - Komitetit të Degës "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981; Faridin Tafallari, Kur shkruante Jusuf Gërvalla 'Bashkimi bënë fuqinë', www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

-5. TASH SË FUNDI JAM NË KONTAKT

Jusuf Gërvalla: "Tash së fundi jam në kontakt edhe me një shok (Kadri Zekën shën. i Xh. D.) të grupit të Marksistë-leninistëve të Kosovës, të tubuar rreth organit të tyre "Liria". Personalisht, për organin e tyre kam mendim shumë të mirë, po edhe shoku me të cilin kam kontaktuar duket shumë i ngritur dhe i pjekur. Ka një mirëkuptim midis nesh dhe kemi rënë në ujdi që t'i bashkërenditim veprimet. Lidhur me këtë, për fillim, kemi zënë të organizojmë një varg demonstratash, nëpër qendra të ndryshme evropiane, që kanë për qëllim të bëhen përpjekje e zëshme e ngjarjeve aktuale në Kosovën tonë trime. Demonstrata e parë, shumë e suksesshme, është bërë para ambasadës jugosllave në Bern të Zvicrës, më 11 prill, në të cilën kanë marrë pjesë edhe shqiptarë nga RFGJ." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 259-260)

-6. ME HYSENIN NUK E PRITËM BASHKË VITIN E RI 1981

Jusuf Gërvalla: "KESHTU NA "URON" UDB-ja VITIN E RI!

Si përvjet, edhe sivjet, shumë kurbetçarë u kthyen në vendlindje për t'u shlodhur nga hallet e mëdha të kurbetit dhe për t'u çmallur me njerëzit e tyre. Takimi i tyre me familjet ka për çdonjërin domethënie shumë të madhe, i ripërtrin dhe u jep forca të reja që pas disa javë pushimi, të kthehen sërish atje tek i pret puna e vështirë dhe barraka e ftohtë.

Hysen Gegaj nga Sallagrazhda e Suharekës, ishte punëtor i mirë e shumë i dashur për shokët e vet, gjithnjë i gatshëm t'i ndihmojë pa kursim të tjerët. Edhe ai, me një gëzim të madh u nis për në vendlindje, ku arriti natën e Vitit të Ri. Në shtëpi e pritnin me mallë babai i rrezbitur, nëna plakë, shoqja, vëllezërit, fëmijët e mitur. I harroi vuajtjet e përjetuara gjatë qëndrimit të tij në kurbet. Jeta po i dukej sërish e bukur. Tjetër dhe ish ky, tjetër erë binte këtu athëtima e dimrit, rruga e përbaltur dhe gjerdhet e ulëta.

Si u përshëndet me prindërit e me fëmijët, sa u çmall pakëz, Hyseni doli në fshat tek shokët e moçëm dhe ndenji me ta deri pak para mesnate.

Në shtëpi e pritnin me padurim. Druanin se do ta kalonin pa të edhe këtë Vit të Ri. E dinin se ai harrohej fare kur ishte me shokët. I tillë kish qenë qysh fëmijë, kur i ruante lopët e fshatit, për t'ia shtuar një kafshatë bukë familjes. I tillë kishte qenë edhe në kohën e rinisë së hershme, kur iu desh ta regjte shtatin e njomë me peshat e rënda të betonit e të tullave, në punishtet ndërtimore të Beogradit. Për shokë jepte gjithçka edhe tash. Veçse tash vinte pak më thatim e gjithnjë më hijerëndë. Dhe sikur kishte ca brenga të thella për moshën e tij.



Me Hysenin e pritëm verën e vitit 1980: Hysen Gega e Faridin Tafallari

Megjithatë, pak para mesnate, ai u kthye në shtëpi. Shtathedhur e hijerëndë. Mbase pak edhe në qejf. Nga pija. Por ç'ishte ajo brengë e re në rrudhat e hershme, që s'po ia kuptonin dot prindërit as e shoqja? Po burrërohet si shpejt, tha me vete, jo pa njëfarë mburrjeje të druajtur, i ati, Qazim Gegaj. Ndërsa vëllau i dytë i Hysenit, Danushi, e shikonte me një admirim të fshehtë, sa herë që puqnin gotat apo ia krisnin këngës së festës.

Kulminacioni arriti në mëngjesin e 1 janarit. Aty nga ora tre, shtëpia e Qazim Gegajt, qe rrethuar nga një tog policësh të armatosur deri në dhëmbë. Pasi policia kishte zënë mirë e mirë pozitën, udhëheqësi i saj trokiti fuqishëm në derën e shtëpisë dhe u çorëgersisht. Ai kërkoi t'ua dorëzonin Hysenin.

Me gjasë, policisë nuk i pëlqekan njerëzit e mirë dhe të dashur. Njerëzit e tillë i quajtkan me një emër absurd: "armiq të popullit"! Armiqtë e popullit të jenë vallë ata që s'i bëjnë gjë të keqe popullit, pos që mendojnë ditë e natë për hallet e tij dhe të vetat?! Armiq kishin qenë dikur gjermanët, italianët, çetnikët... Shqiptari, që dërmohet e robtohet për një kafshatë goje në rrugët e hidhura të kurbetit ky shqiptar të jetë armik i popullit shqiptar?!? Armiku i popullit shqiptar ka qenë gjithmonë dikush tjetër. Armik i popullit shqiptar është polici që çirret, sikur i ka pikur nga qielli e drejta për të burgosur njerëzit e pafajshëm, për hir të gjakpirësve të Beogradit!

- Jeni të rrethuar! Dorëzoheni Hysenin, - i bërtiti përsëri babait, dhe shoqes së Hysenit, kryepolici, duke ua vënë grykën e automatikut në gjoks.

Hyseni, në krye të shkallëve, bërtiti si i shastisur, nga tmerri që e kapi kur i pa babanë dhe gruan para grykës së armës.

- Hiqe atë hekuraqe, or fatzi, ç'ke që u bie më qafë pleqve e grave?!

- Hysen Gegaj! Në emër të popullit, jeni i arrestuar!

- Cilit popull?!? Unë jam bir i këtij plaku, bir i këtij populli dhe i kësaj toke. Për ty ka ankime e mallkime populli, jo për mua.

- Mbaje gojën, - çirrej kryepolici, kur ia lidhën duartë Hysenit. - Tash ec përpara, e kusurin do ta marrësh vesh në hetuesi...

- S'qe nevoja të më lidhni. Vij vetë.

Pa u ndarë mirë nata me ditë, Sallagrazhda u gjetë më këmbë. I zgjoi zëri i fuqishëm i loparit, argatit dhe gurbetçarit Hysen Gegaj, që ndonëse po ia shtonin goditjet me kundak, me grushte e shkelma, bërtiste me gjithë gjoksën e tij të bëshëm:

- Poshtë titizmi, armiku i përbetuar i popullit shqiptar! Lavdi marksizëm-leninizmit! Poshtë klika tradhtare kosovare. Rroftë populli shqiptar, i lirë e i bashkuar! Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë në krye me prijësin e madh Enver Hoxha!

- Rroftë e qoftë, sa malet me dëborë, - iu përgjegj që nga oborri i vëllai, Danush Gegaj dhe nuk pushoi as ky, deri sa iu vunë prangat dhe deri sa u nis kampanjolla e milicisë.

Në pejzazhin e mjegullt dimëror, mbi rrugën e përbaltur dhe gjerdhet e ulëta të Sallagrazhdës mbeti vetëm zhurma e thekshme e kampanjollës së milicisë, që u nis me turr, trishtimi dhe mpirja e plakut Qazim Gegaj, i cili s'e kishte kuptuar gjysmën e fjalëve që thoshin të bijtë... Mbeti zemra e mpirë e nuses dhe vaji i fëmijëve...

- Rroftë populli shqiptar, i lirë e i bashkuar! - po të përgjigjemi edhe ne që këtej, o Hysen Gegaj dhe ty Danush, dhe atyre mijëra djemve të këtij populli, që UDB-ja po i dergj pa kursim në burgjet e fëlliqura e mizore. Dhe që këtej po jua përcjellim edhe sihariqin, se edhe populli po bëhet gati për t'jua marrë ju hakun!

Po bëhet gati populli për hakmarrjen e vet të madhe!" (Lajmëtari i lirisë, janar 1981, faqe 1)

Raporti i Jusufit dhe Bardhoshit me Hysen Gegën është sqaruar si drita e diellit nga vet Jusufi. Aktivitetet e përbashkëta të Jusufit me Hysen Gegën gjatë vitit 1980 dhe artikulli i Jusufit në Lajmëtarin e lirisë janë dëshmi e përjetshme se si kapitulli i relacionit të Jusufit me Hysen Gegën është kapitull i mbyllur.

4. BASHKIMIN DO TA BËJNË NJERËZIT E VËRTETË TË PUNËVE TË VËRTETA

-1. KUJDESI PËR RRRITJEN E QENIT TË SHARRIT DHE PËRHAPJA E TIJ NË BOTË

-2. KU E KE TELEFONIN – TELEFONI NUK PUNON

-3. E KENI DITUR JU KËTË FAKT?

-4. E KENI DITUR JU KËTË THASHETHEMNAJË?

-5. BASHKIMIN DO TA BËJNË NJERËZIT E VËRTETË TË PUNËVE TË VËRTETA

Në skenën 4 të pjesës parë, përshkruhet, artistikisht në bazë të fuqisë së fantazisë së Sabri Hamitit, pa asnjë bazim në ndonjë të dhënë dokumentare, edhe pse fjala është për një ngjarje të vërtetë historike, rrjedha e dialogjeve në mes Jusufit, Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit, në mesditën e 17 janarit 1982 në shtëpinë e familjes Gërvalla. Në skenën paraprake, 3 të pjesës së parë e pamë se si Luli e Keqa e dërgojnë Gegën për ta

vra Jusufin. Në skenën vijuese, në mënyrë magjike pa as sqarimin më të vogël, planifikuesit e atentateve në Jusufin e Bardhoshin, vijnë tek Jusufi, takohen për herë të parë së bashku në bunkerin e tij dhe diskutojnë që të bëhen shokët më të mirë e më të sinqertë në mes veti.

Se si ka shkuar rrjedhimi i ngjarjeve prej 14 janarit 1982 e deri në mbrëmjen e vonë dhe vrasjen të 17 janarit 1982 e kam parashtruar në tre kapituj të librit "Lëvizja e Jusuf Gërvallës", e ata janë: "Ne tani kemi shtypin tonë", "Në qofsh gjallë" dhe "Telefoni ndodhej në rrugën matanë shtëpisë", andaj nuk e shoh të arsyeshme të zgjerohem shumë.

Nga kjo skenë i kamë marrë vetëm disa pjesë të zgjedhura.

-1. KUJDESI PËR RITJEN E QENIT TË SHARRIT DHE PËRHAPJA E TIJ NË BOTË

S. H.: *"Për herë të parë janë bashkë në shtëpinë e Isës: Luli thatak, Keqa barkalosh dhe Isa i imët. Janë të ulur rreth tryezës. Ata shihen sy më sy për herë të parë, mbas turbullimeve të mëdha në Prishtinë e në Kosovë. Mbas vrasjeve, arrestimeve e mundimeve të studentëve, të njerëzve të zakonshëm, të fëmijëve. Keqa shikon orën.*

ISA: Mirësevini burra!

KEQA: Mirë se të gjejmë Isë në bunkerin tënd. ... Po shoh perde të lëshuara, derë të mbyllur me shul. ...Ngadalë, Lul, se je pak më i ri. ... Po deshe ashtu mbledhi ti klysht e tu, unë i mbledhë të mjitë dhe Isa të vetët e mbaroi puna. Keqa shikon orën.

LULI: Mos i fryj zjarrit se digjesh edhe vetë!

ISA ngrihet në këmbë.: Ngadalë, burra! Nuk ka klysh Luli, s'ke klyshë as ti, për veten po ju jap garanca se s'kam.

ZANA, hap derën, fut kokën. Mirëdita të gjithëve!

KEQA, Zanës. Hyn fisnike vetëm një minut. Ia shtrin dorën, përshëndetet, mandej ulet. Këtij Lulit tonë po i ngutet. Si e pleqnon ti fisnike këtë punë? Zana rrudhë krahët. Ky e ka mendjen te Lula e vet e re që ia ka lënë shtratin thatë. Qetësi. Unë jam kallë vetëm dhe s'kam çka të ngutem. E kam nanën vejushë të cilës s'mund t'ia gjej një plak. E kam edhe një motër, e sa për motër moj fisnike ia kam gjetur burrin. Ha-ha-ha. Do ta bëjmë dhëndërr Isën për së dyti. Isa hesht. Shikon Zanën, e cila pa asnjë fjalë del.

LULI, i mërdhezur. E mira e të mirave po të lut, Lulën mos e përmend.

ISA, mban veten. Te lutem Keqë, respekt për shtëpinë, konakun, për femrën. Të gjithë jemi me nerva, por kjo është shtëpi. ... i kthyer në vete. Ku mbetëm, burra?

KEQA, shkurt. Te klyshët!

ISA: Po e përsërite këtë fjalë biseda mbaroi." (f.38-42)

Programi i LDK-së: "Kujdesi për rritjen e qenit të sharrit dhe përhapja e tij në botë." (Tetor 2001)

Pra qentë fisnik të Programit të LDK-së munden me u përhap nëpër botë, si klysh të një race me të cilën do të mund të krenohet Kosova. Bashkëluftëtarët e Jusuf Gërvallës, na dalin se janë të një race më të ulët se qentë e Programit partiak të autorit të dramës Misioni.

-2. KU E KE TELEFONIN – TELEFONI NUK PUNON

S. H.: "KEQA, ngrihet, shikon orën. Isë, ku e ke telefonin?

ISA: Telefoni nuk punon.

KEQA, dredhas. Ky prapë nuk e ka mendjen këtu. Ha-ha-ha. E ka mendjen te shtrati i thatë i Lulës.

LULI, e gjuan fytyrës me bllok. Qenke njeri i poshtër!

ISA, hidhet ndërmjet. Ngadalni, burra se nuk na ka hije. Bërtet. Uluni Lul, Keq, mos luani vendit!

Bardhyli i bie derës me rrëmbim, duke i gjetur të tretë të lidhur.

ISA, këlthet. Bardhyl, mbylle derën e shko në dhomën tënde!

LULI: Baca Isë, s'më zë gjumi pa e ndëgjuar zërin e Lulës. Nuk e kam parë tri ditë. Qesh si në turp.

ISA: Po thirre! Zënës. Lëshoja telefonin.

LULI, në telefon. Alo! Lulë, si je e dashur... Po të dua sa jetën... Si? Po si të të harroj kur mendjen e kam te ti... Po jam te Isa, te baca Isë. Te Isa de, sonte jam këtu... Nuk ka punuar telefoni deri tash. Ia shkelë syrin Isës duke buzëqeshur. Të vij tash... Është vonë. Sa është ora? Shikon orën në mur 24.00... Me çka? ... Jo me tren. Të puth. Cëk. E lëshon telefonin." (f.44-52)

Ajo që bien në sy është lufta e autorit për talljen dhe nënçmimin e personazheve të veta pa përjashtim. Pra ai tallet me *klyshët* e Jusufit. Në këtë skenë shfaqet lufta primitive, *bellum omnium contra omnes*, – lufta e të gjithëve kundër të gjithëve. Aleancat, besimet e mosbesimet, pabesitë e njerëzve të hunit e të konopit, vazhdimisht krijohen, shemben, riformohen dhe shemben përsëri me shpejtësinë e vetimës. Fillimisht janë Luli e Keqa së bashku që i çojnë peshqeshe Isës përmes Hysen Gegës. Pastaj del Luli kundër Keqës të cilin e quan njeri të poshtër dhe e gjuan me bllok fytyrës. Për një moment duket sikur Luli e Isa janë unik e të besës kundër Keqës. Pastaj vijnë personat e prapaskenës Jusi, Sofo dhe i Madhi, nga shteti shqiptar, që e kanë fjalën përfundimtare që vendosin mbi të tretë, për prishjet dhe pajtimet e tyre, që vendosin çdo gjë për jetën e tyre dhe për vdekjen e tyre. Atentati, vrasja, në paraqitjen e vet e thyen rekordin e UDB-së Serbe dhe Tanjugut. Tanjugu ka pas thënë se vrasja është qërim hesapesh në mes grupeve në emigracion. Sabri Hamiti në gjithë dramën e tij, prej fillimit e deri në mbarim e lufton Tanjugun dhe UDB-në Serbe me qëllim që kokën e operacionit të vrasjes ta gjej në Tiranën e Enver Hoxhës.

Për të gjithë ata që kanë filluar të ndiejnë një lloj xhelozie, lidhur me atë, se me anën e çfarë detektori u gjet një detektiv i një kalibri të tillë, shpresoj se do të mund të ngushëllohen me fjalët e Apostol Dukës.

-3. E KENI DITUR JU KËTË FAKT?

Apostol Duka: "- Mbrëmë, Hydajet Hyseni dhe Berat Luzha u befasuan kur unë iu thashë se ekzekutorët, ose dorasit, siç quhen në Kosovë dhe në veri të Shqipërisë, e Kadri Zekës dhe të vëllezërve Gërvalla kanë qenë shqiptarë, djem të familjeve kosovare që banonin prej kohësh në Shqipëri. Sigurisht ata kanë qenë në shërbim të UDB-së jugosllave, të paguar e të urdhëruar prej saj. E keni ditur ju këtë **fakt**?...

... -Kjo është zbuluar tashmë. Vetëm se nuk është bërë publike, por juve me pozitën dhe me njohjet zyrtare që kini në Shqipëri, mund të kërkonti dhe të merrni një informacion më të hollësishëm." (Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, f. 183 e 184)

-4. E KENI DITUR JU KËTË THASHETHEMNAJË?

Apostol Duka: "Pak kohë para se në Shtutgart të ish-Gjermanisë Federale të vriteshin Kadri Zeka dhe vëllezërit Gërvalla, në Shqipëri vrau veten në kushte edhe sot të dyshimta e të pasqaruara Mehmet Shehu... Pak kohë pas vrasjes së Kadri Zekës dhe vëllezërve Gërvalla, arrestohet Kadri Hazbiu... por edhe të tjerë, të akuzuar, gjykuar e dënuar shumë rënd kohë më parë si Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako, Koço Theodhosi, Kiço Ngjela e të tjerë. ... në Shqipëri qarkulloi fjala sikur informacionin për Kadri Zekën dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallën, shërbimet e fshehta serbe e kishin marrë pikërisht nga Shqipëria. Sipas asaj fjale apo **thashethemnaje**, kjo ka ndodhur pas një takimi të disa prej drejtuesve të OMLK në njërën prej ambasadave tona, ndoshta në Bullgari ose në Austri. Ata të ambasadës pastaj kanë raportuar për takimin në ministrinë e Brendshme dhe në atë të Jashtme, fjala ka shkuar në veshët e Feçorr Shehut e Nesti Nases dhe këtu është mbyllur rrethi: Këta të fundit kanë raportuar menjëherë tek padronët e tyre në Beograd për anëtarët më kryesor të organizatës, emrat, vendndodhjet, detyrat që kryenin, veprimtarinë që zhvillonin etj. Ju e dini mirë se OMLK është goditur rëndë tamam në këtë kohë, jo vetëm me vrasjen e Shtutgartit, por edhe me arrestimet e shumta dhe dënimet e rënda të drejtuesve të saj.

Shihni ju të dy ndonjë të vërtetë a ndonjë lidhje mes këtyre ngjarjeve të rënda, mund të ketë ndodhur tamam kështu siç është folur? (Vrasje në Shtutgart, f. 201)

-5. BASHKIMIN DO TA BËJNË NJERËZIT E VËRTETË TË PUNËVE TË VËRTETA

Për ta ilustruar edhe njëherë atmosferën e vërtetë të atyre ditëve, në përfundim të analizës së Pjesës së parë, skena 4 të dramës Misoni, i referohem kësaj pjese nga libri im "Lëvizja e Jusuf Gërvallës". Çështjet të cilat shqyrtohen në këtë pjesë i referohen letrës së Jusuf Gërvallës dërguar Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982. Kjo letër është botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbe-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

Arsye për të qenë aq gjaknxehtë

Jusuf Gërvalla: "Me bisedën që patëm **në dasmë**, unë në njëfarë mënyre u tregova i padrejtë ndaj teje. Por, duhet ta kesh kuptuar që **gjaknxehtësinë** time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufij. Arsye për të qenë aq **gjaknxehtë** mbase nuk kam pasur." (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Jusufi i thotë I. Kelmendit se në dasmën e Kadri Zekës më 2 janar 1982, është treguar i padrejtë ndaj tij. Pse i padrejtë? Sepse shumë gjëra që Jusufi ia thotë Ibrahim Kelmendit, në të vërtetë i ka merituar dhe kanë qenë të adresuara për Kadriun, por pasi ka qenë dasmë Jusufi nuk mund t'ia thotë atij direkt por ia thotë shokut të tij të organizatës, Ibrahim Kelmendit.

Por, duhet ta kesh kuptuar që **gjaknxehtësinë** time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufij. Me këtë fjali Jusufi ka parasysh dy periudha nga viti 1980; Shkurt - prill 1980 dhe kohën nga 28 Nëntori 1980 deri më 18 dhjetor 1980, kur Jusufi pa kurrfarë kufizimesh e ndihmon dhe mundëson botimin e gazetës "Bashkimi".

Pse Jusufi është gjaknxehetë? Sepse në këtë kohë Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi zhvillojnë fushatë, nëpër Zvicër e Gjermani kundër Lëvizjes dhe vet Jusufit. Si mund të përmblihet përmbajtja e kësaj fushate?

- Në përputhje me TEZAT RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS, është formuar FRONTI POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS.

- Të gjitha organizatat në Kosovë i janë bashkuar FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS.

- OMLK-ja për këtë qëllim e ka përpiluar dokumentin "THIRRJE - TË GJITHË NË FRONT! TË GJITHË PËR FRONTIN!

- Vetëm Lëvizja e Jusuf Gërvallës nuk po donë me iu bashkua Frontit!

- Vetëm Jusuf Gërvalla ka dalë kundër bashkimit! Pra të gjithë janë për bashkim, vetëm ai është kundër!

- Kjo do të thotë se në Lëvizjen e Jusuf Gërvallës ka njerëz antikomunist që nuk pranojnë të udhëhiqen nga komunistët!

- Në një organizatë që nuk pranon të udhëhiqet nga komunistët punët qëndrojnë shumë keq!

Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq

Si përgjigje në fushatën e Kadri Zekës, në të cilën është i involvuar edhe Ibrahim Kelmendi Jusufi përgjigjet me fjalët e mëposhtme:

Jusuf Gërvalla: *"Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Lojë e pamirë me personin tim dhe organizatën time

Jusuf Gërvalla: *"Por, nga takti më kanë nxjerrë disa gjeste e veprime të një shoku, që të kundruara nga distanca e të sotmes, më dalin një lojë e pamirë, së pari me personin tim, e pastaj edhe me një organizatë, çka, më shumë organizatë revolucionare, madje në një çast madhështor të historisë sonë, që implikon dashurinë, afrimin dhe singëritetin më të madh mes luftëtarëve të lirisë."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Me **gjeste e veprime të një shoku** Jusufi ka parasysh Kadri Zekën. Gjestet e tilla Jusufi i konsideron **lojë e pamirë** edhe me atë si person e gjithashtu edhe me Lëvizjen e Jusufit (LNÇKVSHJ).

Ti mund dhe besoj se je i painformuar

Shefqet Cakiqi - Llapashtica: *"E di se edhe Ibrahim Kelmendi ka pas pakënaqësi për përfshirjen ose mos përfshirjen e tij në bisedime për bashkimin në Frontin për Republikën e Kosovës ... pas publikimit të Tezave të OMLK-së në vjeshtë të vitit 1981."* (www.kosova.de, Afishuar me: 23.03.2007 21:22)

Ibrahim Kelmendi: *"Sigurisht se nuk e dinë më mirë se unë, që do të thotë se unë kam qenë i inkadruar në të gjitha takimet për bisedime. Në ndonjërin nga ato takime kam shkuar me bashkëveprimtarë, të cilët mund të dëshmojnë."* (www.kosova.de, Afishuar me: 23.03.2007 22:57)

Jusuf Gërvalla: *"Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçarjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Letra e Jusufit e 15 janarit 1982 është letra e parë që Jusufi ia dërgon Ibrahim Kelmendit, pas një letre në nëntor 1980.

Shkaku pse Ibrahim Kelmendi nuk është i **përfshirë, inkuadruar apo informuar** prej anës së Jusufit gjendet i sqaruar në tërësi në dy letra të Jusufit të dërguara Sabri Novosellës; më 13 maj dhe 20 gusht 1981. Këto dy letra unë i kam shtjelluar në shkrimet e mia "Jusuf Gërvalla dhe demonstratat e vitit 1981 në Evropën Perëndimore" dhe "Në Kalanë e Jusuf Gërvallës" të botuara në www.pashtriku.org, andaj nuk mund të zgjerohem këtu më shumë.

Shkaku pse Ibrahim Kelmendi nuk është i **përfshirë, inkuadruar apo informuar** në bisedimet rreth bashkimit prej anës së Kadri Zekës nuk është çështje me të cilën ka pasur nevojë të merret Jusufi dhe rrjedhimisht nuk është çështje me të cilën kam nevojë të merrem unë. Jusufi i përgjigjet shumë mirë Ibrahim Kelmendit:

Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë.

Çka dinë Jusufi? Ku bënë pjesë tani (më 15 dhjetor 1982) Ibrahim Kelmendi?

Jusufi e din se Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi janë në të njëjtën organizatë.

Kush i tregoi Jusufit këtë fakt? - Kadri Zeka!

Ku? - Në panairin e librit në Frankfurt më 17 tetor 1981.

Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë

Jusuf Gërvalla: *"Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. Shokët e tu të rinj e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Jusufin nuk e lejon edukata e tij të përzihet në punët e brendshme të Kadri Zekës e Ibrahim Kelmendit. Jusufi i thotë I. Kelmendit se shokët e tu të rinj (Kadri Zeka etj.) e kanë me borxh me të përfshi, me të inkuadrua e me të informua.

Nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar

Jusuf Gërvalla: *"Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme. Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u qjerrë për të e duke luftuar kundër tij."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Të gjitha thëniet e këtij citati janë aq të qarta sa është vështirë, ndoshta edhe mëkat me u mundua e me i thënë më mirë.

Antikomunist e kundërshtar i partisë iluzioniste

Jusuf Gërvalla: *"Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne. E vërteta është krejt ndryshe. Shoku Z. i ka procesverbalet e takimit me të. Po deshtët të ngulni këmbë edhe më tej në qëndrimin "antikomunist" të atij shokut të Lëvizjes, urdhëroni e bëjeni këtë punë në baza më të shëndosha e më të ndershme, merrini përbazë procesverbalet e takimit."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Me **njeriun antikomunist të Lëvizjes** mendohet Sabri Novosella. Pra, Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi mendojnë se Sabri Novosella mundet me u ndie i ofenduar nëse ata e shpallin si antikomunist. Këtu shtrohet prapë një çështje delikate. Pasi Kadri Zeka dhe

OMLK-ja e konsiderojnë vetëm veten komunist të formuar dhe askënd tjetër, kjo domethënë se e meta dhe gjynahu i Sabriut nuk qëndron në atë se pse ai nuk është komunist, por pse është **antikomunist** e kundërshtar i partisë iluzioniste.

Bashkimi i shpallur si akt i kryer në thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!"

Jusuf Gërvalla: *"Atje shihet se ku qëndron e vërteta për bashkimin e paarritur, e megjithatë të shpallur si akt të kryer në **thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!"**, të cilën ndoshta nuk e ke pasur në dorë, ngase botimi i saj u spostua pas letrës sime dërguar shokut Z (Kadri Zeka - shën i Xh. D.).*

*Tani po e kupton se unë hyra shumë thellë në punë që s'janë të miat, **në punë tuaja të brendshme**. Prandaj, nuk shkoj dot më tej. Dëshiroj që ana jonë këndeje të jetë e gabuar dhe juve t'ju shkojë puna për së mbari deri në arritjen e fitores. Ne s'ndiejmë frikë as kemi dëm nga cilado forcë me të vërtetë patriotike e revolucionare e popullit tonë. Përkundrazi, atë kërkojmë si qorri sytë dhe ajo na bënë të mburremi. Por kemi një çikë ndruajtje se punës i është zënë jo fort mirë peta." (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)*

Bashkimin do ta bëjnë njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta

Hasan Mala: *"Isufi i ka thënë (Kadri Zekës - shën i Xh. D.) se pse nuk është arritë atje, mund të kryhet nesër. Domethënë mund të bëhet nesër, nuk do të thotë se u krye (mori fund - shën im) kjo punë. Jusufi e ka pritë me rezervë, domethënë ai e ka pritë me rezervë që pse s'u bërë mirë tani, por në të ardhshmen do të bëhet mirë." (Nga filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?", 1992)*

Jusuf Gërvalla: *"Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e **bashkimit**. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, **do ta bëjnë** kur të vijë koha, **njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta**." (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)*

Po të nxorri rruga këndeje ndonjë ditë

Jusuf Gërvalla: *Tani po të njoftoj se këto ditë na arriti në videokasetë me pesë filma shqiptarë. Filmat janë të shkëlqyeshëm dhe shumë inspirues. Ne ende s'ia kemi dalë ta shumëzojmë videokasetën, se për këtë punë po na duhet edhe një videofon i dytë, që s'e kemi, dhe një shtojcë speciale për riinçizim, që s'e kemi poashtu.*

***Po të nxorri rruga këndeje ndonjë ditë** dhe po pate mundësi, merr videofonin tuaj e eja t'i riinçizojmë. **Me këtë rrugë, për të njëjtën çështje po e njoftoj edhe shokun Z.**, megjithëqë më duket se ata nuk kanë ende as videofon." (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)*

Jusuf Gërvalla: *"Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë, as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z (Kadri Zekën - shën i Xh. D.). Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës, por **megalomaninë e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për dominim me çdo kusht mbi të tjerët**." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981).*

Po në këto ditë del edhe numri i dytë i Zërit të Kosovës, Zëri i Jusufit i cili haptazi i diskuton disa aspekte të çështjeve të bashkimit. Ja se çka shkruan Zëri i Kosovës, i janarit 1982, në faqe 2.

Jusuf Gërvalla: *“Karshi zhvillimit të tillë të ngjarjeve, për forcat tona të organizuara patriotike e revolucionare, për rininë dhe popullin tonë dalin detyra serioze, të barasvlershme me përpjekjet historike shekullore për ekzistimin e kombit shqiptar në tërësi dhe për këmbënguljen në realizimin e të drejtave të ligjshme të pjesës së robëruar të popullit tonë nga shovinistët jugosllavë, në veçanti.*

Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike dhe revolucionare, të cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvujtur e marrin në tërë seriozitetin e saj. Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e ‘politikës së madhe’, lojën e arrivizmit revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë (fjalët i drejtohen Kadri Zekës dhe shokëve të tij - shën i Xh. D.), dhe ato që janë organizuar prej elementesh të dyshimta, (këto fjalë i drejtohen ish – policit politik, Abdullah Prapashtica - shën i Xh. D.) e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar. Gjaku i derdhur, burgu i zi dhe terrori çnjerëzor që po ushtron mbi bijtë e bijat e Kosovës trime, na obligon që Atdeut tonë t’i dalim hakut me një dashuri që bëhet, - siç thotë ... - me ngut, me alarm, me përpjekjet mbinjerëzore të luftëtarëve të vërtetë të lirisë.” (Zëri i Kosovës, nr. 2 janar 1982, faqe 2)

Kadri Zeka me I. Kelmendin, në mbrëmjen e 16 janarit, nga Düsseldorf vijnë në Shtutgart, bëjnë telefonata tek shokët e Jusufit, me shpresë se Jusufi, ashtu siç ka prognozuar më parë I. Kelmendi, ka hy në lëkurën e vetë. Prej ndonjërit prej tyre marrin vesh se aktivistët e dalluar janë të tubuar në Bernhausen. Kadri Zeka, siç e kemi parë më parë i ankohet Faridinit se pse nuk ua din adresat njerëzve më të mirë në rrethin e Shtutgartit dhe për ta kompensuar këtë mangësi e ka I. Kelmendin me vete, i cili pa vonesë e qon në Bernhausen. Kaq e ngutshme dhe e shenjtë është puna e bisedimeve të bashkimit, "e ftesa e Jusufit" sa ata qëndrojnë duke parë video-filma deri në 02.00 të natës të 17 janarit 1982. Në Untergruppenbach mbërrijnë në ora 03.00 të 17 janarit 1982, pesë ditë pasi Kadriu ka udhëtuar nga Zvicra. (Lëvizja e Jusuf Gërvallës, f. 258-262)

5. LOTËT E TIJ PIKUAN

- 1. I mungonte babai
- 2. E ka përqafuar babain
- 3. U gëzova shumë kur mora ftesën e Suzanës

Pjesa e dytë quhet "Dasma". Thelbi i kësaj pjese sillet rreth hidhërimeve dhe gëzimeve. Ideja themelore në këtë pjesë është se organet shtetërore të Shqipërisë (të personifikuara nga Sofo, Jusi dhe i Madhi) që e kanë pranuar familjen e Jusufit ia kanë dashtë të keqen familjes së tij, në mënyrë të ngjashme si Jusufit në Gjermani. E keqja në këtë pjesë është e personifikuar nga Ajat Haxhiu. Përkundër të keqes, ka gëzime e ai është gëzimi i martesës së djalit të madh të Jusufit, gëzim i cili gërshetohet pikë për pikë me gëzimin e popullit në Sheshin e madh të Tiranës për rrëzimin e diktaturës komuniste të Enver Hoxhës.

Sabri Hamiti: "ZANA, vetmevete.

Ku mund të jenë tash? Ndoshta s'i kam bërë gjë zotit e të më dënojë tash që i bëra këmbë e dorë e të më mbeten në rrugë. Nuk i sjell në shtëpi as dita as nata. *Lidh duart. Shëtit dhomës.* Çfarë do të bëhet me gjithë neve? Do të ndërrojnë të gjitha. Miqësitë, krushqitë, lidhjet... Nuk do të ndërrojë asgjë. Njerëzit s'mund të ndërrohen për një ditë." (Misioni, Rilindja Prishtinë 1997, faqe 57)

Këtë pjesë nuk e kam analizuar duke u bazuar në faktin se unë dhe shokët më të afërm të Jusufit e Bardhoshit nuk kemi të bëjmë me te e me këtë edhe as të drejtë të përzihemi në te.

-1. I mungonte babai

Nexhmije Hoxha: "...Familja e Jusuf Gërvallës prej kohësh ishte e njohur për ndjenjat Kombëtare, prandaj shovinistët serbë e kishin përndjekur brez pas brezi këtë familje. Histori e dhimbshme, por e madhërishme. Dhe, kjo familje mori një grusht të rëndë, në një ditë, agjentina jugosllave vrau dy vëllezër, njëri më i mirë se tjetri. Suzana bashkë me dy djemtë dhe vajzën, në moshën shkollare, më i vogli 4 vjeç, erdhën në Tiranë. Shteti shqiptar mori përsipër mbajtjen e tyre, i strehoi i rregulloi në shkolla sipas dëshirave të tyre, u lidhi pensione të përshtatshme jo vetëm fëmijëve, por edhe Suzanës, e cila kërkoi të ndiqte studimet e larta jo duke punuar e me korrespondencë, por si studente e rregullt.

Djali i madh, Premtoni, u zgjodh deri anëtar i KQ të Bashkimit të Rinisë. Kjo Familje gjeti ambient të ngrohtë jo vetëm te kosovarët që banonin në Shqipëri, por nga të gjithë ata shqiptarë që kishin për zemër Kosovën e që kishin dëgjuar për talentet e Jusuf Gërvallës, për këtë yll të ri të ndritur, që kish dalë e po ngritej nga gjiri i popullit të shumëvujtur kosovar. Përveç shtetit për të shopen e Jusuf Gërvallës e fëmijët e tij u interesua drejtpërsëdrejti vetë Enveri! Ai u kujdes si për jetimët e një shoku, siç ka bërë me shumë nga fëmijët e dëshmorëve të Luftës.

Unë personalisht, nuk lashë përvjetor të vrasjes së Jusufit pa i shkuar Suzanës për vizitë në shtëpi. Që në fillim u dërgova fëmijëve disa dhurata nga xhaxhi Enver, që të gëzoheshin. Kur mësuam që dëshira e Jusufit ishte që vajza të mësonte FLAUTIN, ne i dërguam një FLAUT. Dhe këtë ia dërgoi Enveri. Suzana më dhuroi një qeleshe kosovare, të cilën - siç më tha - Jusufi e vinte në demonstrata, më dha një flamur të qëndisur, që unë i kam ruajtur si relikte të shtrenjta bashkë me ato të Enverit.

Kur martoi djalin, unë shkova dhe e urova. Aty takova shumë kosovarë që kishin ardhë nga vendet ku kishin emigruar. Djalit të Jusufit iu bë një dasmë, që nuk i mungoi asgjë nga ç'mund t'i bënte babai, veçse mungonte ai vetë!..." (Xhafer Durmishi, Lëvizja e Jusuf Gërvallës, pashtriku.org, 2011, faqe 593-594)

-2. E ka përqafuar babain

Suzana Gërvalla: "I dashur Vëlla Feredin, U gëzova shumë kur e mora letrën tënde, ato fotografi dhe shiritin e varrimit. Në këtë letër kam me ju shkru për shumë gjëra të reja që kanë ndodhur këtu më së pari po ju shkruaj për festën e 1 Majit. Ajo ka qenë ditë e shënuar për të gjithë ne. Për 1 Maj Donika i ka dhënë lulet shokut Enver. Ajo atë ditë e ka përqafuar babain e kombit shqiptar. ... Shoku Enver e priti shumë përzemërsisht Donikën. Për një kohë të gjatë ai i foli në vesh për babain dhe migjen e saj. E krahasoj Jusufin me Qemal Stafën, shumë e përkëdheli e lotët e tij pikuan mbi flokët e Donikës me shokun Enver.

Ja dhe një lajm të gëzuar, me datën 12 maj Donika ka dalë në koncert si soliste me flaut me një orkestër të madhe. Ajo korri shumë sukses. Shkruan të gjithë gazetatat për te. Në “Zërin e popullit” të datës 13 maj ja kanë vënë edhe fotografinë në faqen e parë. Me datën 21 maj ka dalë edhe në koncertin qeveritar ku ishte edhe vetë shoku Enver.” (Letër Faridin Tafallari, 30 maj 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 78)

-3. U gëzova shumë kur mora ftesën e Suzanës

Haxhi Lleshi

“Veprimtar i Partisë dhe i shtetit, një ndër figurat e shquara të Luftës ANÇ dhe të ndërtimit socialist, kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor (1953-1982), Hero i Popullit. Lindi në fshatin Reshan të Dibrës më 1 maj 1913. U lidh ngushtë që në fillim me luftën për çlirimin e atdheut, u shqua për besnikëri ndaj vijës së Partisë për trimëri dhe si organizator, në fillim komandant i Çetës partizane të Dibrës (1943). Luajti rol të rëndësishëm për bashkimin e popullit të krahinës rreth Frontit NÇ, për hedhjen e tij në luftë, për zgjerimin e luftës nacionalçlirimtare në Dibrën e Madhe e në disa krahina të tjera të Maqedonisë.



*Haxhi Lleshi dhe Faridin Tafallari në dasmën e birit të Jusuf Gërvallës
në Tiranë, më 7 gusht 1990*

Anëtar i PKSH në prill 1943. Mori pjesë në Konferencën e Pezës (1942), u zgjodh anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ që me themelimin e tij (1943), në Konferencën II NÇ të Labintit (1943) u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm ANÇ, ndërsa në Kongresin e Përmetit (1944) anëtar i Komitetit ANÇ.

Pas çlirimit ka dhënë ndihmesë të madhe për ndërtimin socialist të vendit dhe forcimin e pushtetit popullor. Anëtar i KQ të PPSH që nga Kongresi III (1956). Deputet në Kuvendin Popullor në të gjitha legjislaturat.”
(Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985, faqe 656)

Pali Miska

“Një nga udhëheqësit e Partisë dhe të shtetit, anëtar i Byrosë Politike të KQ të PPSH nga Kongresi VII (1976), Hero i Punës Socialiste. Lindi në fshatin Bradvicë të rrethit të Korçës më 19 maj 1931. U formua dhe u kalit si revolucionar dhe pastaj si kuadër. Anëtar i PPSH në vitin 1951. Ka kryer Fakultetin e ekonomisë. Është caktuar në detyra të rëndësishme dhe me përgjegjësi partie e shteti, ku është dalluar për këmbëngulje dhe ndërgjegje të lartë. Drejtor i Ndërmarrjes së Sharrave në Fushë-Arrëz (1964), sekretar (1968) e pastaj sekretar i parë i KP të rrethit të Pukës (1969), ministër i Industrisë e Minierave (1975), kandidat i KQ të PPSH në Kongresin VI (1971) dhe anëtar i KQ të PPSH në Kongresin VII (1976), zëvendëskryetar i KM të RPS të Shqipërisë (1976). Kryetar i Kuvendit Popullor (1982). U zgjodh sekretar i parë i KP të rrethit të Elbasanit (1982) dhe i rrethit të Fierit më 1983. Ka dhënë dhe jep ndihmesë të madhe për të zbatuar vijën e Partisë në ekonomi për ndërtimin e socializmit, ka luftuar me vendosmëri për mbrojtjen e vijës marksiste-leniniste të Partisë kundër imperializmit, revizionizmit modern dhe gjithë armiqve të brendshëm e të jashtëm.

Deputet në Kuvendin Popullor nga legjislatura e shtatë (1970). ”

(Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985, faqe 712-713)

Fjala e Pali Miskës në dasmën e birit të Jusuf Gërvallës, më 7 gusht 1990

Pali Miska: *“Të gjithë këta shokë dhe shoqe që keni ardhur (nga mërgimi-Perëndimi) veç familjes dhe të tjerë kjo është nder jo vetëm që i bëni Suzanës e fëmijëve këtu jo vetëm familjes tuaj por është edhe një nder që i bëni Shqipërisë. Në një kohë kur serbomëdhenjtë dhe të tjerët mundohen me të gjitha forcat të na përçajjnë të na ndajnë të na hasmërojnë ne jemi kompakt, të fortë, të lidhur si çeliku dhe nuk ka se si të ndodhë ndryshe sepse këtë unitet që kemi këtë dashuri që kemi, këtë respekt që kemi njëri për tjetrin e kemi kalitë me gjak, me sakrifica të mëdha. Juve e keni provuar në familjen tuaj, dhe familja juaj është shembull i shkëlqyer i atdhedashurisë jo vetëm për Kosovën por për tërë Shqipërinë. Për tërë Shqipërinë, sepse Jusufi dhe të tjerët nuk luftonin vetëm për Kosovën dhe kosovarët sot nuk luftojnë vetëm për Kosovën por për tërë Shqipërinë si një komb, si një unitet i tërë.*

Dhe ajo që bëhet sot në Kosovë është një gjë shumë e mençur, shumë e mirë, një gjë trimrore. Djemtë e Kosovës i kanë dalë zot Kosovës (duartrokitje) i kanë dalë zot Kosovës, dhe ne ç'po shikojmë perspektiva e tyre është jashtëzakonisht e qartë, jashtëzakonisht e mirë. Me një urtësi, me mençuri të madhe, por edhe me trimëri të rrallë që i sfiduan edhe serbët edhe malazezët edhe gjithë reaksionin jugosllav, si duar të reaksionit botëror dhe bënë që Kosova të ndërkombëtarizohet, të njihet Kosova në tërë botën, edhe atje ku nuk është njohur u njoh. Bile Kosova ndihmoi që të njihet Shqipëria edhe më gjerë akoma, dhe ky është një kontribut shumë i madh i kosovarëve, i këtyre njerëzve të shquar që e drejtojnë me aq mençuri Kosovën. (duartrokitje). Atë aktin që bënë, ta vejnë Kosovën në statusin që i takon, ai është akt heroik, akt historik.

Të ndodhë si të ndodhë ai është akt historik. Edhe alternativat tha shoku Ramiz, që i ka zgjedhë vetë populli i Kosovës i kanë dalë zot, popullit të Kosovës dhe Kosovës në

tërësi, tërë shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi. Është një moment historik. Edhe ajo që ndodhi vjet, nënë presionin e tankeve, automatikut dhe presioneve të tjera, e miratuan në Kuvendin e Kosovës, deri te një Riza Sapunxhiu i cili i doli zot vetes, dhe kur i del zot vetes mos prit se të të lavdërojnë serbët. Do të ndëshkojnë dhe po të ndëshkoj serbi je në rregull.



Pali Miska në dasmën e birit të Jusuf Gërvallës, 7 gusht 1990

Duhet të jemi një qik modest në këto punët tona, qoftë në krijime, që t'i vlerësojmë më mirë akoma dhe t'i vëmë në vendin që duhet edhe krijuesit kosovarë. E kanë bërë vetë që t'i vendosim në pedestal ku e meritojnë.

Kur ishte shoku Enver, erdhi këtu Bashkim Paçuku dhe kaloi këtu një muaj me Gaqo Çakon, dhe shokut Enver i thanë se erdhi Bashkim Paçuku dhe e falënderoi Gaqo Çakon për ndihmën e madhe që i dha. Ndëgjoi shoku Enver dhe tha: Po Gaqo Çako e falënderoi Bashkim Paçukun sepse mundet që Bashkim Paçuku i ka dhënë ndihmë më shumë Gaqos se sa ai Bashkimit. Njeriu që i tregonte, tha se nuk e di. Shoku Enver i tha atij që t'i thotë Gaqos që ta falënderoj atë, se ai tha, është talenti. Dhe tani kur u bë 25 vjetori i vdekjes së Fan Nolit, Bashkim Paçuku mbajti një kumtesë, referat (me temën); Fan Noli muzikolog i shquar. Ne jemi një pamvarësisht se kufijtë i kemi të ndarë. Jemi një komb, jemi një popull, kemi të njëjtat virtyte, të njëjtat tradita, si në të kaluarën ashtu edhe sot. Është fat i madh për ne shqiptarët, se këtu në Shqipëri traditave, Partia dhe shoku Enver u kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe, trashëgimisë i ka dhënë rëndësi jashtëzakonisht të madhe por edhe atje në Kosovë nën atë regjim që ka qenë dhe është kosovarët i kane dalë zot vetes dhe traditën e pasurojnë. Kanë dalë Asim Voksha, Isa Buletina, Bajram Curra, Emin Duraka e Jusuf Gërvalla etj. etj. të rinj. Jusuf Gërvalla është me këta të rinjtë që i kanë dalë zot dhe atë tradite të mirë të popullit të Kosovës e kemi këtu. Ja sot në gazetën Drita ka shkrime nga Jusufi dhe fotografi. Partia i vlerëson shumë dhe ne emocionohemi kur i lexojmë dhe kur dëgjojmë ato që bëjnë kosovarët. Prandaj nuk ka se si të mos i vlerësojmë, e ti botojmë edhe në gazeta. Bile siç e the ti

(Suzanë), jemi të vonuar. Duhet t'i bëjmë më mirë akoma. Dhe do t'i bëjmë më mirë me siguri, se i shërbejnë kombit dhe atdheut.

Edhe këtë që ju keni bërë sot është një shprehje e dashurisë jo vetëm për familjen, për Suzanën, për djemtë për vajzën dhe për nusen, por është shprehje edhe për atdhedashurinë. Shpreh unitetin real që ekziston në popullin tonë. Kudo që janë shqiptarët, edhe në Amerikë e Argjentinë dhe në Zvicër, Austri, Gjermani, edhe në Shqipëri e në Jugosllavi, kudo që janë një dhe rrojnë me mendje e zemër në Shqipëri. Dhe kjo ardhja e juaj (nga Gjermania e Zvicra) këtu tamam këtë e ka bërë. Dasmë e kohës e ngjashme me pikturën e Abdurrahim Buzës, me flamur. Edhe atë ftesën mirë e kishit bërë (Suzana: me kopertinën e librit të Jusufit që ia keni botuar në Shqipëri). Për hajr t'u jetë kjo miqësi, të trashëgohen e me jetë të lumtur dhe secili në jetën e tij dhe në familjen e tij dhe të afërmit e tij të kenë lumturi e gëzime.

Edhe miqësia ka kuptim, nuk është spontane. Djali i Jusuf Gërvallës me vajzën e Kujtim Buzës. Edhe ndonjë tjetër të merrte kuptim do të kishte, por kjo e ka më të mirën.

Unë nga ana ime jam shumë i gëzuar bashkë me gruan, dhe **u gëzova shumë kur mora ftesën e Suzanës**, se e marton djalin, dhe këtë dashurinë e këtë gëzimin tim e shpreh me ndjenja të thella të dashurisë për tërë familjen tuaj, Gërvalla, për juve që jeni andej (Perëndim), dhe ata që janë këtu. E shpreh duke ju uruar nga zemra që të trashëgohen. " (Tiranë, 7 gusht 1990, videofilm, Arkivi i Faridit Tafallarit).

6. SPEKTAKLE DHE VRAPIME TË MJERA

- 1. BURRNIA DHE QYQARIA
- 2. ÇKA JANË KËTO SPEKTAKLE TË MJERA?
- 3. VARRIM MADHËSHTOR
- 4. Ç'ËSHTË KY VRAP I MJERË?
- 5. NJË JAVË U GRINDËM PËR GURËT E YJET
- 6. FOL ME LULËN QË T'I FLET KEQËS

Pjesa e tretë, BALSAMI, i ka tetë skena, të paraqitura në formën I (1, 2 ,3, 4) dhe II (1, 2 ,3, 4)

S.H.: "15 vjet nga vdekja e Isës. Mundimet e gazetave e të TV për të shënuar ngjarjen e për të ndërtuar portretin e vonuar të martirit. Vrap mbas deklaratave të anëtarëve të familjes, miqve të tij dhe të tjerëve që donë të gjejnë identitetin e vet te tjetri në vonesë kohe." (f.75)

-1. BURRNIA DHE QYQARIA

Në skenën e parë I-1 ngjarja zhvillohet në Lisnajë (Dubovik), në vendlindjen e Jusufit, më 1997, në 15 vjetorin e 17 Janarit 1982, në kulmin e luftës brenda LDK-së në mes themeluesve të saj dhe burgijashave kuqalash që luftojnë për ta marrë kalanë nga brenda. Turpi i burgijashave kuqalash apo të bojatisur, në këtë skenë, të paraqitur në formën e tri hijeve, është se ata në luftën e tyre për ta fituar rolin hegjemon në partinë në të cilën janë infiltruar me atë qëllim, e kërkojnë edhe ndihmën e nënës së Jusufit e Bardhoshit, e një plake të vetmuar që nuk pranoi kurrë me e lëshue shtëpinë e saj, ku i ka

rritë fëmijët e vet. Heroizmi dhe burrnia e themeluesve të LDK-së, në këtë rast marrin një impuls tepër të fuqishëm, pasi Nëna e Jusufit e heton dhëlpninë dhe bojatisjen e hijeve, ua pret shkurt dhe u tregon se ajo i njeh miqtë e vërtetë të Jusufit, të cilët janë në anën e themeluesve.

-2. ÇKA JANË KËTO SPEKTAKLE TË MJERA?

Në skenat I-2, -3 dhe -4 ngjarja zhvillohet në banesën e gruas dhe fëmijëve të Jusufit në Tiranë, dhe ka të bëjë me përgatitjet rreth një filmi dokumentar.

Në skenën I-3 gjenden këto fjalë:

S. H.: *"REGJISORI –A dini zoti Fitimi, ne do të bëjmë një emision për Isën. Do të ishte mirë që ju të flisni për babain tuaj e heroin.*

FITIMI, preraz. – Ndal! Ç'janë këto parulla që flisni këtu? Çka janë këto spektakle pa ngjyrë?

Regjisori i bën me shenjë kameramanit të xhirojës. Fitimi e heton dhe e ndalon.

FITIMI, regjisorit të ngrirë. – Shiko djalë i mirë. Babai im, Isa, nuk ka qenë asfarë heroi. Ai ka qenë krejt i zakonshëm. E ka dashur muzikën, letërsinë, familjen e vet e lirinë. Ka punuar shumë. i ka urrejtur për vdekje rrenat. Kjo edhe i ka kushtuar me jetë. Mund të flitet për jetën e një shqiptari të zakonshëm të Kosovës, që jeton jetën e vet e vdes si vdes njeriu. Sa për spektaklet nuk i jap as pesë para. Kur e mbaruan spektaklin e mjerë në varrin e tij, e isha një fëmijë, të gjithë ikën e më lanë vetëm me flamur në dorë te kryet e tij. Do të më linin te varri po të mos ishte nëna, të më merrte ngryk në atë tmerr e në atë tubim të tmerrshëm. Mos shpifni e shpikni miq, rrena, heronj të gjallë e të vdekur se do të keni punë me ndërgjegjen tuaj dhe me mua.

Ua kthen shpinën. Mund të shkoni. Fitores. Përcilli deri te shkallët.

Dalin të gjithë pa thënë asnjë fjalë." (f.87-88)

-3. VARRIM MADHËSHTOR

Kur jemi tek çështja e varrimit më 5 shkurt 1982 në Shtutgart është shumë me interes t'i shohim përshtypjet e anëtarëve të familjes Kadriut.

Taip Zeka: *"Atëherë kam marrë babën, edhe Ahmet Isufi erdhi prapë me ne, nana e Isufit kishte pas mbërri edhe ajo gjatë kësaj kohe dhe varrimi u bë me bashkatdhetarë. Një varrim aty, qysh i ka hije me u bë. Me përgatitje shumë të mëdha, me krejt.... ..Kur janë rivarrosë Kadriu, Isufi e Bardhi, u bë ndarja e tyre, kur ata nuk i kishte nda as vdekja dhe as ai varrim madhështor në Gjermani.."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 26 dhe 40)

-4. Ç'ËSHTË KY VRAP I MJERË?

Skena I-4

S. H.: *"DONA*

I njeiti ambient. Gjysmerrësirë.

DONA, e vetmuar. - Kush janë ata t'u flas për babain tim. Asnjë fjalë. Babain e kam njohur vetëm në Prishtinë. Duhet të kthehem atje për ta rinjohur. Jashtë nuk ka qenë

i njëjti. Ajo mbyllje në dhomën e tij në mansardë. Ai ballë i rrudhur, ajo buzëqeshje e tretur. Interesi i humbur për gitarën e vetë, për flautën time. Atëherë s'kam ditur gjë, tash e di si ia hëngrën shpirtin paknapak përditë. Ai për mua kishte humbur në Gjermani. Bishat ia hëngrën zemrën. Tash duan të ngjallen si kufomat e gjalla rreth hijes së tij. Jo. Nuk lejoj, nuk dua. Çka kanë bërë për të, asgjë. E kanë veshur vdekjen e tij me një vel të mjegullës, me peshën e territ. Jo! Pushim. Ç'është ky vrap i mjerë i njerëzve që duan të gjejnë identitetin e vet te tjetri në vonësë kohe." (f. 88-89)

-5. NJË JAVË U GRINDËM PËR GURËT E YJET

Skena II-1

Kjo skenë zhvillohet në Kopshtpelë (Shtutgart) tek varrezat kryesore, Hauptfriedhof, Steinhaldenstrasse 52, 70378 Stuttgart, ku nga 5 shkurti 1982 deri më 24 shkurt 2002 ishin të varrosur Vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zeka.

Xhafer Durmishi: "Fjalë të gdhendura në gurët e varreve që për 20 vite qëndruan në Shtutgart. Epitafi në gurët e varreve të Jusufit dhe Bardhoshit u shkrua nga unë. Epitafi në gurin e Jusufit:

"Luftoi dhe mbeti yll i pashuar në qiellin shqiptar"

"Në fshatin Untergruppenbach afër Shtutgartit të Gjermanisë, mbi varrin e një të riu shqiptar, 31 vjeçar gjendet ky epitaf:

'Këtu prehet dhe pret një ditë Besniku i Kosovës'.

Mbase do të mjaftonin këto dy radhë për të shprehur dramën e këtij të riu, të cilën në njëfarë mënyre e përjeton sot Kosova, me të vetmin ndryshim që dita e shumëpritur sot duket më e afërt se kurrë. Është fjala për Bardhosh Gërvallën." (Luti Dervishi, Nga fjala në tubimin përkujtimor mbajtur në Tiranë më 1992)

Nga të afërmit e Kadri Zekës në Zvicër për gurin e varrit të tij u shkrua ky epitaf:

"Lavdi komunistit dhe organizatorit të paepur gjer në fund"

S. H.: "GJERGJI – Ndarja shihet në gurët e varreve. Stema dhe ylli, ah ylli. Shihi fjalët e gdhendura në gurë. I bashkon vdekja e përnjëhershme dhe trolli i huaj ku pushon trupi i tyre.

DONA, afrohet, nëpër lot.

Yjet pesëcepëshe i ke të paprishura.

ZANA – Një javë u grindëm për gurët e yjet. Na shpëtuan gjermanët...

GJERGJI – Çfarë kanë këtu gjermanët?

ZANA – Unë kërkoja stemën. Këqja e Lula ngulnin këmbë në yjet. Stemat, yjet, stemat, yjet! K. E Lula donin që yjet të gdhendeshin në formë të madhe. Gjermanët thanë se kjo nuk lejohet me ligj. Kjo është tokë gjermane dhe ndryshe nuk bënë. U gjet kompromisi, të gdhenden stemat e yjet në gurë njëra nën tjetrën. Qeshet hidhur." (f.91-92)

Sabri Novosella: "Varret ishin të rregulluara shumë mirë, me lapidar për secilin veç e veç. Në lapidar shkruante: Atdhetari Jusuf Gërvalla, Atdhetari Bardhosh Gërvalla, komunisti Kadri Zeka. Ishte zhvilluar një debat i gjatë kur ishte vendosur se si të shkruhet në lapidar, "atdhetar" apo "komunist". Hafiz Gagica e Xhafer Durmishi ishin konsultuar me mua dhe unë nuk kisha lejuar që në lapidar kurrsesi të mos shkruhet epitafi komunisti, por atdhetari. Këtë e kishte përkrahur edhe gruaja e Jusuf Gërvallës, Suzana. Gruaja e Kadri Zekës, Saima Jusufi, Hasan Mala, ndërkaq, kishin qenë kategorik që të shkruhet epitafi "komunisti" mbi lapidar. Ashtu edhe ishte vepruar. Jusufit e Bardhoshi t'u shkruhej "atdhetari", ndërsa Kadriut "komunisti". (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, www.sabrinovosellamaxhuni.com)

Varrimi i 5 shkurtit 1982 në Shtutgart ka qenë varrim sa i thjeshtë aq edhe madhështor. Në çështjen e formës, germave dhe simboleve në gur nuk ka pasur ndikim as Suzana e as Sabri Novosella. Gurët e varreve janë vendosur nga firma e caktuar në vjeshtë 1982. Kjo është bërë për shkak se duhet të kaloj një kohë e mirë derisa të qetësohet dheu mbi varre. Në këtë kohë Suzana ka qenë në Shqipëri dhe lidhjet me te nuk kanë qenë të lehta. Në Shqipëri, Suzana ka shkuar më 28 mars 1982.

Suzana Gërvalla: "U bë një vit që u largova ndaj jush dhe ende nuk morra ASNJË letër prej jush. Unë letër drejt për së drejti nuk ju kam dërguar, por përshëndetje ju kam que disa herë. Nuk më besohet se e haruat aq shpejtë shoqen e luftës, e cila i ndau të mirat e të këqijat me ju atje në mërgim. Ju na latë tash kur ne na duhet përkrahja e juaj më së shumti, tash kur mbetëm pa Jusufin e Bardhin e pa asnjë anëtarë të familjes." (Letër Faridin Tafallarit, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

Kjo letër e Suzanës e 22 shkurtit 1983, është kontakti i saj i parë me shokët e Shtutgartit pas 28 marsit 1982. Kjo do të thotë se pohimet e Sabri Hamitit, Sabri Novosellës dhe në mënyrë të aluduar, nëse janë të Suzanës, nuk janë të vërteta pasi faktet flasin krejt ndryshe.

Quittung		DM in Ziffern	Pf
Nettowert			
+ % MwSt			
Gesamtbetrag		- 4.344	
Deutsche Mark in Worten		Deutsche Pfennige wie oben	
- Viertausenddreihundertvierundvierzig			
von Herrn Ramadan Namija, Esslingen			
Königsplatzstr. 12			
für Anzahlung für 3 Grabsteine			
richtig erhalten zu haben, bestätigt			
Ort	Ostfildern 2	Datum	27.7.1982
Buchungsvermerke	Stempel/Unterschrift des Empfängers: Siegfried Allmendinger Kunststeine • Natursteine • Grabmale 7302 Ostfildern 2 (Esslingen) Rudolf-Diesel-Str. 24 • Tel. 0711/341985		

Vërtetimi i pagimit të gurëve të varrezave, i datës 27 korrik 1982

Gdhendjen e gurëve të varrezave e ka bërë kjo firmë gjermane:

SIEGRFRIED ALLMENDINGER
 KUNSTSTEINE-NATURSTEINE-GRABMALE
 Rudolf-Diesel-str. 24
 7302 OSTFILDERN 2
 Tel. 0711-341985

Megjithatë, nga fjalët e mësipërme del se Suzana apo Sabri Novosella, epitafin e Jusufit, tekstin mbi gurin e Jusufit e Bardhit, ashtu si dhe fjalët për veprën e idetë e tyre do t'i kishin skalitur më mirë. Me shokët e Kadri Zekës nuk është bërë kurrfarë debati në këtë pikë, as i gjatë e as i shkurtë. Ata nuk i kemi pyetur për epitafin e Jusufit dhe Bardhoshit dhe ata nuk na kanë pyetur apo marrë leje se çka të shkruajnë në gurin e varrit të Kadri Zekës. E vetmja pyetje për drejtorinë e organit për mbikëqyrjen e varrezave ka qenë: a është e mundur që një sfond i shqiptonjës në gurë të jetë me ngjyrë të kuqe si në flamur. Përgjigja gjermane ka qenë: Jo! Ngjyra e kuqe nuk përdoret në gurët e varrezave. Edhe kjo temë është mbyllë me një pyetje të vetme dhe këtui nuk ka pasur kurrfarë shpëtimi nga gjermanët e as kurrfarë grindjeje me shokët e Kadri Zekës.

Gdhendja e tre gurëve, pa e llogaritur këtu sigurimin, ka kushtuar 5145,36 DM. Më 27 korrik 1982, Nami Ramadanit i ka paguar 4344 DM. Më 30 korrik 1982, firma e lartpërmendur ia ka dërguar Nami Ramadanit, Karlsbaderstr. 12, 7300 Eslingen, faturën e dytë të një shume prej 802,36 DM. Pra $4344 + 802,36 = 5145,36$ DM.

Xhafer Durmishi: *"Shoku Engjëll (Kolaneci)"*

Në prag të festës (28 Nëntorit 1982-shën i Xh. D.) F(aridini) më njoftoi për bisedën telefonike që paska pasur me ju. Me këtë rast më tregoi se tek ju paskan ardhur letrat e Dritës (Suzanës). Siç ju pata thënë edhe më parë, neve na u deshtë që gurët t'i rregullojmë me çdo kusht para festës (28 Nëntorit 1982-shën im), dhe siç mund t'ju ketë treguar shoku Faridin, ata (gurët) u vendosën e me sa duket janë të punuar mirë. Edhe njerëzit kanë dhënë vlerësime të mira, por ndonjë fotografi ende nuk ma kanë sjellë shokët. Ne huazuam një shumë të hollash për këtë rast dhe paguam një pjesë për të cilën të kam pas treguar. Firma e gurëve, në të vërtetë më kompetentja, se këto rregulla këtu unë nuk i di, por si më kanë treguar e ka bërë punën në atë mënyrë që, kur të kthehet letra (autorizimi) i Suzanës do të na kthehen të hollat. Siç e dini, në atë letër Suzana autorizon një njeri që të përgjigjet në çdo rast për sigurimin e gurit të të shoqit, për arsye se ajo nuk ka banim të përhershëm në mërgim.

Përndryshe ne jemi mirë, edhe punët janë duke shkuar mirë. Te fala S. (Xh. Durmishi)" (Letër Engjëll Kolanecit në Ambasadën Shqiptare në Vjenë, Nëntor 1982; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 255)

Me një rast të vetëm për ndihma juridike për llogarinë të Suzanës, avokatit të autorizuar të saj i janë dhënë 2434 DM.

Vërtetimet e Faridin Tafallarit tregojnë se për çështje që kanë të bëjnë me varrimin, dhe sigurimin e gurëve, më 17 prill 1983 janë bërë dy pagesa. Njëra kap shumën 2102 marka gjermane (DM) dhe tjetra 8003 marka gjermane (DM). Në këtë drejtim në bazë të shënimeve Faridin Tafallari ka ndihmuar me 2355 marka gjermane, Nami Ramadanit me 450 DM. Për sigurimin e gurëve të varreve ndihma ka dhënë edhe Qemal Haxhillari, bashkëfshatar i Faridinit.

Në bazë të faturave që më janë siguruar rrjedh se Faridin Tafallari, vetëm për periudhën nga 9 marsi 1983 – 20 janar 1991 ka paguar 2842,42 DM për mirëmbajtjen e gjelbërimit të përhershëm me lulet e çdo stine tek varret e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit. Kjo punë ka vazhduar pandërpre deri në shkurt 2002. Për mbajtjen e gjelbërimit të përhershëm, përveç Faridinit ka ndihmuar sidomos me kohën dhe angazhimin e tyre çifti Vedat dhe Sadrije Saliu nga fshati Veleshtë e Strugës, me banim në Shtutgart. Hafiz Gagica i cili ka banuar tërë kohën në Shtutgart ka dhënë gjithashtu një kontribut të jashtëzakonshëm.

Ka shumë e shumë aktivist që ruajnë fakte të rëndësishme për kontributin e tyre në atë kohë të lavdishme por këto fakte i ruajnë me xhelozë, ndoshta për mendimin tim, më të madh se sa është e nevojshme, duke pritur njeriun e denjë të cilit do t'ia besonin ato.

-6. FOL ME LULËN QË T'I FLET KEQËS

Skena II-2

Ngjarja zhvillohet në një restorant oriental, sigurisht në Shtutgart, pas procesionit tek varrezat. Janë të mbledhur anëtarë të familjes së Jusufit e Bardhoshit, miku i vetëm i Jusufit, Gjergji. Përveç tyre janë edhe Baca i Lulit dhe Lula. Baca i Lulit, si më i vjetri në tubim e merr fjalën duke e falënderuar Gogon, burrin e Donës, i cili i ka ftuar në mbrëmje.

S. H.: "BACA I LULIT, ngre gotën. Mbasi jam më i vjetri, m'i jepni dy fjalë. Qetësi e rëndë. Ju përshëndes të gjithëve e, sado të duket e çuditshme, jam i gëzuar që jemi bashkë sonte këtu. Edhe më i gëzueshëm do t'isha po t'ishin bashkë të gjithë, ajo turmë që nderonte sot vëllezërit e shokët tanë, se ata nuk janë më vetëm tanët po të të gjithëve. Para të gjithëve e falenderoj Gogon, që më ka ftuar. Ju e dini që unë jam për herë të parë jashtë. Më ka rënë vëllai, s'kam mundur ta varros. Sot, mbas kaq vitesh e pash varrin e tij. Mund ta merrni me mend dhembjen e zbrazëtinë time në shpirt. Po, edhe ju ndoshta e keni pasur më rëndë që e keni parë me sytë tuaj tragjedinë. Pushim. Jemi krenarë të gjithë në këtë dhembje, jemi krenarë për jetën e tyre. Ne duhet të ndjekim rrugën e tyre. Të gjithë së bashku, pa bashkim s'ka gjë. Gëzuar.

DONA: Bashkim!... Rrugë. Fjalë, fjalë, vetëm fjalë. E konkrete asgjë. Jam e lodhur nga fjalët. ...

... BACA I LULIT: Ata që bëjnë rrena e shpifje duhet të dënohen bashkarisht, e të jemi si një.

Plani i Partisë Komuniste (PKMLSHJ): "Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës“ i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave, **krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve, por edhe në mesin e mërgimtarëve.**" (Nuhi Sylajmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)

DONA: O burrë, po a nuk t'i kanë shurdhuar veshët gjithë ato shpifje, gjithë ato fjalë të shumëzuara në gazeta për Gegën, për Sofon, për Jusin, për dreqin e mallkuar dhe njeri i gjallë s'e sqaron rolin e tyre. **Po ti mund të flasësh me Lulën. Dhe ajo mund të flas me Keqën. Heshtje. Ja Keqa, ku e ke?**

BACA I ISËS: Gega di shumë, po Gega nuk flet. Ai nuk u shfaq kurrë më, as para burgut, as pas burgut. Udha e tij për Prishtinë dhe kthimi i tij janë plot pikëpyetje që don sqarim. Sqarim nga vetë Gega. E kam thirrë sa herë edhe publikisht të jap shpjegime. Ai vetëm hesht. Fundi i fundit Gega na ka borxh për gjithë jetën shpjegimin. **Mundet që edhe këtu ka njerëz që mund të thonë diçka për Gegën e heshtjen e tij.**" (f.95-100)

Është interesant të përkujtojmë se çka është thënë në pjesën e parë, skena 3, dhe pse Baca i Isës thotë se mundet që edhe këtu, rreth tavolinës, ka njerëz që mund të thonë diçka për Gegën dhe heshtjen e tij.

S. H.: "GEGA – Nuk të kisha njohur. Unë jam Gega!.. Më kanë folur shokët. ... Shokët e kanë një fjalë me ty. ...Unë... Nuk di si... Shokët thonë se ti punon krye në veti, nuk e pyet askend... Shokët thonë se ti i nënçmon shokët, që moti.

ISA – **Kush janë shokët?**

GEGA – Të gjithë shokët, me rend. **Luli e Keqa.** Porosia e shokëve është se kush punon krye në vete, punon kundër Lëvizjes... Shkurt e shqip, punon për armikun... Tamam puna. Kush jam unë që t'i njoh ata. Unë marr e kryej detyra. Kaq mundem, kaq bëj. Për punët e tjera le të mendojë Komiteti.

ISA – Komiteti?

GEGA – Komiteti i Lëvizjes. ... vë dorën në xhep. Unë nuk mundem... Unë nuk di... më kanë thënë. Nxjerr revolen dhe e vë në tavolinë. ... Më kanë thënë se e vret një tradhtar!" (f.30-36)

7. NE MBETËM PA ASKË PRANË

- 1. USHQIMI I TYRE ISHTE NEKTARI DHE AMBROSIA
- 2. NA LINTE SIKUR FËMIJËT KUR I LE E AMA
- 3. JU JEPSHA GAJRET TË GJITHËVE POR ATËHERE E KISHA GJITHË SHOQËRINË E JUSUFIT ME VETE
- 4. NUSJA E BARDHYLIT E KTHYE, NE MBETËM PA ASKË PRANË
- 5. PATA VËREJTJE PËR PUNËN E TYRE
- 6. TË FALA S'PO NA ÇOJNË ASNJËHERË

-1. USHQIMI I TYRE ISHTE NEKTARI DHE AMBROSIA

Lista e atyre që u ushqyen me nektar dhe ambrosia prej gazetave të Jusuf Gërvallës; Lista e atyre që ndihmuan luftën dhe u qëndruan afër familjeve të të vrarëve në Kështjellën e Vëllezërve Gërvalla dhe me këtë e nuk ia lejuan UDB-së Serbe dhe vrasësve të saj ta shuaj si subjekt edhe Lëvizjen e tyre Nacionalçlirimtare:

<i>Shokët e Remzi Ademajt</i>	1990 DEM
<i>Shokët e Remzi Ademajt nga Mynheni</i>	6240 DEM
<i>Shokët e Remzi Ademajt nga Heilbroni</i>	2520 DEM
<i>Shoku i Remzi Ademajt</i>	260 DEM
<i>Shoku i Remzi Ademajt – kroat</i>	50 DEM
<i>Shokët e Remzi Ademajt</i>	200 DEM
<i>Shokët e Remzi Ademajt</i>	386 DEM
<i>Shokët e Remzi Ademajt nga Mynheni</i>	920 DEM (bashkarisht 12566 DM)

Sabri Hamiti: "ISA – Donë gazeta e janë gjysmanalfabetë." ...
 "ZANA, pa përfillje. Nuk kam çka sugjeroj në mënyrë të veçantë. **Sa për miqtë e Isës, ai i ka pasur dy miqë të mirë, Nakun e Gjergjin. Ata mund t'ju flasin çka e vlen, për veprën e tij.**" (Faqe 24 dhe 83-84)

<i>„Shoqëria Vullneti“</i>	11970 DEM
<i>Klubi „Emin Duraku“ i Dyseldorfit</i>	9480 DEM
	26500 BEF
	700 FRF
	150 DEM
<i>Vëllezërit nga Berni</i>	1410 SFR
	2000 SEK (bashkarisht 21960 DEM (pa valuta tjera)

<i>Miku i Hasan Malës nga Manhajmi</i>	200 DEM
<i>Shokët e Shaqir Shabanit nga Manhajmi</i>	210 DEM
<i>Shokët e Mynhenit, Abdyl Pacolli</i>	330 DEM
<i>Hetem Fejza me shokë</i>	300 DEM
<i>Tezaku i Hysenit</i>	50 DEM
<i>Shokët e Murat Kryeziut</i>	500 DEM
<i>Shoku i bacit Jahë</i>	20 DEM
<i>Shokët nga Sindelfingeni</i>	120 DEM
<i>Shokët nga Zvicra</i>	500 DEM
<i>Shokët nga Cyrihu</i>	200 DEM
<i>Shokët nga Berna</i>	200 DEM
<i>Shokët e Shtutgartit</i>	500 DEM

Sabri Hamiti: "ISA – Donë gazeta e janë gjysmanalfabetë." ...
"ZANA, pa përfillje. Nuk kam çka sugjeroj në mënyrë të veçantë. Sa për miqtë e Isës, ai i ka pasur dy miqë të mirë, Nakun e Gjergjin. Ata mund t'ju flasën çka e vlen, për veprën e tij."

<i>Shoqëria Bernhausen</i>	300 DEM
<i>Shoqëria Ahmet Sadikut nga Frankfurti</i>	490 DEM
<i>Shokët nga Mynheni</i>	600 DEM
<i>Shokët nga Ludvigsburgu</i>	330 DEM
<i>Ramadani dhe shoku i tij</i>	200 DEM
<i>Shoku i Nami Ramadanit</i>	100 DEM
<i>Shokët nga Manhajmi</i>	250 DEM
<i>Shokët nga Bitigahjmi</i>	1100 DEM

Donika Gërvalla: "Në anën tjetër ka mjaft persona që nga atentati i 17 janarit 1982 përpiqen të fitojnë kapital politik." (17 janar 2010, <http://gervallablog.com>)

<i>Shoku i Zhujit</i>	100 DEM
<i>Shoqëria Mörs – 3 Replenstrase 14</i>	2200 DEM
<i>Solidariteti Bremen</i>	1300 DEM
<i>Solidariteti "Fronti Popullor"</i>	240 DEM
<i>Ramadan Kurtishi me shokë.</i>	
<i>Këta shokë dhanë gjithsej</i>	930 DEM
<i>Shokët nga Zvicra</i>	980 DEM
	+250 SFR+2130 dinarë
<i>Shokët nga Manhajmi</i>	330 DEM +100 BFR
<i>Miku i Zhujit</i>	300 DEM
<i>Shokët e Zhujit</i>	170 DEM
<i>Shokët e Ahmet Sadikut</i>	
<i>nga Dajmleer Benz kontributi i librave</i>	140 DEM
<i>Shokët nga Manhajmi</i>	250 DEM
<i>Frankfurti</i>	970 DEM

Sabri Hamiti: "ISA – Donë gazeta e janë gjysmanalfabetë." ...
"ZANA, pa përfillje. Nuk kam çka sugjeroj në mënyrë të veçantë. Sa për miqtë e Isës, ai i ka pasur dy miqë të mirë, Nakun e Gjergjin. Ata mund t'ju flasin çka e vlen, për veprën e tij."

<i>Shoku i Mynhenit</i>	100 DEM
<i>Shoku i Nami Ramadanit</i>	20 DEM
<i>Shokët e Zvicrës</i>	1100 SFR
<i>Shoku i Ulqinit</i>	140 DEM
<i>Shokët e Zhujës</i>	600 DEM
<i>Shokët e Murat Kryeziut</i>	200 DEM
<i>Fqinjët gjermanë nga Untergruppenbach</i>	790 DEM (bashkarisht 16260 DEM)
Në mënyrë anonime, përmes shokëve të vet janë dhënë 50786 DM (Marka Gjermane)	
2760 SFR (Franga Zvicëranë= 3353 DEM, 26600 BEF (Franga të Belgjikës) =1412 DEM, 700 FFR (Franga Franceze)=259 DEM	
2000 KR (Korona Suedeze)=774 DEM, 2310 dinarë	
Shuma totale së bashku me valutat tjera 56584 DEM	

<i>Osman Shemsiu e Shaip Bukoshi</i>	400 DEM
<i>Skënderi me një shoqe nga Ludvigsburgu</i>	200 DEM
<i>Hysen Gërvalla</i>	200 DEM
<i>Rifat Kadriu</i>	620 DEM
<i>Sylejmani nga Boni</i>	100 DEM
<i>Zymer Kryeziu</i>	1200 DEM
<i>Ademi</i>	100 DEM
<i>Ahmeti</i>	100 DEM
<i>Ramushi</i>	100 DEM
<i>Shaqir Shabani</i>	140 DEM
<i>Ademi me një shok, ka shitur fotografi dhe atë shumë e ka dhënë për ndihmë</i>	10 DEM +50 SFR
<i>Elfi Agushi, Gjenevë (nga Ferizaj)</i>	500 DEM
<i>Jahir Jahiri</i>	500 DEM
<i>Qemal Haxhillari</i>	200 DEM
<i>Vezir Kelmendi</i>	100 DEM

Sabri Hamiti: "ISA – Donë gazeta e janë gjysmanalfabetë." ...
"ZANA, pa përfillje. Nuk kam çka sugjeroj në mënyrë të veçantë. Sa për miqtë e Isës, ai i ka pasur dy miqë të mirë, Nakun e Gjergjin. Ata mund t'ju flasin çka e vlen, për veprën e tij."

<i>Drejtori i shkollës Gjermane</i>	100 DEM
<i>Fahredin Tafallari</i>	500 DEM
<i>Nami Ramadani</i>	1000 DEM
<i>Fetahu</i>	200 DEM
<i>B. Ramadani</i>	100 DEM
<i>Latifi</i>	500 DEM
<i>Fazliu</i>	200 DEM
<i>Mahmut Agushi përmes postës</i>	1000 DEM
<i>Muhameti</i>	100 DEM
<i>Zhuji</i>	200 DEM

Niman Osmani	200 DEM
Besim Rexha	100 DEM
Shokët: Smajl Jashari, Arif Jasiqi, Magllan Jahaj, Zenel Gjocaj, Muhamet Dukaj, Mustafë Mazrekaj,	
Nysret Hajdari nga Beningeni/ nga Prishtina	530 DEM
Nuhi Sylejmani nga Sindelfingeni/ nga Llojani	500 DEM
Shabani	100 DEM
Mustafë Bajraktari	100 DEM
Dinë Salihu	100 DEM
Haxhi Berisha	100 DEM
Isa	50 DEM
Sami Ramadani nga Smira	100 DEM

Sabri Hamiti: "ISA – Donë gazeta e janë gjysmanalfabetë." ...
 "ZANA, pa përfillje. Nuk kam çka sugjeroj në mënyrë të veçantë. **Sa për miqtë e Isës, ai i ka pasur dy miqë të mirë, Nakun e Gjergjin. Ata mund t'ju flasin çka e vlen, për veprën e tij.**" (Faqe 24 dhe 83-84)

Halim Hasanaj	100 DEM
Ragbi nga Zyrihu	900 DEM
Halili nga Mynheni	200 DEM
Rizah Hoxha	100 DEM
Eshref Morina	100 DEM
Kamber Bajram Alija	20 DEM
Sonja me një shoqe	1300 DEM
Besim Rexhaj	700 DEM
Përmes postës Selim Bega nga Franca	386.84 DEM
Zymer Basha	200 DEM
Ramë Hysaj nga Erlageni	100 DEM
Rifat Kadriu nga Mynheni	100 DEM

Donika Gërvalla: "Në anën tjetër ka mjaft persona që nga atentati i 17 janarit 1982 përpiqen të fitojnë kapital politik." (17 janar 2010, <http://gervallablog.com>)

Hajrullah Rugova	100 DEM
Kadri Ipek	200 DEM
Shuma totale	14756,86 DEM
	+ 50 Frangat Zvicërene
	14817,61 DEM

Shuma totale (nga ata që ndihmuan pa i dhënë emrat e mbiemrat)	56584 DEM	79%
Shuma totale (nga ata që ndihmuan dhe emrat tyre u shënuan me pëlqimin e tyre)	14817 DEM	21%
	71401 DEM	

Lista e atyre që në momentet më të vështira të dhembjes, nuk i lanë vetëm familjet e të vrarëve është marrë nga: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f. 157. Përveç të dhënave nga Nuhi Sylejmani, fushata për ndihma lidhur me rastin e 17 janarit 1982 janë bërë edhe në Australi dhe SHBA. Vlen të theksohet se me Kështjellën e Jusuf Gërvallës kanë qenë të lidhur përveç të tjerëve edhe **Bytyqët nga skajet e ndryshme të Botës**, siç kanë qenë Rilind Bytyqi nga Australia, Sejdi Bytyqi nga New Yorku, Sadije dhe Ibush Bytyqi nga Parisi, Leme dhe Sylejman Bytyqi nga fshati Kravasari, me adresë në Kirch winkel str.5, 5031 Peine, West Germany dhe Mejdi Bytyqi nga Heilbroni e shok i Remzi Ademit.

Rilind Bytyqi dhe Shoqëria Bashkimi Kombëtar "Bajram Curri" në Australi, me të cilët e kisha siguruar unë kontaktin përmes Pajazit Ibrahimit kanë mbledhur ndihma, si për familjet Gërvalla ashtu edhe për shoqen e Kadri Zekës. Çeku bankar që ka ardhë në Shtutgart nuk ka mundur të përdoret pasi ka qenë në emër të një pseudonimi. Sa i përket ndihmës për shoqen e Kadri Zekës i kam drejtuar në adresën që më është dhënë në Zvicër. Kjo është krejt çka di në këtë pikë.

Sejdi Bytyqi nga New Yorku, i cili adresën e Kështjellës së Jusuf Gërvallës e ka siguruar nga policia e New Yorkut, në një letër më 5 qershor 1982 më shkruan këto fjalë:

Sejdi Bytyqi: "...gjithashtu tani u hap fushata edhe për ndihmën e dy të vejave të vëllezërve Gërvalla." (Letër Xhafer Durmishit, 5 qershor 1982)

Përveç Sejdi Bytyqit, në një letër të atyre ditëve (pa datë), nga Amerika thuhet kështu:

"Komiteti Shqiptar i Detroitit me rrethe, ditën përkujtimore të dëshmorëve të ri të Kosovës, hapi një fushatë të vogël, më tepër shpirtërore se financiare, të posaçme për familjet e vëllezërve Gërvalla.

Në të njëjtën kohë të gjithë shqiptarët e Michiganit ju ngushëllojnë me zemër për humbjen tragjike tuajën dhe tonën si vëllezër shqiptar. Zoti i past buzë vedit

*Me nderime dhe respekt, **Julian Efa, Xhevdet Hoxhaj**"*

Nga Faridin Tafallari më janë dhënë këto shënime që kanë të bëjnë me këtë kohë:

-Shaqir Salihu, nga New Yorku, përmes "THE NORTHERN VIRGINIA BANK" më 23 qershor 1982, në emër të Suzana Gërvallës, i ka dërguar në Gjermani 2000 dollar amerikan, por çeku nuk është tërhequr për arsye se Suzana nuk ka qenë në Gjermani.

-Besim Rexha përmes shokëve të vet i ka mbledh me një rast 700 DM. Në listën e Nuhi Sylejmanit më lart, figuron emri Besim Rexha dhe shuma gjegjëse 700 DM, por këtu është fjala për shumë tjetër të mëvonshme. Vërtetimi i përpiluar nga Besim Rexha ka këtë listë:

<i>"Emri</i>	<i>Adresa</i>	<i>Telefoni</i>	<i>Shuma në DM</i>
1. Besim Rexha,	Heiderstr. 4, 5620 Velbert 1,	02124-52528	100
2. Lah Dula,	Orleanstr. 5A, 8 Munchen 80,	089-482837	100
3. Anonim	-	-	50
4. Anonim	-	-	30
5. Petrit Gega, Launigenstr. 19,	8871 Gundremingen, Baracke-XI-18,		50
6. Anonim	-	-	50
7. Syl Hasanaj, Kantstr. 15,	8522 Herzogenaurach	-	100
8. Hajrullah Krasniqi, MartinBühlerstr. 5A,	8520 Erlangen	0913-147625	100
9. Hamit Aliu, Auf dem brink 7B,	3250 Hameln-Herkendorf	051581312	100
10. Besim Rexha	-	-	20

Shuma totale 700 DM

*I dorëzoi në Untergruppenbach
me 12 prill 1982
Besim Rexha*

*I Muar
Tushë Gërvalla
Nënshkrimi i Tushës"*

Sabri Hamiti: *"Donë gazeta e janë gjysmanalfabetë."* (f.24)

Jusuf Gërvalla: *"... thua se vetëm në "nivele" tim të shkrimit paska për mua afrim, respekt e dashuri për njerëzit! E çka do të kish qenë "nivele" im, sikur t'u jepej flirteve absurde narcisoide me vetveten dhe të injoronte faktin, se ka pa numër virtyte të tjera, që mund ta marrin vizën e njerëzisë para se një aftësi mesatare e të shkruarit?! Ky është ofendimi më i madh, që më ke bërë ndonjëherë: të më zhveshësh nga gjithçka njerëzore dhe të më identifikosh me një aftësi gati-gati mediokër të shkrimit!"* (Letër Ibrahim Kelmendit; Faridin Tafallari, *Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme*, Tiranë 2010, faqe 282)

-2. NA LINTE SIKUR FËMIJËT KUR I LE E AMA

Skena II-3

S. H.: *"Në banesën e Gogos në mbrëmje... . Në dhomë pushon zhurma e sundon qetësia. Janë kokë më kokë Gjergji e Zana."* (f.102)

S. H.: *"ZANA – Mbetëm vetëm. Ti ishe në burg, Baca i Isës ishte në burg. Lokja mezi erdhi në varrim dhe u kthye në Lisnajë. Nusja e Bardhylit poashtu. Ne mbetëm pa askë pranë. Unë me fëmijët. Dhe shkuam në Tiranë."* (f.104)

Faridin Tafallari: *"Tani Suzana dhe fëmijët e saj po përgatiteshin për të ikur dhe neve na linte sikur fëmijët kur i le e ama. ... Pasi iku Suzana, këtu mbeti Tusha, e shoqja e Bardhoshit; ajo bashkë me fëmijët e vet do të kthehej në Kosovë. U nis edhe ajo dhe tani shtëpia ku kishin banuar Vëllezërit Gërvalla mbeti e zbrazët. I paharruar do të mbetet ky vend për ne shqiptarët, kudo që të jemi."* (Terror-Dhimbe-Qëndresë, faqe 60)

Suzana u nisë nga Untergruppenbachu për në Shqipëri, përmes Vjenës, më 28 mars 1982. Në Untergruppenbach e rrethuar me përkrahjen dhe ngushëllimet e shokëve mbeti gruaja e Bardhoshit, Tusha edhe 48 ditë tjera. Tusha u kthye në Kosovë më 15 maj 1982.

-3. JU JEPSHA GAJRET TË GJITHËVE POR ATËHERE E KISHA GJITHË SHOQËRINË E JUSUFIT ME VETE

Suzana Gërvalla: *"Vllëzër të dashur Faredin e Nuhi!*

U bë një vit që u largova ndaj jush dhe ende nuk morra asnjë letër prej jush. Unë letër drejt për së drejti nuk ju kam dërguar, por përsëritet ju kam que disa herë. Nuk më besohet se e haruat aq shpejtë shoqen e luftës, e cila i ndau të mirat e të këqijat me ju atje në mërgim. Ju na latë tash kur ne na duhet përkrahja e juaj më së shumti, tash kur mbetëm pa Jusufin e Bardhin e pa asnjë anëtarë të familjes.

Ne me të vërtetë këtu kemi shoqëri të re dhe përkrahje të madhe por mendë i kemi atje te ju te varrezat e Shtutgardit, se atje i lam ata ma të afërmit. E tash nuk dimë as si duken varrezat e tyre, spati kush me na que asnjë fotografi prej atjehit. Tash unë më nuk e shof as organin tonë, gazetën për të cilën e ka dhënë jetën burri dhe kunati im e të cilën e punova unë me këto duar pse ska kush me ma que prej atjehit.

Ta dini se jam prekur shumë prej jush. As ata djemtë të tjerë nuk shkruajnë por ata janë të rinj e agjami dhe nuk jua nxo për të madhe por prej jush kam pritur më shumë. Po qaj unë që nuk qajta në ato momente më të vështira të jetës sime, po qaj unë që ju jepsha gajret të gjithëve por atëhere e kisha gjithë shoqërinë e Jusufit me vete e tash më

latë të gjithë. Unë nuk e di pse na lat kështu, a nuk dita me ju dasht si vëllëzër apo nuk dita me ju bë hizmet sa duhet. Apo shkoj Jusufi e gruaja e fëmija e Jusufit nuk ekzisojnë më. Unë e di se ju keni shumë punë por e di edhe se keni kohë me e shkruar një letër më të cilën do t'i gëzoni tre jetimat e Jusufit dhe gruan e tij, të cilët kanë mbetur këtu krejtësisht të harruar nga shoqëria e vjetër. Ndoshta do të më nxoni për të madhe që ju shkruaj kështu por nuk mujta me duru më, nëse e teprua ju kërkoj falje." (Letër Faridin Tafallarit më 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77-78)

-4. NUSJA E BARDHYLIT E KTHYE, NE MBETËM PA ASKË PRANË

S. H.: "ZANA – Lokja mezi erdhi në varrim dhe u kthye në Lisnajë. Nusja e Bardhylit poashtu. Ne mbetëm pa askë pranë. Unë me fëmijët. Dhe shkuam në Tiranë." (f.104)

Suzana Gërvalla: "Ta dini se jam prekur shumë prej jush. As ata djemtë të tjerë nuk shkruajnë por ata janë të rinj e agjami dhe nuk jua nxo për të madhe por prej jush kam pritur më shumë. Po qaj unë që nuk qajta në ato momente më të vështira të jetës sime, po qaj unë që ju jepsha gajret të gjithëve por atëhere e kisha gjithë shoqërinë e Jusufit me vete e tash më latë të gjithë." (Letër Faridin Tafallarit më 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

-5. PATA VËREJTJE PËR PUNËN E TYRE

S. H.: "ZANA – Lokja mezi erdhi në varrim dhe u kthye në Lisnajë. Nusja e Bardhylit poashtu. Ne mbetëm pa askë pranë. Unë me fëmijët. Dhe shkuam në Tiranë." (f.104)

Suzana u nisë nga Untergruppenbachu për në Shqipëri, përmes Vjenës, më 28 mars 1982. Në Untergruppenbach e rrethuar me përkrahjen dhe ngushëllimet e shokëve mbeti gruaja e Bardhoshit, Tusha edhe 48 ditë tjera. Tusha u kthye në Kosovë më 15 maj 1982.

"Ndryshe nga Suzana, Tusha kishte vendosur të kthehej në Kosovë. Për t'i dalë në ndihmë kishte ardhur nga Kosova babai i saj, Haxhi Tahiri. Ishte e qartë se pas ikjes së Tushës duhej liruvar banesën ku kishte jetuar familja Gërvalla. Të shtunën e 8 majit në mbrëmje, derisa po bisedonim rreth kësaj çështjeje, në familjen Gërvalla erdhën për vizitë Nami Ramadani, Fahredin Tafallari dhe Sahit Tofaj. E vazhduam bisedën me brengën se pasi të largohej Tusha, gjithsesi duhej liruvar banesa. Aty kishte shumë materiale. Kishte parulla, afishe, flamuj e materiale të tjera propagandistike që duhej larguar. Ishte makineria radhitëse e shtypshkronjës së Jusufit dhe disa gjëra tjera ndoshta edhe të panevojshme. Propozova që punën e parullave të ma linin mua për ruajtje të sigurt. Nuk pranoi Xhafer Durmishi, duke e arsyetuar kundërshtimin e vet me atë se gjoja unë nuk marrkam vesh në këto punë të thella!

Ishin përgatitjet e fundit të Tushës për të udhëtuar në Kosovë. Ne e angazhuam Taip Toskin, që ditën e shtunë, të 15 majit 1982, t'i bartte me veturën e tij. Pasi i kishte përgatitur valixhet, u mor me përgatitjen e tre fëmijëve, Mirjetës, Visarit dhe Bardhoshes së porsalindur. Me mundësitë e mia ia dhurova 500 marka. Pastaj u përshëndeta me ta. Po këtë ditë u zhvendosa edhe unë nga banesa e familjes Gërvalla dhe u vendosa në Nagold, te Fahredin Tafallari. Bartja e gjëseneve, dhe bashkë me to edhe e parullave, u organizuan nga Hafiz Gagica, Hasani nga Podujeva dhe Hysen Spahiu. Pata vërejtje për punën e tyre." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f.137-138)

-6. TË FALA S'PO NA ÇOJNË ASNJËHERË

S. H.: "ZANA – Lokja mezi erdhi në varrim dhe u kthye në Lisnajë. Nusja e Bardhyllit poashtu." (f.104)

Tusha Gërvalla (gruaja e Bardhosh Gërvallës): *Mirë dita shok e vllazënë*

Po ju lajmrona të gjithëve se na imi mir tanë shnosh e mir po mërzhitem kapakë po ju si ini tanë me shnet ashtu edhe me punë si po kaloni, a po mërzhitni. Letra e juj sot me erdh shumë faleminderes prej jush. Edhe fotografit me erdhën shumë mir ishin kan marue. Shok po ju veti për Isufin edhe Bardhin se qysh janë a po mërzhiten. Të fala spo na qojne asniher. Për varrezat e tyne më tregut se kur po i nreqshin veq fotografoni e qonaj fotografit e vorreve të nrequna. Tash po ju ves për teshat e tyne vrasjes a jau kthynë policija hala apo qato tesha si t'jau kthejnë na i qoni për Miftarin kur të kthehet heren tjetër. Per Suzanën me tregut se ashtë mir dhe thmin se i ka mir. Per suksese te thmive shumë u gzova edhe për Suzanën si po studjojke më gzut. Me shnet si ashtë a po merzhitet apo ju shkrun shpesh. Edhe për pare po ju tregoj se erdhën ju rrit nera. Si ndihma mos kini dert me que kurr ni dinar se asht gjynah me e hangër njersen e huj. Edhe për paketa si më kerkut falje per vones nuk prishet kurgj kur të muni i qoni e falje po ju kerkoj une se e teprum me të gjitha veq ma bani hallall. Tash po ju ves për pension qka u ba a po del gj'a apo jo dhe a po duhet me nreq edhe unë kha gj'a a jo a vetem ju atje. Përkthyesit pagujani qdo punë si ta kryen.

Pensionin kur te del e qoni nëpërmjet Miftarit e kurkuj tjetër. Visari, Mirjeta ashtu edhe Bardhja mir janë rrit shumë. Tash spo ju lyp diqka. Ne mujshi me më que do sod të teshave bukur shumë se hiq spo gjinet. E qoni per Miftarin heren tjetër. Qetash nuk po dij se qka me ju shkrue. Suzanës bani shumë të fala ashtu edhe thmive. Mos t merzhitet fat e patëm. Shyqyr qe ashtë rahatue dhe po te ves a mundet me na shkrue drejt për drejt ajo. Me tregon se une letrën ia ktheva. Veq ishalla nuk ma nxini për të madhe ndoni gabim e kam ba pa qellim po kam gabue se sm ka ra qaq shumë me shkrue. E tash pritni të fala prej të gjithëve e shume prej meje të gjithë shoktë e shoqetë të fala. Tusha" (Letër nga Kosova shokëve në Shtutgart, vjeshtë 1982; gjendet tek Faridin Tafallari).

Faridin Tafallari iu dha më vonë autorizimi prej Suzanës dhe Tushës, që t'i përfaqësonte në Gjermani dhe t'i mbronte interesat e tyre në konsultim me avokatin e familjes Gërvalla. Suzana dhe fëmijët në Shqipëri nuk morën ndonjë ndihmë nga shteti Gjerman, sepse siç tregon Faridini, Entet e sigurimeve gjermane nuk kishin marrëveshje me Shqipërinë. Sa i përket Tushës dhe fëmijëve të saj, nga Shteti Gjerman, në Kosovë, si benificione të sigurimeve të Bardhoshit, prej 16 shkurtit 1983 deri në dhjetor 1984 iu përcollën, përmes Faridin Tafallarit, 125 mijë marka gjermane (DM).

Remzi Ademaj, më 11 dhjetor 1985, për hir të Jusuf e Bardhosh Gërvallës, nisat për në kufirin italo-jugosllav me detyrë që ta merr pjesëtar të familjes Gërvalla dhe t'u ndihmoj të dalin në Gjermani apo Zvicër. Në këtë detyrë arrestohet dhe pas procedurave të ndryshme bien në duart e policisë jugosllave dhe dënohet me 6 vjet burg.



Remzi Ademaj, në festën e 28 Nëntorit 1983

8. SHKUAM E NA ÇUAN

- 1. I DASHUR SHOKU ENVER
- 2. PËRCJELLJA E SUZANËS, PREMTONIT, DONIKËS DHE ERGONIT PËR SHQIPËRI

-1. I DASHUR SHOKU ENVER

Jusuf Gërvalla: *"I dashur shoku Enver!*

Djali im i vogël, dy vjeç e gjysmë, po llafosej me të motrën, tetë vjeçe ndaj të gdhirë, "Dua", i thoshte asaj, të vij me ty në shkollë! "Kur të rritesh edhe pak", ia ktheu ajo dhe shtoi me një dëlirësi të dhembshur fëmijënore: "Kur t'i bëhesh ti motrës për shkollë, ne do të jemi në Shqipërinë tonë të dashur!"

Sabri Hamiti: *"ZANA – Mbetëm vetëm. Ti ishe në burg, Baca i Isës ishte në burg. .. Ne mbetëm pa askë pranë. Unë me fëmijët. Dhe shkuam në Tiranë. – GJERGJI: Shkuat vetë?*

ZANA: Shkuam e na çuan. Refugjatë për së dyti." (Faqe 104)

Cicërrimë më të ëmbël, po edhe më prekëse, për të më nxjerrë gjumin e një mëngjesi të gdhirë me përtësë në dhe të huaj-thuaja se nuk kish.

Isha i lumtur që fëmija im s'e hiqte mendjeje mundësinë për të jetuar në Shqipërinë tonë të dashur. Por fjalët e saj më prekën shumë se sendërtimin e dëshirës së fëmijëve të mi dhe gjakimin tim, nuk e kisha unë në dorë.

Më 14 dhjetor të vitit të kaluar, UDB-ja e Pejës e arrestoi në shtëpinë e lindjes, në katundin Dubovik (afër Deçanit), vëllaun tim të madh, Hysen Gërvallën. Po këtë ditë, UDB-ja e Prishtinës mua ma kishte bastisur banesën në Prishtinë, pa prezencën time. Lajmin e hidhur ma solli në punë (në gazetën "Rilindja") shoqja ime, menjëherë pas bastisjes dhe pas largimit të inspektorëve të UDB-së nga banesa. Lidhur me arrestimin e vëllaut tim të madh dhe me materialet ilegale që kishin shtënë në dorë organet e Pejës, atë gruan time, e kishte informuar një kushëri im i parë. Materialet propagandistike të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës si dhe makina ilegale e shkrimit, në rast dorëzimi, do të më ngarkonin me shumë vjet burgim të rëndë.

Prandaj, duke marrë pëlqimin e shokut të parë të Lëvizjes, anëtar i Komitetit Qendror, unë u arratisa aty për aty. Më datë 21 dhjetor arrita në Ludvigsburg të RF Gjermane dhe u strehova te vëllau im i vogël Bardhosh Gërvalla, i cili këtu punon që nga viti 1974. ...

Unë, me të arritur në Ludvigsburg, i bëra telefon Ambasadës Shqiptare në Vjenë dhe prej shokëve të atjeshëm kërkova ndonjë këshillë se si mund të ruhem nga gabimet në një botë ku nuk kisha qenë kurrë më parë dhe ku, pasi kisha ardhur pa pasaportë e më duhej të kërkoja azil politik, kishte mundësi edhe për ndonjë gabim. Pak ditë më vonë, këtë gjë si dhe kërkesën për shqyrtimin e mundësive që të më jepet mundësia e strehimit në RPS të Shqipërisë, ia komunikova edhe me gojë njërit prej shokëve të Ambasadës së përmendur.

Sabri Hamiti: *"ZANA – Mbetëm vetëm. Ti ishe në burg, Baca i Isës ishte në burg. .. Ne mbetëm pa askë pranë. Unë me fëmijët. Dhe shkuam në Tiranë. – GJERGJI: Shkuat vetë?*

ZANA: Shkuam e na çuan. Refugjatë për së dyti." (Faqe 104)

Nga ajo kohë u bënë afro katër muaj dhe lidhur me kërkesën time nuk mora ndonjë përgjigje.

Ndërkohë, me iniciativën time, në të përjavshmen gjermane "Der Shpigel", u botua një artikull i gjatë për situatën aktuale në Kosovë, pas arrestimeve masive të shqiptarëve, të cilët duhet të përgjigjen para gjyqit jugosllav për vepra "kundër popullit dhe shtetit". Pos kësaj, gazetës së këtushme majtiste "Tageszeitung" i dhashë edhe një intervistë po

për gjendjen e përmendur. Shkrova edhe një numër artikujsh për gazetën ilegale shqiptare "Bashkimi", e cila qarkullon në radhët e punëtorëve shqiptarë me punë në Gjermani dhe në Kosovë.

Nga shokët e Kosovës më vinin kohë pas kohe porosi që të ruhesha, sepse UDB-ja, e cila është mësuar t'i qërojë me likuidime fizike hesapet me disa ustashë kroatë, kinse nuk qenka larg vendimit që një praktikë të tillë ta aplikojë edhe me shqiptarët në botën e jashtme. Nuk mund të them se s'më kanë bërë ndonjë përshtypje këto sugjerime të shokëve, por as njerëzve të UDB-së këtu, megjithë marrëveshjet dhe bashkëpunimin jugosllavo-gjerman, nuk ua kam aq shumë frikën. ...

Sabri Hamiti: "**ZANA** – Mbetëm vetëm. Ti ishe në burg, Baca i Isës ishte në burg. .. Ne mbetëm pa askë pranë. Unë me fëmijët. Dhe shkuam në Tiranë. – GJERGJI: Shkuat vetë?

ZANA: Shkuam e na çuan. Refugjatë për së dyti." (Faqe 104)

Por, që nga çasti i parë i arratisjes, unë e kam pasur mendjen të strehohem në Shqipëri. Prandaj, shoku Enver, mora kurajon të Ju drejtohem Ju personalisht. Kam njoftime për marrëveshjen shqiptaro-jugosllave lidhur me ekstradimin reciprok të personave të vënë jashtë ligjit në të dy vendet. Por, sipas Nenit 65 të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Shqipërisë, ku thuhet: "Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë u jepet e drejta e strehimit shtetasve të huaj që ndiqen për shkak të veprimtarisë së tyre në dobi të revolucionit e të socializmit, të demokracisë e të çlirimit kombëtar si edhe të përparimit të shkencës e të kulturës", konsideroj se mua më takon kjo e drejtë. Nuk dua të them se ma mohon kush, por, procedura e rëndomë e realizimit të saj po më dëmton fizikisht e shpirtërisht, shoku Enver. ...

Sabri Hamiti: "**ZANA** – Mbetëm vetëm. Ti ishe në burg, Baca i Isës ishte në burg. .. Ne mbetëm pa askë pranë. Unë me fëmijët. Dhe shkuam në Tiranë. – GJERGJI: Shkuat vetë?

ZANA: Shkuam e na çuan. Refugjatë për së dyti." (Faqe 104)

Nuk ishte punë e lehtë për mua të vendos që të Ju drejtohem Ju, shoku Enver, për një çështje që ndoshta nuk është e denjë të merreni me të. Në krahasim me të ligat që kanë rënë mbi kokë familjes sime para dhe pas lufte, me të ligat që kam përjetuar vetë dhe me situatën e përgjithshme shumë të vështirë në Kosovë, gjendja ime është, siç i themi ne nga Kosova, lule e dritës. Por, edhe deveja ka rënë, më gjunjë për një lëkurë lepuri që i është shtuar barrës së saj të rëndë.

Kur i marr parasysh çështjet në gjithë gjersinë e tyre, kërkesa për të m'u dhënë e drejta e strehimit në atdheun tim, më duket si një luks, dhe atëherë më rrëmben një ndjenjë turpi. Por i vetëdijshëm se në Kosovë, përderisa gjendja të mos ndërrojë rrënjësisht, këmba ime s'ka si shkel më sa të jem gjallë, e në anën tjetër, me këtë botë të huaj s'më lidh asnjë cikërrimë dhe këtu nuk shoh kurrfarë perspektive, e vetmja rrugë e drejtë dhe e njerëzishme më duket jeta në Shqipëri.

Sabri Hamiti: "**ZANA** – Mbetëm vetëm. Ti ishe në burg, Baca i Isës ishte në burg. .. Ne mbetëm pa askë pranë. Unë me fëmijët. Dhe shkuam në Tiranë. – GJERGJI: Shkuat vetë?

ZANA: Shkuam e na çuan. Refugjatë për së dyti." (Faqe 104)

Jam i vetëdijshëm edhe për disa probleme të pahijshme, që kanë shkaktuar disa kosovarë, duke dalë me qëllime të ulëta në territorin e RPS të Shqipërisë. Për fat, makinacionet e UDB-së, që në Kosovë e viset e tjera shqiptare brenda kufijve politikë të Jugosllavisë kanë bërë kërdrinë në dëm të popullit tonë, në shtetin shqiptar s'kanë gjetur shesh për të bërë përshesh. Mirëpo, duke qenë njeri i përvuajtur, i thjeshtë dhe i vetëdijshëm për dashurinë që kam ndaj nënës Shqipëri, jam i sigurtë se unë s'do të merrja në asnjë mënyrë rrugën e atyre djemve bastardë të Kosovës, që janë vënë në shërbim të armikut, por do të ndiqja shembullin e ca të tjerëve, si Ajet Haxhiu, Agim Gjakova e ndonjë tjetër të cilët kurdoherë kanë mbetur burra të ndershëm." (Letër Enver Hoxhës, prill 1980; Faridin Tafallari, Kur shkruante Jusuf Gërvalla 'Bashkimi bënë fuqinë', www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

Sabri Hamiti: "**ZANA – Mbetëm vetëm. Ti ishe në burg, Baca i Isës ishte në burg. .. Ne mbetëm pa askë pranë. Unë me fëmijët. Dhe shkuam në Tiranë . – GJERGJI: Shkuat vetë?**
ZANA: Shkuam e na çuan. Refugjatë për së dyti." (Faqe 104)

Suzana Gërvalla: "Pas varrosjes së tyre unë kam kërkuar me shkua në Shqipëri me fëmijët. Se Jusufi kishte dëshirë me i shkollua fëmijët në Shqipëri. Kamë bërë kërkesë, tri herë ma kanë kthye negative. Nuk më pranonin. Të katërtën herë kërkesën e kam dërguar në Turqi dhe atje ka qenë një person që e ka rregullua dhe më pranuan me shkua. Kemi shkuar përmes Austrisë në Athinë, e nga Athina në Tiranë." (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo, YouTube, 3 gusht 2017, koha në film 21:33-22:10)

Xhafer Durmishi: "Në orët e vona të natës së 16 shkurtit 1982 (me Sabri Novosellën) e kemi marrë autobusin, dhe në një natë që dukej shumë e ftohtë, kemi udhëtuar deri në Ankara ku kemi mbërrirë në mëngjesin e 17 shkurtit. Kemi shkuar drejtë në ambasadën shqiptare. Pas një bisede të gjatë, Bujar Hoxha, djali i Kadri Prishtinës, në prani të Sabri Novosellës, ma ka komunikuar vendimin e PPSH (apo thënë me drejtë të Enver Hoxhës) për pranimin e gruas dhe fëmijëve të Jusufit në Shqipëri, kërkesë të cilën ia kisha bërë Engjëll Kolanecit, me dëshirë e porosi të Suzanës, dëshirë e ide të cilën Jusufi ia ka mbjellë qysh kur ai ka qenë gjallë."

Komiteti "Vëllezërit Gërvalla": "Shpendi pasi i numëroi disa detyra që i ka pasur Drita si shoqja më e ngushtë e Sokolit (për të cilat disa nga të pranishmit nuk kanë qenë në dijeni) e njëherit i njoftoi se ajo pas një kohe do të shkojë në A. (Australi-shën i Xh. D.). Ai atë e propozoi si sekretare deri sa ajo të jetë në mesin tonë. (...) **Me shkuarjen e Dritës ne do të mblidhemi prapë dhe në vendin e sekretarit do të zgjedhet Halimi.**" (Letër drejtuar Komitetit të degës së LRSHJ "Hasan Prishtina" në Turqi më 26 shkurt 1982, Faridin Tafallari, Terror-Dhimbe-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 357-358)

Përmes kontaktit me Pajazit Ibrahimit kisha marrë lidhje me Shoqërinë Bashkimi Kombëtar Bajram Curri në Australi. Për ta ruajtur fshehtësinë e plot derisa të kryhej puna, patëm thënë se familja e Jusufit, nën përkujdesjen e Rilind Bytyqit me shokë do të vendoset në Australi.

-2. PËRCJELLJA E SUZANËS, PREMTONIT, DONIKËS DHE ERGONIT PËR SHQIPËRI

Xhafer Durmishi: "Pas kërkesës që ia kisha bërë Engjëll Kolanecit për vendosjen e Suzanës me fëmijët në Shqipëri, e cila ishte edhe kërkesë e Suzanës dhe dëshirë e shprehur më parë nga vetë Jusufi, dhe ardhjes së përgjigjes pozitive që m'u komunikua nga Bujar

Hoxha në Ankara më 17 shkurt 1982, në fund të marsit u bë organizimi i dërgimit të familjes së ngushtë të Jusufit në Shqipëri. Pas bisedave që kisha bërë me Engjëllin, nga Untergruppenbachu, më 28 mars 1982, u nisëm Haxhi Berisha, Faridin Tafallari, Nuhi Sylejmani dhe unë. Faridini për këtë rrugë e ka huazuar një kombi prej Nami Ramadanit, nga fshati Tenovë i Tetovës, që jetonte në Esslingen. Faridini me Nuhiun e kanë ngarkuar kombin me tesha e sende. Unë e Haxhi Berisha me Suzanën dhe fëmijët e kemi marrë trenin nga Shtutgarti për në Vjenë. Adresën e takimin na e ka caktuar Engjëll Kolaneci. Atë ditë ne të gjithë jemi takuar në Muzeun, në të cilin gjendej shpata e Skënderbeut. Unë, Faridini dhe Nuhiu jemi përshëndetur me Suzanën, Premtonin, Donikën e Ergonin në Muze dhe jemi kthyer së bashku me kombin e Namiut. Haxhi Berisha ka qëndruar më gjatë se ne me familjen atë ditë dhe është kthye më vonë, vetëm, me tren."

Suzana Gërvalla: "Ta dini se jam prekur shumë prej jush. As ata djemtë të tjerë nuk shkruajnë por ata janë të rinj e agjami dhe nuk jua nxo për të madhe por prej jush kam pritur më shumë. **Po qaj unë që nuk qajta në ato momente më të vështira të jetës sime, po qaj unë që ju jepsha gajret të gjithëve por atëhere e kisha gjithë shoqërinë e Jusufit me vete e tash më latë të gjithë.** Unë nuk e di pse na lat kështu, a nuk dita me ju dasht si vëllëzër apo nuk dita me ju bë hizmet sa duhet." (Letër Faridin Tafallarit më 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

S. H.: "GJERGJI – Kush qenkan këta?

ISA – vijon me zë të ulët. Thonë se janë një **Luli e një Keqa**. ... Të tjerët i bartin fjalët e tyre...

GJERGJI – Që ti je tradhtar?

ISA – Edhe këtë, edhe atë. Por shërbime lypin. Donë gazeta e janë gjysmanalfabetë. Shihe çfarë shkruajnë! Ia nxjerrë parasysht një letër. Parulla, propagandë qesharake. Këngë për traktorin, vaje për Kosovën, himne për Shqipërinë, këngë për Të Madhin. Më duhet të ndreq diçka."

GJERGJI – Këto fjalë më sollën këtu si pakrye. Ata farë tipash duhet t'i takosh sa më shpejt, përndryshe shkove keq ti dhe më keq familja." (f.23-24)

Sabri Hamitit: "ZANA, pa përfillje. Nuk kam çka sugjeroj në mënyrë të veçantë. **Sa për miqtë e Isës, ai i ka pasur dy miqë të mirë, Nakun e Gjergjin. Ata mund t'ju flasin çka e vlen, për veprën e tij.**" (Faqe 24 dhe 83-84)

Sabri Hamiti: "ZANA – Ti e di Gjergj kush e ka njohur Isën. Mirëfilli e luta atë djaloshin dinak e të urtë që të mbështetej në dokumente." (f.101)

Suzana Gërvalla: "Ta dini se jam prekur shumë prej jush. As ata djemtë të tjerë nuk shkruajnë por ata janë të rinj e agjami dhe nuk jua nxo për të madhe por prej jush kam pritur më shumë. **Po qaj unë që nuk qajta në ato momente më të vështira të jetës sime, po qaj unë që ju jepsha gajret të gjithëve por atëhere e kisha gjithë shoqërinë e Jusufit me vete e tash më latë të gjithë.** Unë nuk e di pse na lat kështu, a nuk dita me ju dasht si vëllëzër apo nuk dita me ju bë hizmet sa duhet." (Letër Faridin Tafallarit më 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

Tusha Gërvalla (gruaja e Bardhosh Gërvallës): "Mirë dita shok e vllazenë Po ju lajmrona të gjithëve se na imi mir tanë shnosh e mir po mërzhitem kapakë po ju si ini tanë me shnet ashtu edhe me punë si po kaloni, a po mërzhitni. Letra e ju j sot me erdh shumë faleminderes prej jush. Edhe fotografit me erdhën shumë mir ishin kan marue. Shok po ju veti për Isufin edhe Bardhin se qysh janë a po mërzhiten. Të fala spo na qojne asniher." (Letër nga Kosova shokëve në Shtutgart, vjeshtë 1982)

I DASHUR SHOKU ENVER,
E DASHUR SHOQJA NEXHMIJE,

Përpara se të shpreh mirënjohjen e thellë për tërheqjen time në Atdhe dhe kushtet e shkëlqyera që më janë krijuar (pa përmendur ngazëllimin dhe nderin që na shkaktoi mua dhe fëmijëve vizita e shoqes Nexhmije); përpara se të shënoj falënderimet nga thellësia e zemrave të të tre fëmijëve, që UDB-ja jugosllave u përpoq t'i linte jetimë, duke vrarë tim shoq, Jusufin, por harruan se për bijtë e vërtetë të Shqipërisë është prindja kurrë e pavdekshme – Partia,

e kam amanet, Shoku Enver, t'Ju përcjell dashurinë, respektin dhe mirënjohjen e pakufishme të burrit tim, Jusuf Gërvalla! Kemi jetuar me bukë e pa bukë, emri Juaj na ka dhënë forcë, mësimet Tuaja na kanë ndriçuar rrugën. Zërin Tuaj e kemi përcjellë tek zemrat e kosovarëve. Im shoq, Jusufi, ishte publicist, poet, kompozitor, piktor; por nuk mburrej me asgjë, përveç me fjalët: “JEMI ENVERISTË”. Ai dinte përmendësh pasazhe të tëra nga të gjitha veprat Tuaja. Sa herë në hall, brenga e mjerime në botën e betejshme perëndimore, ne kemi folur gojë më gojë, duke u ruajtur mos na përgjonin edhe muret, përmendnim PPSH-në e na rrehte zemra. Kemi ëndërruar për të ardhmen e Kosovës. Në çdo episod të bisedave, dëshirave dhe ëndërrimeve të ndezura, strumbullar ka qenë emri Juaj, i cili sa është i dashur dhe i shtrenjtë për kosovarët, aq është bërë i njohur në tërë botën. Kemi hequr kafshatën prej goje për të botuar gazeta e revista, ku kemi asimiluar mësimet dhe bindjet Tuaja patriotike-politike-filozofike dhe i kemi shpërndarë, duke përbiruar përmes hordhive të agjenturës jugosllave dhe të të gjitha ngjyrave reaksionare.

Jam krenare që im shoq, Jusuf Gërvalla, vërtet ra në frontin më tragjik të ideologjisë dhe të patriotizmit, por mund të them me thjeshtësi se ai arriti të krijojë një bërthamë revolucionarësh sipas mësimave të PPSH-së, që do të vazhdojë luftën deri në fitore! Janë revolucionarë, patriotë të tillë që kanë vetëm një alternativë: “Me vdekë ose me fitue!” Prandaj nuk mund t'ua tronditë asgjë qëllimin e fitores!

Im shoq, me dy plumba të UDB-së në shpatull, me të tretin në bark, kur e ndanin disa sekonda nga jeta, porositi:

“Fëmijët të m'i rritësh trima! Dhe kur të uleni, edhe kur të ngriheni, emrin e shokut Enver do ta keni në gojë!”

Amanetin e Jusufit e kryejmë ne, edhe Ergoni katërvjeçar përdor si himn vargjet që ia ka mësuar i ati:

“Jam i vogël, kurrgjë s'di,
Veç dy fjalë për Shqipëri,
Për flamurin kuq e zi,
Për ENVERIN, për PARTI”

Ditën që jemi nisur për në Atdhe, jam betuar përpara varrit të Jusufit, betohem edhe përpara Jush, shoku Enver, se rrugën e Jusufit do ta ndjek, do të jem gati të jap gjithçka prej vetes ku e lyp interesi i Atdheut dhe i Partisë, do t'i edukoj fëmijët edhe më tej me frymën e lartë të partishmërisë proletare, do të ndjek fakultetin për t'u bërë sa më e aftë.

Së fundi, s' di si t' Ju falënderoj që, midis gjithë atyre punëve që keni, si Ju, ashtu edhe shoqja Nexhmije, gjeni rastin të na kujtoni me dhurata që na rrisin krenarinë mua dhe fëmijëve të mi. Kam një kërkesë, ndoshta të tepërt: do të doja një shënim nga dora Juaj, shoku Enver, qoftë edhe në një nga librat që më keni dhuruar, asisoj, më bëhet se do t' i bëhej qejfi e do të krenohej edhe Jusufi në varr, atje larg, në dhe të huaj!

Ju përqafojmë me mall dhe ju urojmë jetë të gjatë.
Unë, Suzana, Fëmijët: Premtoni, Donika, Ergoni
Tiranë, më 28-6-1982

SHËNIM:

Si Jusufi, ashtu edhe unë, ëndrrën më të madhe të jetës e kemi pasur të pranoeshim si komunistë në gjirin e PPSH. Jusufi ra, unë shpreh dëshirën e zjarrtë të bëhem komuniste, duke qenë në gjendje të përmbush të gjitha kushtet që parashikon Statuti!

(vna.al, 3 qershor 2025)

-3. REAGIM I FAMILJES GËRVALLA

për incidentin që i ka ndodhur Donika Gërvallës, nga kreu i LDK-së Isa Mustafa

Dubovik, 21. 05. 2016: Familja jonë Gërvalla në Kosovë, në Shqipëri dhe në diasporë jemi tepër të shqetësuar për incidentin e mbrëmshëm që i ka ndodhur vajzës sonë, Donika Gërvalla, nga struktura klanore e Isa Mustafës, kryetar i LDK-së.

Bija jonë mbrëmë po insistonte të merr pjesë në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së, si kryetare e degës së kësaj partie në Gjermani.

Elementë të klani të Mustafës, duke e ditur qëndrimin e Donikës për t'ia kthyer dinjitetin kombëtar kësaj partie, ashtu si e kishte në kohën e dr. Ibrahim Rugovës, jo vetëm që nuk e kanë lënë të marrë pjesë në mbledhje, por fizikisht, duke e tërhequr zvarrë, nuk e kanë lënë të hyjë në sallë.

Ky incident i parapërgatitur, tepër i rëndë jo vetëm për një femër, na e ka kujtuar kohën e regjimit pushtues serb, për të cilën ka luftuar e tërë familja jonë, duke dhënë madje edhe dy heronjë.

Ky incident jo vetëm që ka nëpërkëmbur dinjitetin njerëzor të vajzës sonë, por është edhe një sulm i rëndë kundër fjalës dhe mendimit të lirë, të cilat janë vlera themelore dhe universale të një shoqërie demokratike, për të cilën trumbeton se po punon vetë klani i Mustafës. Këto vlera qytetëruese, për të cilat punon bija jonë, janë shkelur aq brutalisht në kohën kur e tërë bota ka sytë të kthyer kah shoqëria jonë dhe nga të gjitha veprimtaritë shtetndërtuese të kësaj fryme.

Ne si familje me tradita kombëtare me frymë të mendimit të ri shtetëror, kombëtare dhe demokratik, e dimë mirë se kjo frymë është në kundërshtim të thellë me ideologjinë të komunizmit sllav, të cilën e ka në shpirt, si tani, si më herët, e njëjta strukturë që ka sulmuar vajzën tonë, ashtu si ka sulmuar edhe tani edhe më parë vlerat e lirisë të Kosovës, duke përfshirë të gjitha lëvizjet kombëtare dhe çlirimtare, prej viteve të '80-ta e deri më sot.

Ne familja Gërvalla, por edhe shoqëria jonë në përgjithësi, do të mbështesim edhe më tutje mendimet dhe veprimet, që kanë vlera kombëtare, shtetërore dhe demokratike, kundër të cilave ka ndodhur ky incident. Vetëm me këto vlera mund të shkojmë përpara

për të ndërtuar shtetin dhe shoqërinë demokratike, në të cilën ka vend shprehja e mendimit të lirë, e pranueshme për tërë qytetërimin evropian dhe botëror.

Edhe diçka Isë: Në identitetin tonë kombëtar dhe ate historik, femra ka qënë institucion dhe vlerë e paprekshme e shoqërisë sonë.

Isë, siç e di edhe ti, familja jonë gjatë gjithë historisë është persekutuar, bastisur, kontrolluar, burgosur, syrgjynosur, terrorizuar me qindra herë nga UDB-ja serbe dhe ajo Jugosllave, por edhe ata asnjëherë nuk kanë zbritur në nivelin tënd dhe të klanit tuaj.

Dubovik, 21 maj 2016, Për familjen GËRVALLA - Hysen Gërvalla

=====

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit

01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: “Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror.” (14 janar 1981)

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën “Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi”. Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

=====

XHAFER DURMISHI-SKENDERI Dhjetor 2011-Shkurt 2026